



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Kuvendi i Komunës në Gjilan, në mbledhjen e mbajtur më datë 23.02.2001 nxori këtë:

VENDIM
PËR NDËRTIMIN E OBJEKTIT BANESOR – AFARISTË

-I-

LEJOHET ndërtimi i objektit banesor- afarist në ng. katas. Nr. 2457/5, 2458/1, 2459/11 dhe 2459/14 Komuna kadastrale në Gjilan, Shfrytëzues i të cilave ngastra kadastrale është Kombinati i Tekstilit, “ INTEGJ” – Gjilan.

-II-

Në bazë të këtij Vendimi do të bëhet bartja administrative nga Shfrytëzuesi Kombinati i Tekstilit “ INTEGJ”- Gjilan, në shfrytëzuesin e ri Kuvendi i Komunës Gjilan.

-III-

Objekti nga N.1 i këtij vendimi do të ndërtohet sipas PDU të lagjes “ KAMNIK”

-IV-

Autorizohet kryetari i K.K- Gjilan që të lidh Marrëveshje për investim në ndërtim e këtij objekti banesor- afarist.

-V-

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset kryetari i K.K. Gjilan.

-VI-

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

Nr. 01/ 1196/ 07
Gjilan, 23.02.2001

Kryetari:

Lutfi Haziri



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Në bazë të nenit 3.1. pika e, dhe d, të Rregullores mbi vetëqeverisjen e komunave të Kosovës “UNMIK/ RREG/ 2000/45”, dhe nenin 12, pika b,c dhe e, të Statutit të Komunës së Gjilanit, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 16.03.2001, nxori këtë.

VENDIM
MBI NDËRTIMIN E OBJEKTEVE NDËRTIMORE NË TERRITORIN E KOMUNËS SË GJILANIT

1) DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1.

Me këtë vendim përcaktohen kushtet e përgjithshme për ndërtimin, rekonstruktimin, aneks ndërtimin të objekteve në territorin e Komunës së Gjilanit.

Neni 2

Dispozitat e këtij vendimi kanë të bëjnë me:

- 1) ndërtimin e objekteve investive;
- 2) ndërtimin dhe rikonstruimin e objekteve të infrastrukturës komunale;
- 3) ndërtimin e ti, ndërtimin aneks, mbindërtimin, rikonstruimin, adaptimin dhe meremetimin e objektit;
- 4) ndërtimin e objekteve të përkohshme në punishte.

Neni 3

Objektet investive në kuptim të këtij vendimi, konsiderohen: objektet e ndërtimit, objektet e ndërtimit me instalime, impiante dhe pajisje të montuara që I shërbejnë objektit investiv dhe instalimet , impiantet dhe pajisjet që vendosen në objekte të ndërtimit.

Objektet ndërtimore në kuptim të këtij vendimi konsiderohen edhe ndërtesat e banimit individual dhe kolektiv-etazh, ndërtesat banesore –afariste ,ndërtesat afariste dhe objekteve ndihmëse.

Objektet komunale konsiderohen ujësjellësi, kanalizimi, PTT-instalimet, elektro-instalimet si dhe stazat e kalueshme nëpër sipërfaqe të gjelbëruara, hortikultura, rregullimi I rrjedhës së lumenjve dhe kanaleve e të ngjashme.

Rikonstruim I objekteve në kuptim të këtij vendimi konsiderohen kryerja e punëve në objektet ekzistuese me të cilat punë kryhet sanimi ose ndryshimi I elementeve të konstruksionit të objektit apo kryhen punë tjera në objektet të cilat mund të kenë ndikim në stabilitetin e objektit, përkatësisht pjesëve të objektit.

Me adaptim dhe meremetim të objektit në kuptim të këtij vendimi nënkuptojmë punët e domosdoshme në mirëmbajtjen vijuese të objektit që ka ndikim në higjienën e përgjithshme të objekteve të banimit, pamjet estetike të objektit si që janë: hapja, murosja, lyerja dhe gëlqerosja e mureve të brendshme dhe të jashtme ,përmirësimi I vrimave dhe të plasaritjeve, ndërrimi dhe

mirëmbajtja e çatisë, ndryshimi I pjerrtësisë së kulmit , ndërrimi I zdrukthëtarisë dhe dyshemesë dhe punëve të ngjashme të cilat mund të kryhen pa lejen e organit kompetent. Objektet I përkohshëm në punishte konsiderohen objektet me karakter të përkohshme të cilat duhet shërbejnë për ndërtimin e objektit kryesor si që janë: barakat për vendosjen e punëtorëve, depot e materialit ndërtimor dhe mjeteve të punës e të ngjashme.

II. KUSHTET URBANISTIKO-TEKNIKE

Neni 5

Kushtet urbanistiko- teknike për ndërtimin e objekteve ndërtimore ,përcaktohen në bazë të planit gjeneral urbanistikë. Planit detal urbanistik dhe planit të rregullimit ,respektivisht vendimit me të cilin zëvendësohen ato plane në pajtim me këtë vendim dhe ato kushte janë.

1. kushtet në vështrim të madhësisë, formës dhe pozitës së ngastrës ndërtimore, katësisë dhe lartësisë së objektit, vijës së rregullimit dhe vijës së ndërtimit;
2. Pozitës së objektit në raport me objektet tjera të afërta dedikimit, gabaritit horizontal dhe vertikal, bazave karakteristike të pamjes së jashtme dhe përcaktimit të vijës së rregullimit kah rrugët e trafikut për komunikacion.
3. Shënimet bazë për instalimet, respektivisht stabilimentet e ujësjellësit, kanalizimit, hedhjes dhe vendgrumbullimit të mbeturinave si dhe caktimi I organeve dhe subjekteve tjera kompetente të cilat më për së afërmi do të I përcaktojë kushtet për instalime dhe kyçje në stabilitet;
4. Shënimet e objekteve të cilat duhet të rrënohen, për shkak të ndërtimit të ri;
5. Rregullimin e sipërfaqeve të lira në ngastër- oborr;
6. kushtet të cilat I kërkon siguria në trafik;
7. Caktimi e organit I cili duhet të jap pëlqimin në dokumentacion investivo-teknik ose në disa pjesë të projektit si që janë : inspektionit sanitari, inspektionit I komunikacionit, shërbimi kundër zjarrit, elektroekonomisë dhe organeve tjera për dhënien e pëlqimeve të domosdoshme sipas dispozitave në fuqi.

Neni 6

Shënimet mbi kushtet urbanistike-teknike me shkrim I jep organi kompetent për punë të urbanizimit, në bazë të kërkesës së palës.

III. DOKUMENTACIONI TEKNIK

Neni 7

Ndërtimi I objekteve bëhet në bazë të dokumentacionit investivo-teknike ose në bazë të disa projekteve, (në tekstin e mëtejme; dokumentacioni teknik) nëse për disa objekte me këtë vendim nuk është parapa ndryshe.

Adoptimi I objekteve ekzistuese dhe ndërtimi I disa objekteve më të vogla si që janë: garazhet jashtë objektit, WC skaj oborrit gropat septike, shahtat, pusët, muret nga rruga të ngjashme, bëhet sipas projektit ideor-skicës.

Neni 8

Dokumentacioni teknikë duhet të jetë I punuar në pajtim me dispozitat në fuqi dhe kushtet urbanistike-teknike.

Harmonizimin në mes të dokumentacionit teknik dhe kushteve urbanistike-teknike e vërteton organi kompetent për punë të urbanizmit.

Pjesë përbërëse e dokumentacionit teknik duhet të jetë edhe

- kushtet urbanistike- teknike,

- dëshmia që toka, respektivisht ngastra kadastrale është e dedikuar për ndërtimin e objektit të tillë (kopja e planit) dhe
- dëshmia mbi të drejtën e pronës në të cilën ndërtohet objekti –flet posedimi ose kontrata e vërtetuar gjykatë.

Neni 9

Dokumentacioni teknik dhe projekti duhet të jetë I punuar nga shtëpia projektuese, respektivisht nga ndërmarrja e regjistruar për punimin e atij lloj dokumentacioni. Projekti ideor-skicës mund ta punojë edhe personi I cili e ka për të kualifikimin përkatës profesional.

Për punët në objektet e mbrojtura me ligj, në projekt, pëlqimin duhet ta jap organi kompetent për mbrojtjen e përmendoreve kulturore.

IV LËSHIMI I LEJEVE NDËTIMORE

Neni 10

Ndërtimi I objektit nuk mund të fillojë para se të lëshohet leja për ndërtim.

Lejen për ndërtimin e objektit e nxjerr investuesi

Lejen për ndërtimin e objektit e lëshon organi kompetent për punë të urbanizmit në pajtim me dispozitat pozitive ligjore dhe të këtij vendimi.

Neni 11

Leja për ndërtimin e objekteve të përkohshme pas marrjes së lejes për ndërtimin e objektit kryesor

Para marrjes së lejes për ndërtim, në ngastër nuk mund të kryhet kurrfarë pune (sjellja dhe vendosja e materialit, punimi I objekteve te përkohshme) etj.

Pas kryerjes së punëve në objektin kryesor, objektet e përkohshme duhet të largohen ose të rrënohen.

Neni 12

Leja për ndërtim nuk do të vlejë nëse në afat prej 1 viti nga dita e dhënies së sajë, investuesi nuk e fillon punën në objekt.

Me kërkesën e investuesit, organi kompetent që e ka lëshuar atë mundet në rastet e arsyeshme ta vazhdojë të njëjtën më së largu edhe për një vit, me kusht që në ndërkohë të mos kenë ndryshuar kushtet urbanistike të ndërtimit.

Pas kalimit të afatit prej dy vitesh nga dita e lëshuarjes së lejes ndërtimore, investuesi e humbë të drejtën e ndërtimit sipas asaj leje.

Neni 13

Në procedurën e dhënies së pëlqimit urbanistik për ndërtimin e ri, aneks ndërtim, mbindërtim ose rikonstituimin e objektit individual, pala parashtrohet edhe :

Dy kopje të planit të ngastrës ndërtimore dhe dëshminë mbi të drejtën e pronësisë në tokë, për të cilën kërkon pëlqimin urbanistik, në të cilën organi kompetent për dhënien e lejes jep pëlqimin urbanistik në pajtim të dispozitave në fuqi dhe ia cakton edhe tjera të domosdoshme për dhënien e lejes së ndërtimit si që janë : lloji I dokumentacionit teknik- projektit, vërtetimi I projektit, pagesa e kompensimit për rregullimin e tokës ndërtimore, pëlqimet e nevojshme nga ndërmarrjet ose shërbimet tjera kompetente e të ngjashme.

Neni 14

Me kërkesën për dhënien e lejes së ndërtimit të objektit, investuesi është I obliguar që të parashtroj këtë dokumentacion:

- dy kopje të planit kadastral të ngastrës ndërtimore të parcelua sipas planit detal urbanistikë.
- Projektin e punuar dhe të vërtetuar nga ana e ndërmarrjes , respektivisht organit kompetent në tri kopje;
- Pëlqimin e organeve , ndërmarrjeve dhe shërbimeve ku ekziston interesi I tyre.
- Dëshminë mbi pagesën në emër të rregullimit të tokës ndërtimore;
- Lejen ndërtimore për objektin kryesore nëse kërkohet vendosja e objekteve karakterit të përkohshëm.

Neni 15

leja ndërtimore lëshohet me aktvendim dhe I njëjti duhet të përmbajë:

- Shënimet mbi investuesin cilit I lejohet ndërtimi I objektit
- Shënimet mbi ngastrën ndërtimore në të cilën bëhet ndërtimi
- Kushtet urbanistike
- Afatin e vlefshmërisë së lejes ndërtimore.

Neni 16

Organi kompetent për punë të urbanizmit do të konstatojë në dokumentacionin e ushtruar saktësinë e tij në bazë të të cilit lëshohet leja ndërtimore.

Një kopje të dokumentacionit teknik të vërtetuar organi do ta mbajë për evidencë.

Neni 17

Për ndryshimet dhe plotësimet e projektit që bëhen pas lëshimit të lejes ndërtimore, është e nevojshme dhënia e lejes së posaçme nga organi I cili e ka lëshuar lejen e ndërtimit. një kopje të projektit me ndryshime dhe plotësime e ruan organi që e ka lëshuar lejen.

Neni 18

Për objektet të cilat gjinden në komplekset për të cilat nuk është nxjerr plani detal urbanistik, respektivisht përpunimi I planit është në hartim e sipër , e të cilat gjenden në rajonin ndërtimor të përfshirë me plan gjeneral urbanistik të qytetit të Gjilanit, mund të lejohet ndërtimi dhe legalizimi I objekteve nën kushtet si vijon.:

- 1) Që me ndërtimin dhe legalizimin e tyre të mos cenohen dhe rrezikohen arteriet kryesore dhe sekondare të trafikut të komunikacionit dhe objektet e infrastrukturës komunale ekzistuese dhe të parapara me PGJU.
- 2) Që me ndërtimin dhe legalizimin e tyre të mos rrezikohen objektet e afërta dhe
- 3) Që objekti të jetë objekt I banimit ose objekt I dedikimit tjetër e jo objekt ndihmës (shupë garazh kuzhinë verore) etj.

Neni 19

Për objektet të cilat gjinden në kompleksin ndërtimorë për të cilin ekziston PDU realizimi I të cilit është në fazën përfundimtare, nuk mund të lejohet kurrfarë punësh në objektet ekzistuese, nëse objekti I tillë nuk mund të harmonizohet me PDU.

Neni 20

Në fshatra dhe pjesët periferike të qytetit mund të ndërtohen vikend-shtëpiza sipas arkitekturës e cila duhet të I përgjigjet zgjedhjeve urbanistike.

Kuvendi I Komunës me vendim të posaçëm do të I përcaktojë kushtet për ndërtimin e objekteve nga paragrafi 1 i këtij neni.

Neni 21

Nëse në kërkesën për dhënien e lejes së ndërtimit nuk janë parashtruar shtojcat e përmendura në nenin 14, të këtij vendimi, organi kompetent i urbanizmit do ta ftojë parashtruesin e kërkesës që në afatin e caktuar ta parashtrojë dokumentacionin ose dëshminë e nevojshme të cilat mungojnë;

Nëse organi kompetent konstaton se dokumentacioni investivo-teknik nuk i përshtatet kushteve urbanistike dhe kushteve tjera për atë lokacion, ose projekti nuk janë në harmoni me normativat teknike dhe standardet teknike etj. Parashtruesin e kërkesës do ta ftojë që të metat e tilla të mënjanohen në afatin ligjor.

Në rastet nga paragrafi 1. dhe 2 të këtij neni, afati për dhënien e lejes së ndërtimit fillon të rrjedh nga dita e mënjanimi të metave të konstatuara.

Neni 22

Nëse parashtruesi i kërkesës nuk i plotëson kushtet e parapara me këtë vendim, e të cilat janë të domosdoshme për dhënien e lejes së ndërtimit, atëherë organi kompetent i urbanizmit me aktvendim do ta refuzojë, respektivisht hedhë poshtë atë kërkesë.

V. NDËRTIMI I OBJEKTIT

Neni 23

Ndërtimi i objektit duhet të i cenohet – besohet ndërmarrjes ose ndërmarrësit të regjistruar për ndërtimin e objekteve të tilla.

Investuesi dhe ndërmarrja janë të obliguar që të lidhin kontratë mbi ekzekutimin e punëve.

Ndërtimin e objekteve individuale të banimit dhe objekteve, investuesi mund ta kryej edhe vetë nëse për një gjë të tillë posedon kualifikim dhe aftësi profesionale.

Ndërtimi i disa punëve në objekt mund të i cenohet – besohet me kontratë edhe zejtarëve të pavarur të regjistruar për ushtrimin e veprimtarisë së tillë.

Neni 24

Investuesi i objektit ndërtimorë e ka për detyrë që organin kompetent ta lajmërojë për ditën e fillimit të punëve më së voni 8 ditë para fillimit të ndërtimit, respektivisht nga dita e përfundimit të punëve në objekt.

Pas lajmërimit për fillimin e punëve, organi kompetent për dhënien e lejes së ndërtimit do ta përcaktojë vijën e ndërtimit sipas kushteve të dhëna urbanistike dhe mbi këtë do të përpilojë procesverbal.

Neni 25

Mbikëqyrjen mbi ndërtimin e objekteve sipas këtij vendimi, si dhe zbatimin e dispozitave, normativave dhe standardeve teknike gjatë ndërtimit të objektit e bënë organi kompetent.

Neni 26

Organi nga neni 25 i këtij vendimi është i obliguar të konstatojë:

- 1) Se a është nxjerr leja për ndërtimin e objektit nga ana e organit kompetent.
- 2) Se a është duke u ndërtuar objekti në pajtim me kushtet urbanistike dhe dokumentacionin teknik në bazë të të cilit është lëshuar leja.
- 3) Se a janë aplikuar në mënyrë të rregullt dispozitat e këtij vendimi, dispozitat teknik, normativat dhe standardet e obliguara.
- 4) Se a janë aplikuar masat teknike për sigurimin e ndërtimit të rregullt të objektit dhe masat për sigurimin e jetës së punëtorëve, njerëzve, sigurimin e trafikut dhe objekteve dhe të mirave tjera materiale, dhe
- 5) Se a do të ndërtohet objekti për dedikimin për të cilin është lëshuar leja.

Neni 27

Organi nga neni 25 I këtij vendimi ka të drejtë:

- 1) Të urdhëroj që të metat e konstatuara të evitohen Brenda afatit të cilin e cakton ai,
- 2) Të urdhërojë që të ndalet puna e mëtejme e ndërtimit të objektit.
 - Nëse në objekt bëhet punime pa leje ndërtim.
 - Nëse në objekt zhvillohet punime që nuk përkasin me lejen e lëshuar
 - Nëse në objekt nuk zhvillohen të metat Brenda afatit që e cakton organi,
 - Nëse punimet zhvillohen në mënyrë joprofesionale dhe pa aplikimin e dispozitave teknike normativave dhe standardeve të obliguara dhe
 - Nëse punimet zhvillohen pa aplikimin e masave teknike për sigurimin e jetës së njerëzve, sigurimin e trafikut dhe objekteve tjera,
- 3) Të urdhërojë që objekti ose punimet e caktuara të rrënohet, në këto raste:
 - Nëse ndërtohet në vendin ku sipas planit urbanistik, respektivisht kushteve urbanistik-teknike nga neni 18 i këtij vendimi nuk është paraparë ndërtimi i tillë,
 - Nëse konstatohen të meta ose mangësi në ndërtim për shkak të të cilave paraqitet rreziku për stabilitetin e objektit, për sigurimin nga zjarri dhe sigurimin e jetës dhe shëndetit të njerëzve, sigurimin e trafikut, objekteve fqinjë, ose nëse konstatohet se punimet nuk zhvillohen nën kushtet e caktuara për ndërtime të tilla dhe që ato të meta dhe mangësi nuk mund të mënjanohet, dhe
 - Nëse për objektet e ndërtuara pa leje ose punët e zhvilluara në kundërshtim me lejen, në afatin e caktuar nuk pajiset me leje ndërtimi kur kërkesa e tij është refuzuar me aktvendim të formës së prerë.

Neni 28

Nëse nuk veprohet mbi rrënimin e objektit ose të punimeve të zhvilluara, rrënimi do të bëhet me dhunë në barrë dhe ngarkim të investuesit në mënyrë më të volitshme dhe më të shkurtër dhe nën mbikëqyrjen e organit kompetent.

Neni 29

Objektet e filluara dhe të ndërtuara pa leje nuk mund të kyçen në rrjetin elektrik, të kanalizimit ujësjellësit dhe telefonik.

Neni 30

Investuesi dhe pjesëmarrësit tjerë në ndërtimin e objektit me kërkesën e organit kompetent kanë për detyrë të ia japin për kontrollin lejen për ndërtim dhe dokumentacionin tjetër teknik, në bazë të të cilit zhvillohen punimet në objekt si dhe shënimet tjera mbi vijimin dhe mënyrën e zhvillimit të punimeve dhe të ia mundësojnë kontrollimin e papaguar.

Neni 31

Ankesa kundër aktvendimit nga neni 27.28 dhe 29 të këtij vendimi, nuk e shtynë ekzekutimin e aktvendimit.

VI. KONTROLLIMI TEKNIK

Neni 32

Pas kryerjes së ndërtimit të objektit ndërtimor ose pjesës së objektit dhe para fillimit të shfrytëzimit të tij, respektivisht lëshuarjes së tij në përdorim, do të bëhet kontrollimi teknik i tij.

Sipas natyrës së tij, kontrollimi teknik i objektit ndërtimor përfshinë: kontrollimin teknik të punëve ndërtimor dhe kontrollimi teknik i stabilimenteve dhe pajisjeve dhe instalimeve. Kontrollimi teknik kryhet vetëm për ato objekte që janë ndërtuar në bazë të lejes ndërtimore.

Neni 33

Me anë të kontrollit teknik konstatohet se objekti ndërtimor a është ndërtuar në pajtim me dokumentacionin teknik dhe në pajtim me lejen e ndërtimit.
Kontrollimi teknik i punimeve ndërtimore dhe punimeve ndërtimore- zejtare bëhet nga ana e komisionit që e cakton organi që e ka lëshuar lejen e ndërtimit.
Komisioni nga paragrafi paraprak përbëhet së paku nga 3 anëtarë profesional prej të cilëve së paku një anëtarë është përfaqësues i organit që e ka lëshuar lejen ndërtimore.

Neni 34

Kontrollimi teknik bëhet me kërkesën e investuesit i cili e ka për detyrë të i bartë shpenzimet e kontrollimit.
Komisioni për kontrollimin teknik mbanë përgjegjësi për dhënien e mendimit mbi lëshuarjen e lejes për përdorim të objektit.

Neni 35

Për kontrollimin e kryer teknik hartohet procesverbali i cili i dërgohet organit kompetent të urbanizmit me qëllim të lëshimit të lejes për përdorim të objektit.
Procesverbali përmban: lëndën e kontrollimit teknik, dokumentacionin që është vënë në dispozicion me rastin e kontrollit, konstatimin mbi vërejtjet e hasura, mendimet dhe propozimet se a mund të përdoret objekti.

Neni 36

Nëse në objekte konstatohen të meta dhe lëshime, komisioni do të jap mendimin se a mund të lëshohet leja për përdorimin e objektit para ose pas eliminimit të të metave dhe mangësive duke marr parasysh llojin dhe natyrën e objektit.
Nëse është vërtetuar se të metat dhe lëshimit nuk mund të eliminohet, s'po ekziston rreziku që nuk mund të mënjanohet e I cili ka ndikim në pikëpamje të stabilitetit të objektit, jetës dhe shëndetit të njerëzve, trafiku dhe objekteve për rreth, komisioni nga neni 33, i këtij vendimi do të propozoj që ku objekt të rrënohet.

Neni 37

Nëse organi kompetent lejon përdorimin e objektit me të meta të caktuara, të cilat sipas llojit dhe natyrës nuk ndikojnë në shfrytëzimin e drejtë dhe të sigurisë së tij dhe rrethit, do të caktoj afatin Brenda të cilit investuesi dhe kryesi i punëve e kanë për detyrë që ato të meta dhe lëshime të I mënjanojë.

Neni 38

Nëse për shkak të të metave dhe lëshimeve të konstatuara nuk është dhënë leja për përdorim të objektit. Investuesi respektivisht kryesi i punëve pas mënjanimi të atyre të metave dhe lëshimeve duhet të kërkoj kontrollimin e sërishëm të objektit dhe punimeve të zhvilluara më vonë.
Kontrollimi i sërishëm i objektit dhe punëve të zhvilluara më vonë bëhet në mënyrë dhe proces sikur kontrollimi paraprak.

VII. LEJA PËR PËRDORIM TË OBJEKTIT

Neni 39

Objekti ndërtimor ose pjesa e tij e ndërtuar e cila paraqet tërësi ndërtimore-teknike, mund të shfrytëzohen vetëm pas nxjerrjes për përdorim të objektit.
Lejen nga paragrafi paraprak e lëshon organi kompetent për urbanizëm, në bazë të kërkesës së investuesit.

Për objekte ndihmës dhe adoptimin e tyre si dhe meremetimin e objektit-ndihmës nuk është e obligueshme leja për përdorim.

Neni 40

Leja për përdorim të objektit lëshohet nën këto kushte:

- 1) Që objekti të jetë i ndërtuar në bazë të lejes të lëshuar nga ana e organit kompetent;
- 2) Që objekti të jetë i ndërtuar në pajtim me planin urbanistik dhe dokumentacionin teknik;
- 3) Që objekti të jetë i ndërtuar në pajtim me dispozitat teknik dhe standardet e normativave gjegjëse.
- 4) Që në objekt të jenë kryer punimet ndërtimore-zejtare të domosdoshme për shfrytëzimin e tij;
- 5) Që për objekt të sigurohet hyrja e domosdoshme dhe kushtet tjera të shfrytëzimit;
- 6) Që të jetë dhënë pëlqimi i organeve ndërmarrjeve të kompetente, nëse kjo gjë është përcaktuar me dispozita të veçanta ose me këtë vendim;
- 7) Që në bazë të kontrollimit teknik të jetë dhënë mendimi se objekti mund të përdoret dhe
- 8) Nëse është bërë rivërtimi gjeodezik i objektit.

Dhënia e lejes për përdorim mund të kushtëzohet me mënjanimin paraprak të objekteve të përkohshme që janë ndërtuar në lidhje me objektin kryesor.

Neni 42

Bashkë me kërkesën për dhënie të lejes për përdorim të objektit, investuesi ka për detyrë të dorëzojë edhe:

- 1) lejen për ndërtim në bazë të së cilës janë zhvilluar punët në objekt.
- 2) Nëse në objekt janë zhvilluar punimet përkundër lejes së dhënë, atëherë ai duhet të sjellë aktvendim me të cilën ato punime janë harmonizuar me planin urbanistik, lejen e dhënë dhe dokumentacionin teknik, dhe
- 3) Procesverbalin mbi kontrollin teknik të objektit nga ana e komisionit kompetent të formuar me aktvendimin e organit që e ka lëshuar lejen.

VIII. KUSHTET PËR RRËNIMIN E OBJEKTEVE TË NDËRTUARA PA LEJE

Neni 43

Për objektet ndërtimi i të cilave ka filluar ose është kryer pas aprovimit të planit urbanistik pa leje ndërtimore ose përkundër lejes së dhënë, nëse ato gjenden në vendin ku është paraparë ndërtimi i tillë, me kërkesën e investuesit do të lëshohet leja për ndërtim, përkatësisht për harmonizimin e objektit ose punimeve të zhvilluara në të me planin urbanistik.

Neni 44

Nëse objektet nga neni paraprak gjinden në vendin ku nuk është paraparë ndërtimi i tillë me planin urbanistik ose janë zhvilluar punët përkundër lejes së lëshuar dhe që nuk mund të harmonizohen me të, investuesit do të i urdhërohet që objektin, përkatësisht punët e zhvilluara të i rrënojnë.

Neni 45

Dispozitat e nenit 43 dhe 44 të këtij vendimi do të aplikohen edhe për punët e zhvilluara në ndërtimin katësor, aneksndërtim dhe rikonstruim të objekteve ekzistuese.

Neni 46

Kërkesën nga neni 43.44 dhe 45 të këtij vendimi, investuesi është i obliguar ta parashtrojë në afat prej 30 ditësh nga dita kur kjo i është urdhëruar, nga ana e organit kompetent.

Nëse pas kalimit të afatit nga paragrafi 1 i këtij neni, investuesi nuk e parashtron kërkesën për lidhjen e lejes së mëvonshme për ndërtim, respektivisht kur aktvendimi me të cilin kërkesa e tij është refuzuar bëhet i plotfuqishëm, organi kompetent do të i urdhërojë me aktvendim, investuesit që objektin- punimet të i rrënojnë.

Neni 47

Lejen nga neni 43, 44, 45 dhe 46 të këtij vendimi e lëshon organi kompetent për urbanizëm, nën kushtet e parapara me këtë vendim..

IX. DISPOZITAT NDËSHKIMORE

Neni 48

Me dënim me të holla në shumë prej 1000-3000 DM, për kundërvajtje do të dënohet qytetari:

- 1) nëse e fillon ndërtimin e objektit para nxjerrjes së lejes për ndërtim,
- 2) nëse i zhvillon punët në kundërshtim me lejen dhe dokumentacionin teknik, në bazë të të cilit i është dhënë leja,
- 3) nëse nuk e rrënon objektin-punët në mënyrën dhe afatin e caktuar si që i është urdhëruar nga ana e organit kompetent,
- 4) nëse i zhvillon punët në mënyrë me të cilën rrezikon sigurinë e jetës dhe shëndetit të njerëzve, trafikut, objektet fqinjë dhe rrethinën si dhe stabilitetin e objektit,
- 5) nëse i zhvillon punët në kundërshtim me dispozitat teknike, me normativat dhe standardet e obliguara.
- 6) Nëse nuk e parashtron kërkesën sipas nenit 43.44 dhe 45 të këtij vendimi, për harmonizimin e objektit ose punimeve të zhvilluara me planin urbanistik.
- 7) Nëse objektin e ndërtuar pa leje e kyç në objektet e infrastrukturës komunale,

Nëse kundërvajtjen nga paragrafi 1 të këtij neni e bënë personi juridik, do të dënohet me dënim në të holla në shumë prej 3000-6000 DM.

Neni 49

Me dënim në të holla në shumë prej 1500-3500 DM, do të dënohet për kundërvajtje qytetari;

- 1) nëse në afatin e caktuar nuk vepron sipas urdhrit të organit kompetent në pikëpamje të mënjanimi të të metave me rastin e ndërtimit.
- 2) Nëse me rastin e kontrollimit refuzon të ia japë në shikim dokumentacionin teknik dhe shënimet e tjera organit kompetent,
- 3) Nëse nuk e lajmëron fillimin dhe mbarimin e punëve në objekt,
- 4) Nëse në mënyrë të pa rregullt e mbanë punishten
- 5) Nëse nuk i mënjanon objektet e përkohshme për të cilat nuk ka nxjerrë leje të posaçme sipas urdhrit të organit kompetent.
- 6) Nëse nuk lidhë kontratë mbi cenimin e punëve me ndërmarrjen ose ndërmarrësin e regjistruar.

Nëse kundërvajtjen nga paragrafi 1 i këtij neni e bënë personi juridik, do të dënohet me të holla në shumë prej 3500-7000 DM.

Neni 50

Mjetet e inkasuara nga neni 48 dhe 49 të këtij vendimi derdhen në buxhetin e Komunës së Gjilanit me destinim për rregullimin e tokës ndërtimore.

IX- DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 51

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Urbanizëm Rindërtim dhe Ambient dhe Drejtoria për Shërbime Publike të Komunës së Gjilanit.

Neni 52

Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohet vendimi mbi ndërtimin e objekteve të qytetarëve dhe personave civil-juridik të komunës së Gjilanit (Gazeta Zyrtare e Kosovës' nr. 40/87) dhe Urdhëresa Komunale nr.2000/31.

Neni 53

Ky vendim hynë në fuqi ditën e aprovimit,

Nr. 01, 1425-020
Gjilan, 16.03.2001

Kuvendi i Komunës së Gjilanit

Kryetari i Kuvendit,
Lutfi Haziri



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Në bazë të nenit 3.1, pika b dhe d, të Rregullores mbi vetëqeverisjen e komunave të Kosovës, UNMIK- RREG/ 2000/45 dhe nenit 12, pika b dhe e , Statutit të Komunës së Gjilanit, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e vetë të mbajtur më 16.03.2001 bie këtë:

Vendim

**MBI VAZHDIMIN E AFATIT TË VLEFSHMËRISË SË PLANIT GJENERAL DHE
PLANEVE DETALE URBANISTIKE TË QYTETIT TË GJILANIT**

I

Me këtë vendim i vazhdohet afati i vlefshmërisë së vendimit mbi miratimin dhe zbatimin e planit Gjeneral Urbanistik të Qytetit të Gjilanit, i publikuar në “Gazetën Zyrtare të Kosovës “ nr.21/81.

II

I vazhdohet afati i vlefshmërisë të vendimeve për miratimin dhe zbatimin e Planeve Detale Urbanistike të miratuara në bazë të PGJU, nga pika I e këtij vendimi, për vendbanimeve e qytetit të Gjilanit, dhe atë:

- a) PDU- ish “ pjesa e vjetër e Qytetit”.
- b) PDU- ish” Kamnik
- c) PDU- ish “ Gavran I dhe II
- d) PDU- ish “ Banja”
- e) PDU- ish “ Dheu I bardhë I dhe II
- f) PDU- ish “ Popovica I dhe II,
- g) PDU- ish “Spitali Regjional- Jugopetroll “ dhe
- h) PDU- ish “ Qenar Qeshme I dhe II”.

III

Afati i vlefshmërisë të planeve nga pika I dhe II të këtij vendimi, do të jetë në fuqi deri me aprovimin e Planit të ri gjeneral Urbanistik, respektivisht planeve të tjera detale urbanistike të vendbanimeve përkatëse ose vendimit me të cilin ato plane plotësohen ose ndryshohen.

IV

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Urbanizëm, Rindërtim dhe Ambiente dhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronësi të Komunës së Gjilanit.

V

Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit

Nr. 01.1423/020
Gjilan, 16.03.2001

Kryetari i Kuvendit
Lutfi Haziri



KOMUNA E GJILANIT OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Në bazë të nenit 24 paragrafi 3 të ligjit mbi planifikimin e hapësirës, “Gazeta Zyrtare e Kosovës”, nr, 2/89) dhe nenit 3 të ligjit mbi tokën ndërtimore. “Gazeta Zyrtare e Kosovës”, nr. 14/80 dhe nenit 12 pika b dhe c të Statutit të Komunës së Gjilanit.
Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e vet të mbajtur më datë 11.04.2001 nxori këtë:

VENDIM

MBI VENDOSJEN E OBJEKTEVE TË PÛRKOHËSHME NË TERRITORIN E KOMUNËS SË GJILANIT

1) DISPOZITAT E PÛRGJITHSHME.

Neni 1

Me këtë vendim përcaktohen kushtet e përgjithshme në të cilat objektet montuese të cilat lehtë mund të lëvizin ose vendosen në tokën ndërtimore ose sipërfaqen publike në territorin e

Komunës së Gjilanit, e të cilat sipas planit Urbanistik nuk mund të vendosen si objekte të përkohshme.

Neni 2

Me objektet e përkohshme montuese në vështirim të këtij vendimi nënkuptojmë: barakat montuese për shitjen e artikujve ushqimor, kiosqet për shitjen e duhanit, shtypit, suvenireve, lotarisë, bizhuterisë, luleve dhe mallrave të ngjashme objekteve montuese për ushtrimin e veprimtarisë zejtare-shërbyese objektet për lojëra zbavitëse garazhet montuese, barakat për vendosjen e anëtarëve dhe objektet tjera të ngjashme.

Objektet më të vogla të cilat lehtë janë të lëvizshme janë pajimet për shitjen e akulloreve dhe gjellërave të imta freskuese dhe ushqimore aparatet për pomfrit, petulla, hamburgerë, denerë, kupa etj. Tavolinat shitëse para shitoreve, tavolinat shërbyese të kafiterive, çajtove, tavolinat lëvizëse për shitjen e lotos dhe lojërave me fat, uresave dhe tabelat reklamuese e të ngjashme, lojërat për fëmijë etj.

Neni 3

Me tokë ndërtimore në vështirim të këtij vendimi nënkuptojmë tokën e cila është e përfshirë me planin gjeneral urbanistik të Qytetit të Gjilanit dhe është miratimi mbi caktimin e zonës ndërtimore në fshatra.

Me sipërfaqe publike nënkuptojmë tokën në pronësi shtetërore e cila shfrytëzohet ose është e dedikuar për përvojat e përgjithshme shoqërore.

II- VENDOSJA E OBJEKTEVE TË PËRKOHSHMË

Neni 4

Objektet nga neni 2 i këtij vendimi mund të vendosen si më poshtë:

- Që me vendosje të mos pengohet qarkullimi i lirë i këmbësorëve.
- Që në udhëkryq dhe kënde të rrugës të mos e zvogëlojë dhe të mos rrezikojnë sigurinë e komunikacionit.
- Që të mos vendosen mbi gropat kyçëse dhe kontrolluese të objekteve të infrastrukturës komunale nëntokësore, (kanalizimi, ujësjellës, elektrikë, PTT etj). Dhe kanalet dhe vijat rrjedhëse të ujit.
- Që të mos pengojë shikueshmërinë dhe komunikimin me vlerat historike, monumentale dhe ambientale.
- Që objekti të përputhet në tërësi arkitektonikë të kompleksit.
- Që objekti skaj rrugës të kategorizohet të jetë në largësi të paraparë.
- Që objekti i vendosur të mos jetë pengesë për komunikim normal të objekteve tjera.

Neni 5

Madhësinë dhe pamjet estetike të objektit si dhe kushtet tjera teknike-Urbanistike për vendosjen e objekteve e cakton Drejtoria për Urbanizëm, rindërtim dhe ambient e Komunës së Gjilanit.

Objekti duhet të jetë i konstruksionit të tillë që lehtë dhe shpejtë të montohet- demontohet. Kërkesës për dhënie e pëlqimit Urbanistik, investuesi duhet të ia bashkëngjisë edhe planin titucional të tokës në të cilën do të vendoset objekti si dhe pasqyrën skematike të rrugës-lokacionit me vendin e shënuar ku dëshiron ta vendosë objektin.

III . DHËNJJA E TOKËS NË SHFRYTËZIM TË PËRKOHSHËM.

Neni 6

Toka në pronësi shtetërore për vendosjen e objekteve të karakterit të përkohshëm epet me qira.

Në lokalitet e parapara për vendosjen e objekteve të karakterit të përkohshëm, toka epet me qira përmes konkursit ose ankandit publik të cilin e shpallë dhe e zbaton komisioni të cilin e zgjedhë Kuvendi i Komunës.

Kontrata mbi qiranë lidhet me organin kompetent dhënien e lejes për vendosjen e objektit të karakterit të përkohshëm.

Kontrata duhet të përmbajë të gjitha elementet për vendosjen dhe largimin e objektit të karakterit të përkohshëm të bazuar në këtë vendim.

Neni 7

Kontrata nga neni paraprak lidhet për kohë të caktuar , afati I së cilës nuk mund të jetë më i gjatë së 5 vite.

Para skadimit të afatit nga paragrafi paraprak, pronari ose shfrytëzuesi I objektit mund të kërkojë vazhdimin e kontratës, nëse I përmbushë edhe kushtet tjera të parapara me këtë vendim dhe dispozitat tjera pozitive në fuqi.

Neni 8

Pronarët- shfrytëzuesit e objekteve të përkohshme ekzistuese të vendosura me ose pa leje deri në momentin e hyrjes në fuqi të këtij vendimi janë, të obliguara që në afatin prej 30 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij vendimi të lidhin kontratë mbi qiranë e tokës, në rast se dëshirojë që edhe më tutje tokën në të cilën është vendosur objekti i tillë.

Neni 9

Toka për vendosjen e objekteve të përkohshme ju jepet personave fizik nen këto kushte:

- Që të mos ketë në pronësi individuale ose shtetërore lokal tjetër afaristë ose lokal të tipit montues të karakterit të përkohshme.
- Që të mos jetë në marrëdhënie pune
- Që veprimtarinë e vet ta kryej gjatë orarit të rregullt të punës.
- Që të posedojë kualifikim përkatës për ushtrimin e asnjë veprimtarie dhe
- Që personalisht ta shfrytëzojë objektin në fjalë.

IV. KOMPENZIMI PËR SHFRYTËZIMIN E TOKËS

Neni 10

Për vendosjen e objekteve të përkohshme montuese, në sipërfaqe publike, paguhet kompensimi vjetor dhe sipas m2, të sipërfaqes së tokës në të cilën është vendosë objekti.

I.- për objekte në sipërfaqe deri 30 m2

- 1) Zona e I-të.....120. DM/1.m2,
- 2) Zona e II-të.....100 DM/1.m2
- 3) zona e III-të80 DM / 1.m2
- 4) në fshatra20 DM/1.m2

I/a për objekte me sipërfaqe mbi 30, m2. paguhet shuma 80% nga shuma nen pikën I.

I/b për objektet të cilat nuk I shërbejnë veprimtarisë afariste që janë :paguhet shuma 50% nga shuma nën pikën I.

Për objekte lëvizëse të vendosura në sipërfaqe, druve – thëngjillit kompensimi ditor si vijon:

II. - lloji I objekteve

Z o n a t

- | | | |
|--|-----|----------------|
| 1) kafiteritë : tavolinë.....2 | 1.5 | 1. DM /1 ditë |
| 2) ëmbëltore-çajto: 1. tavolinë.....1.5 | 1 | 0.50 DM/1 ditë |
| 3) tavolinat – tezgat bashkangjitur lokaleve 1 m2..... 2.5 | 2 | 1.30.DM/1ditë |
| 4) frigoriferët për akulllore..... ..2.5 | 2 | 1.50.DM/1ditë |
| 5) aparatet për dener dhe qebap etj.....10 | 8 | 5.DM/1ditë |
| 6) aparatet për pomfrit, petulla etj.....3 | 2 | 1.DM/1ditë |

7) tavolinat për loto, uresa etj.....1 m2.....2.....2.....1.DM/1ditë

8) lojërat e fëmijëve, sipërfaqe. Minimale 100 m2= 0,25 DM/ 1 m2 në ditë.

Neni 11

Kompensimin nga paragrafi 1 dhe 2 të nenit 10. janë të obliguara ta paguajnë paraprakisht për çdo muaj secili shfrytëzues I tokës- sipërfaqes publike.

Kompensimi paguhet në llogari të Komunës së Gjilanit me dedikim për rregullimin e tokës ndërtimore.

Neni 12

Për vendosjen e objekteve montuese në oborrin e vet, investuesi paguan kompensimin në shumë të njëjtë si në nenin 10. të këtij vendimi me përjashtim që kompensimi paguhet vetëm me rastin e vendosjes së objektit e jo çdo muaj.

Neni 13

Kompensimin nga neni 11, të këtij vendimi nuk do të janë të obliguara ta paguaj shoqatat e invalidëve të luftës, të të verbërve, të shurdhmemecëve, të hendikepuarve e të ngjashme, nëse objektet i shfrytëzojnë ekskluzivisht për nevoja të veta.

V. DHËNJIA E LEJES

Neni 14

Objektet nga neni 2 i këtij vendimi nuk mund të vendosen pa leje paraprake të organit kompetent.

Lejen për vendosjen e objektit e lëshon Drejtoria për Urbanizëm , rindërtim dhe Ambient e Komunës së Gjilanit.

Investuesi është i obliguar që në kërkesë të caktojë dhe definojë se për çfarë dedikimi kërkon vendosjen e objektit si dhe të cilën veprimtari do ta ushtrojë në të.

Neni 15

Së bashku me kërkesën për vendosjen e objektit, investuesi duhet të parashtrijë edhe:

- 1) kontrata mbi qesimin ose dëshminë tjetër valide mbi të drejtën e pronësisë ose të drejtën e shfrytëzimit të tokës në të cilën kërkon vendosjen e objektit.
- 2) Kopjen e planit me konstatim të organit kompetent për pëlqimin dhe kushtet e vendosjes së objektit.
- 3) Plan situacional të tokës me pasqyrën sistematike të rrugëve dhe objekteve ekzistuese të afërta.
- 4) Projektin ose prospektin e objektit në dy kopje, në të cilën është caktuar nga organi kompetent.
- 5) Pëlqimin e organeve tjera, nëse me dispozita të veçanta është paraparë dhe
- 6) Dëshminë mbi pagimin e kompensimit në emër të rregullimit të tokës në të cilën vendoset objekti.

Neni 16

Objekti duhet të vendoset në lokacionin dhe pozitën në të cilën është caktuar nga organi kompetent.

Ndalohet zhvendosja dhe largimi nga lokacioni I caktuar, ndërrimi I objektit me objekt tjetër, shitja, dhënia me nënqesim , ndryshimi I sipërfaqes, ndërrimi i veprimtarisë së lejuar me vendim dhe veprimet tjera jashtë kushteve të përcaktuara me leje.

Neni 17

Pronarët- shfrytëzuesit e objekteve ekzistuese të vendosura deri ne hyrjen në fuqi të këtij vendimi, nëse janë të vendosura pa leje, jashtë kushteve të lejes së lëshuar si dhe atyre që iu ka skaduar afati i lejes, janë të obliguara që në afat prej 30 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, nga organi kompetente të kërkojë harmonizimin e objekteve dhe lejes paraprake me dispozitat e këtij vendimi.

Neni 18

Leja për vendosjen e objektit duhet të përmbajë:

- 1) shënimet mbi pronarin – shfrytëzuesin të cilit I lejohet vendosja e objektit.
- 2) Shënimet elementare mbi objektin (lloji, madhësia , dedikimi, veprimtaria që ushtrohet e të ngjashme).
- 3) Shënimet mbi tokën në të cilën vendoset objekti.
- 4) Pëlqimin e dhënë urbanistik nga organi kompetente dhe organet tjera dhe
- 5) Afatin shënjes dhe afatin e vlefshmërisë së lejes.

Neni 19

Leja pushon të vjelë nëse vendosja e objektit nuk kryhet në afatin e paraparë.

Afati nga paragrafi paraprak nuk mund të jetë më I shkurtë se 10 ose më I gjatë se 30 ditë nga dita e lëshuarjes së lejes.

Neni 20

Kontrollimin gjatë vendosjes së objektit dhe kontrollimin përfundimtarë e bënë Drejtoria për urbanizëm, rindërtim dhe ambient të KK-ës Gjilan.

VI. LARGIMI I OBJEKTIT

Neni 21

Procedurën rreth largimit të objekteve nga neni 21 të këtij vendimi do ta udhëheqë dhe zbatojë Drejtoria për urbanizëm, rindërtim dhe ambient e KK-ës Gjilan, nëse:

- 1) objekti është I vendosur në kundërshtim me nenin 2 të këtij vendimi.
- 2) Paraqitet nevoja për përgatitjen e rregullimit të tokës dhe ndërtimin e objekteve të parapara me plan urbanistik.
- 3) Ka kaluar afati I paraparë me kontratën mbi qiranë – shfrytëzimin e tokës, ndërsa shfrytëzuesi nuk ka parashtruar kërkesë për vazhdimin e sajë.
- 4) Vije deri te prishja ose pushimi I kontratës.
- 5) Shfrytëzuesi I objektit, ekzistues në afatin e paraparë me këtë vendim:
 - nuk lidhë kontratë të re mbi qiranë- shfrytëzimin e tokës.
 - Nuk parashtron kërkesë për harmonizimin e objektit të përkohshëm me kushtet e parapara me këtë vendim ose kërkesa e tij është refuzuar me vendim të organit kompetent
 - Nuk e paguan qiranë për shfrytëzimin e tokës më gjatë se 3 muaj.

Neni 22

Me aktvendim nga neni paraprak do të caktohet afati I largimit të objektit I cili në rastet nga pika 1,2,3 dh 4, nuk mund të jetë më I shkurtë së 3 dhe më I gjatë së 15 ditë, ndërsa në rastin nga pika 5 më gjatë se 30 ditë.

Neni 23

Ankesa kundër aktvendimit nga neni 22 e këtij vendimi nuk e shtynë ekzekutimin e të njëjtit.

Neni 24

Nëse shfrytëzuesi ose pronari nuk e largon objektin e paraparë, largimi do të bëhet në mënyrë të dhunshme, në llogari dhe shpenzime të tij.

Shfrytëzuesi ose pronari I objektit të larguar nuk ka të drejtë në kompensim të shpenzimeve dhe në sigurimin e hapësirës tjetër me qëllim të vendosjes së objektit të njëjtë ose objektit tjetër.

VII. DISPOZITAT NDËSHKIMORE

Neni 25

Me gjobë në shumë prej 1000, deri në 3000 DM, për kundërvajtje do të dënohet qytetari.

- 1) nëse vendimin e objektit e bënë pa u pajisur paraprakisht me leje përkatëse nga organi kompetent.
- 2) Nëse nuk e rrënon- largon objektin në afatin I cili iu ka caktuar
- 3) Nëse objektin nuk e shfrytëzon për dedikimin e caktuar me leje dhe
- 4) Nëse pronari I objektit ekzistues nuk e lidhë kontratën mbi qiranë –shfrytëzimin e tokës dhe nuk bënë harmonizimin e objektit me dispozitat e këtij vendimi në afatin e paraparë.

Nëse kundërvajtjen nga pika 1 e këtij neni e kryen personi juridik do të gjobitet në shumë në shumë prej 3000, deri në 5000 DM.

Neni 26

Mjetet e grumbulluara nga neni 25 të këtij neni do të paguhen në llogari të buxhetit të KK-ës Gjilan.

VIII. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 27

Mbi zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për urbanizëm, rindërtimi dhe ambient e Komunës së Gjilanit dhe Drejtoria për Gjeodezi , Kadastër dhe Pronësi e KK-ës Gjilan.

Neni 28

Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohen të gjitha vendimet e mëparshme mbi vendosjen e objekteve të përkohshme të Komunës së Gjilanit.

Neni 29

Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit.



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Në bazë të nenit 24 të ligjit mbi planifikimin dhe rregullimin e hapësirës (“Gazeta Zyrtare e Kosovës”). Nr. 2/89), nenit 12 pika c dhe d të Statutit të Komunës së Gjilanit dhe nenit 18 të vendimit mbi ndërtimin e objekteve ndërtimore në territorin e Komunës së Gjilanit, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e vet të mbajtur më 11.04.2001 nxori:

VENDIM

MBI KUSHTET E POSAQME PËR DHËNIEN E LEJES SË NDËRTIMIT DHE LEJES SË PËRDORIMIT PËR OBJEKTE TË CAKTUARA.

I.. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Me këtë vendim rregullohen kushtet e veçanta për dhënien e lejes së ndërtimit për objekte, respektivisht pjesë të objekteve të ndërtuara pa leje, në rajonin I cili me planë Urbanistik është paraparë për ndërtimin e objekteve të atij lloji dhe dedikimi, përcakton statutin e objekteve të ndërtuara pa leje në rajonin I cili me planë urbanistik nuk është paraparë për ndërtimin e objekteve të tilla, respektivisht në rajonin për të cilin nuk është nxjerrë plani urbanistik si dhe kushtet për dhënien e lejes së përdorimit.

Neni 2

Leja e ndërtimit epet në përputhje me këtë vendim për të gjitha objektet e ndërtuara pa leje ndërtimore, të cilat mund të harmonizohen me rregullativën ndërtimore dhe kushtet tjera të

parapara të ndërtimit, pavarësisht nga dedikimi si dhe për objekte të rekonstruara dhe të shtuara pa leje ndërtim.

Leja e përdorimit në pajtim me këtë vendim do të epet edhe për objektet për ndërtimin e të cilave është dhënë leja e ndërtimit, e të cilat shfrytëzohen pa leje të përdorimit.

Leja e përdorimit në pajtim me këtë vendim do të epet edhe për objektet e ndërtuara me leje ndërtimi, e të cilat ka mospërputhje të vogla në kuadër të gabaritit dhe katësis së lejuar nga dokumentacioni teknik në bazë të të cilit është lejuar ndërtimi, nëse i plotëson kushtet tjera për shfrytëzimin e të njëjtit, ndërsa shfrytëzohen pa leje të përdorimit.

Leja e ndërtimit në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni mund të epet edhe për objektet e ndërtuara dhe të rekonstruara deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij vendimi

Neni 3

Për objektet për të cilat duke pasur parasysh dedikimin dhe lokalitetin, nuk mund të harmonizohen me planin detal urbanistik, respektivisht ndodhen në rajonin për të cilin nuk është nxjerr një plan I tillë, do të epët leja e përkohshme ndërtimore nëse objekti nuk i përmbushë kushtet në aspekt të stabilitetit, sigurisë dhe mbrojtjes higjienë-sanitare.

Objektet nga paragrafi 1 i këtij neni, mund në bazë të lejes së përkohshme të shfrytëzohen deri në momentin e përgatitjes së tokës, realizimit të dedikimit të planifikuar, respektivisht deri në përcaktimin e përmbushjes së kushteve për harmonizimin e tillë me rregullimin urbanistik dhe kushteve tjera sipas planit përkatës të aprovuar.

II. PROCEDURA DHE MËNYRA E PËRCAKTIMIT TË OBJEKTEVE TË NDËRTUARA PA LEJE NDËRTIMI, RESPEKTIVISHT LEJE PËRDORIMI.

Neni 4

Drejtoria për Urbanizëm, Rindërtim dhe Ambient e Komunës së Gjilanit (në tekstin e mëtejme: organi kompetent), do të bëjë regjistrimin dhe incizimin Gjeodezik të objekteve nga neni 2 dhe 3 të këtij vendimi, do të vërtetojë se objekti ndërtimi dhe rikonstruimi i të cilit është kryer pa leje ndërtimi, i plotëson kushtet urbanistike dhe kushtet tjera të parapara si dhe a është I ndërtuar në pajtim me standardet dhe normativat teknike të parapara për objektet e llojit të tillë.

Për objektin e ndërtuar me leje ndërtimore, e I cili shfrytëzohet pa e siguruar lejen e përdorimit organi kompetent do të vërtetojë se a është ndërtuar në përputhje me dokumentacionin teknik në bazë të të cilit është lejuar ndërtimi dhe ai a i plotëson kushtet tjera për shfrytëzim.

Organi kompetent duhet të kryej edhe regjistrimin e objekteve në ndërtim e sipër.

Procedurën nga paragrafi 1,2, dhe 3 të këtij neni, organi kompetent do ta kryej në bazë të programit të cilin e bie Kuvendi i Komunës.

Neni 5

Procedurën nga neni 4, i këtij vendimi organi kompetent do ta zbatojë përmes komisionit të cilin ai vet e formon ose përmes organizatës dhe subjektit juridik, si dhe ndërmarrësit të regjistruar për punët e projektimit dhe ndërtimit të objekteve dhe punëve të inxhinieringut dhe ekspertizës në lëmin e ndërtimtarisë (në tekstin e mëtejme : Komisioni).

Shpenzimet e vërtetimit të përmbushjes së kushteve për dhënien e lejes së ndërtimit, respektivisht lejes së përdorimit i bartë pronari, respektivisht titullari I të drejtës së shfrytëzimit të objektit lartësinë e të cilave e përcakton organi kompetent, varësisht nga madhësia e objektit ndërlikueshmëria e instalimeve, pajimeve dhe lokacioni i objektit.

Organi kompetent me aktin e vet përcakton kriteret për caktimin e lartësisë dhe mënyrën e pagimit të shpenzimeve nga paragrafi 2 i këtij neni.

Neni 6

Komisioni, organit kompetent ia dërgon regjistrin e objektit dhe procesverbalin mbi plotësimin e kushteve për dhënien e lejes së ndërtimit, respektivisht lejes së përdorimit, në afatin e përcaktuar me aktin mbi formimin, respektivisht me kontratën mbi besimin e punëve.

Procesverbali nga paragrafi i këtij neni, përmban të dhënat mbi investitorin- pronarin e objektit të dhënat të përgjithshme mbi objektin (lokacionit, katësia, lloji i instalimeve, lloji i materialit të ndërtuar etj). Shënimet mbi shkallën e ndërtimit të objektit , mbi ekzistimin e dokumentacionit teknik në bazë të të cilit është ndërtuar objekti me mendimin profesional mbi përmbajtjes e tij, të dhënat mbi pajtimet komunale, kohën e ndërtimit dhe kohën e shfrytëzimit. Për objektin i cili shfrytëzohet, komisioni jep profesional nga prizmi i përmbushjes së kushteve të parapara ligjore dhe rregullativës përkatëse dhe eventualisht të metat që duhet të mënjanoen.

Regjistrimin e objektit, komisioni e bënë në formularin të cilin e përpilon organi kompetent. Organi kompetent, formularin nga paragrafi 4 të këtij vendimi do ta hartojë në afatin prej 30 ditësh nga dita e aprovimit të këtij vendimi.

III. LEJA E NDËRTIMIT DHE LEJA E PËRDORIMIT

Neni 7

Organi kompetent për objektin e ndërtuar pa leje ndërtimi për të cilin ekzistojnë kushtet urbanistike për dhënien e lejes, jep lejen urbanistike dhe lajmëron pronarin mbi objektin mbi kushtet tjera për dhënien e lejes së ndërrimit, respektivisht mbi dokumentacionin të cilin është i obliguar t'ia bashkangjes kërkesën për dhënien e lejes e posaçme.

- 1) llojin dhe sasinë e dokumentacionit teknik I cili I përshtatet gjendjes reale të objektit të ndërtuar.
- 2) Dëshminë mbi të drejtën e pronës, respektivisht shfrytëzimit të tokës ndërtimore
- 3) Dëshminë mbi të drejtën e pronës, respektivisht shfrytëzimit të objektit.
- 4) Dëshminë mbi rregullimin e marrëdhënieve të ndërsjella me subjektin e autorizuar për rregullimin e tokës ndërtimore.

Për dhënien e lejes së përdorimit, kërkesës i bashkëngjitet leja e ndërtimit.

Organi kompetent e cakton edhe afatin e parashtrimit të dokumentacionit të paragrafit 1 të këtij neni i cili nuk mund të jetë më I gjatë se gjashtë muaj nga dita e pranimi të lejes Urbanistike, respektivisht lajmërimin e përjashtimit ky afat mund të vazhdohet deri në përfundimin e procedurës së rregullimit të marrëdhënieve pronësore të pronës të tokës në të cilën gjendet objekti por më së shumti edhe 90 ditë.

Lejen urbanistike organi kompetent e jep pas zbatimit të procedurës së formimit të ngastrës ndërtimore, konform rregullativës së posaçme.

Neni 8

Dokumentacioni teknik nga neni 7, I këtij vendimi duhet të përmbajë: projektin ndërtimor-arkitektonik, projektin e elektro-instalimit, kanalizimit, ujësjellësit si dhe instalimeve makinerive nëse janë të ndërtuara, e nëse objekti nuk është i kyçur në rrjetin e ujësjellësit dhe kanalizimit, skemën dhe zgjidhjen tekniko-teknologjike për furnizimin me ujë dhe bartjen e ujërave të ndotura.

Për objektet për të cilat lejen e ndërtimit e jep organi I pushtetit qendror në nivel të Kosovës, përmbajtjen e dokumentacionit teknik e parasheh në fjalë.

Neni 9

Si dëshmi mbi të drejtën e pronësisë, respektivisht të drejtën e shfrytëzimit të tokës net ë cilën është ndërtuar objekti konsiderohet:

- 1) për objektin e ndërtuar në tokën në pronësi – certifikatën nga librat publike mbi regjistrimin e paluajtshmërisë ose kontratën mbi blerjen e tokës në të cilën ekziston e drejta e pronësisë e lidhur dhe e vërtetuar në gjykatë.
- 2) Për objektin e ndërtuar në pronësi të personit tjetër, respektivisht në të cilën të drejtën e shfrytëzimit e ka tjetër person vendimi I plotfuqishëm në të cilin është vërtetuar e drejta e pronësisë ose e drejta e shfrytëzimit të tokës e të cilën pasuri e ka fituar dhe siguruar në pajtim me dispozitat mbi marrëdhëniet pronësore.
- 3) Për objektin e ndërtuar në tokën urbane të qytetit aktin e organit kompetent të Komunës mbi vërtetimin e të drejtës të shfrytëzimit të asaj toke, në bazë të pronësisë në objektin e ndërtuar në atë tokë.
- 4) Për objektin e ndërtuar në tokën në pronësi shoqërore, kontratën mbi bartjen e të drejtës së pronësisë në atë tokë sipas kushteve të tregut, respektivisht aktin e organit kompetent të Komunës mbi vërtetimin e të drejtës së shfrytëzimit në pajtim me ligjin.

Vërtetimi i të drejtës së shfrytëzimit të tokës, në vërtetim të paragrafit 1. pika 3. dhe 4 të këtij neni në bazë të kërkesës së pronarit të objektit.

Neni 10

Komuna mund të parasheh kushte të veçanta, mbi mënyrën dhe afatin e pagesës së kompensimit të shpenzimeve për rregullimin e tokës ndërtimore për objektet nga neni 2. të këtij vendimi.

Si dëshmi mbi rregullimin e marrëdhënieve me subjektin kompetent i cili e rregullon tokën ndërtimore, në vështirim të këtij neni konsiderohet kontrata e lidhu me atë subjekt ose akti tjetër valid me të cilën janë rregulluar çështjet e pagesës së kompensimit e të cilës I bashkëngjitet edhe dëshmia mbi përmbushjen e obligimit.

Neni 11

Leja e ndërtimit, respektivisht leja e përdorimit mund të epet me kushtet e parapara me këtë vendim edhe për ndërtimin e dedikimit të hapësirës së përbashkët të ndërtesave në pronësi etazhe dhe shndërrimin e të njëjtës ne hapësirë për banim, me kusht që aktin e ndërrimit të dedikimit ta lëshoj orkani kompetent i Komunës.

Neni 12

Kur organi kompetent vërteton se objekti i cili shfrytëzohet, respektivisht i cili është i ndërtuar dhe përfunduar pa leje, ndërsa i plotëson kushtet urbanistike dhe kushtet tjera të parapara e sipas vlerësimit të komisionit i plotëson edhe kushtet për shfrytëzim leja e ndërtimit dhe leja e legalizimit respektivisht përdorimit mund të epen edhe me një aktvendim.

Për objektin e ndërtuar në bazë të lejes ndërtimore e I cili shfrytëzohet pa leje te përdorimit, ndërsa sipas konstatimit të komisionit I plotëson kushtet e parapara për shfrytëzim, organi kompetent do të jep lejen e përdorimit në afat prej 10 ditësh nga dita e pranimit të raportit të komisionit mbi plotësimin e kushteve te parapara.

Neni 13

Nëse sipas vlerësimit të komisionit, objekti I plotëson kushtet e parapara të ndërtimit, organi kompetent do ta njoftojë pronarin mbi të metat e konstatuara dhe do t'ia caktoj afatin në të cilin pronari I objektit është I detyruar qe punët e kryera t'i harmonizoj sipas standardeve të parapara dhe të dorëzoj dokumentacionin teknik dhe dokumentacionin tjetër të nevojshme për dhënien e lejes së ndërtimit, ky afat mund të jetë më I gjatë se një vit nga dita e pranimit të lajmërimit.

Në mënyrën nga paragrafi 1. të këtij neni organi kompetent do të veproj edhe në rastin kur objekti shfrytëzohet pa leje përdorimi, I cili është I ndërtuar në bazë të lejes ndërtimore, e i cili sipas vlerësimit të komisionit nuk I plotëson kushtet e parapara për shfrytëzim, me ç'rast afati I mënjanimi të mangësive nuk mund të jetë I gjatë se gjashtë muaj.

Neni 14

Organi kompetent në bazë të regjistrimit të objekteve në ndërtim e sipër, menjëherë do të nxjerrë aktvendim mbi ndërprerjen e punëve në ato objekte dhe do të caktojë afatin në të cilin pronari I objektit është I obliguar të pajiset me leje ndërtimi, e I cili afat nuk mund të jetë më I gjatë se 90 ditë nga dita e nxjerrjes së aktvendimit.

Leja e ndërtimit për objektet nga paragrafi 1, të këtij neni epet sipas kushteve të parapara me këtë vendim edhe për objektet ndërtimi I të cilave është kryer pa leje ndërtimi.

IV. RRËNIMI I OBJEKTIT.

Neni 15

Organi kompetent do të bëjë rrënimin e objektit nëse pronari respektivisht bartësit i të drejtës së shfrytëzimit ose investuesi:

- 1) pas marrjes së pëlqimit urbanistik dhe lajmërimit nga ana e organit kompetent në vështrim të pikës 1, të këtij vendimit, parashtron kërkesë për dhënien e lejes së ndërtimit në afatin e paraparë.
- 2) Nuk i harmonizon punët e kryera me kushtet e parapara dhe nuk e parashtron dokumentacionin teknik dhe dokumentacionin tjetër për dhënies së lejes së ndërtimit në afatin në të cilin e cakton organi kompetent në vështrime të pikës 1 të nenit 13 të këtij vendimi.
- 3) Nuk i përmbushë kushtet në vështrim të fitimit të së drejtës së pronësisë, respektivisht shfrytëzimit të tokës net ë cilën është ndërtuar objekti.
- 4) Nuk pajiset me leje ndërtimi për objektin në ndërtim në vështrim të nenit 14 të këtij vendimi dhe,
- 5) Nuk parashtron dëshmi mbi të drejtën e pronësisë, respektivisht të drejtën e shfrytëzimit të objektit.

Neni 16

Organi kompetent do të urdhërojë ndalimin e shfrytëzimit të objektit për të cilin pronari respektivisht bartësi I të drejtës së shfrytëzimit në afatin e paraparë nuk pajiset me leje përdorimi, respektivisht nuk I mënjanon mangësitë e konstatuara në vështrim të nenit 13. paragrafi të këtij neni vendimi.

V. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 17


Në bazë të aktvendimit nga neni 13 të këtij vendimi, pronari i objektit e fiton të drejtën për kyçje në rrjetin e ujësjellësit, kanalizimit, elektrikes dhe objekteve tjera të infrastrukturës Komunale, respektivisht të drejtën e shfrytëzimit të të njëjtave me pagesë të kompensimit në lartësi dhe kushte të cilat janë paraparë me rregullativen e posaçme të Komunës ose ndërmarrjeve përkatëse.

Në rast të rrënimin të objektit për të cilin është dhënë leja e përkohshme e ndërtimit me qëllim të realizimit të dedikimit të paraparë dhe planifikimit, pronari nuk ka të drejtë në kompensimin e vlerës së atij objekti.

Neni 18

Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit dhe do të aplikohet për të gjitha objektet e ndërtuara pa leje ndërtimi.

KUVENDI I KOMUNËS SË GJILANIT



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Në bazë të nenit 37.43 dhe 46 të ligjit mbi tokën ndërtimore, (Gazeta Zyrtare e Kosovës, nr 14/80 dhe 42/86), nenit 12 të vendimit mbi tokën ndërtimore të Komunës së Gjilanit,(“Gazeta Zyrtare e Kosovës” nr.29/86) dhe nenit 122 të Statutit të Komunës së Gjilanit, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e vet të mbajtur më datën 11. prill.2001, bie këtë.

VENDIM

MBI KOMPENZIMIN E RREGULLIMIT TË TOKËS NDËRTIMORE

Neni 1

Me këtë vendim përcaktohet lartësia për kompensimin për rregullimin e tokës ndërtimore në rajonin e qytetit të Gjilanit.

Kompensimin e paraparë me këtë vendim, janë të obliguara ta paguajnë të gjithë investuesit e ndërtimit të të gjitha llojeve, tipave dhe dedikimeve të objekteve, me rastin e marrjes së lejes së ndërtimit të objekteve të reja, respektivisht të lejes së legalizimit dhe lejes së përdorimit të objekteve ekzistuese të ndërtuara pa leje.

Neni 2

Bazat, masat dhe kriteret për caktimin e lartësisë së kompensimit për rregullimin e tokës ndërtimore në rajonin e qytetit të Gjilanit janë:

- shkalla reale e rregullimit të tokës ndërtimore
- përshtatshmëria për banim që ofron toka ndërtimore dhe
- programi I rregullimit të tokës ndërtimore.

Neni 3

Sipas kushteve në vështrim të nenit 2, të këtij vendimi toka ndërtimore e qytetit të Gjilanit ndahet në tri zona:

Zona e I-rë, përfshinë: pjesën e vjetër të qytetit, të paraparë me PDU,

Zona e II-të, përfshinë vendbanimet që kanë PDU, por nuk janë në zonën e I-rë,

Zona e III-të, përfshinë vendbanimet që janë Brenda PGJU të qytetit por nuk janë të përfshira në zonën e I-rë dhe II-të.

Neni 4

Lartësia e kompensimit të rregullimit të tokës ndërtimore, varësisht nga lloji, tipi dedikimi dhe zona përcaktohet si vijon dhe llogaritet në (m2 bruto), sipërfaqes së objektit.

Neni 5

Mjetet e grumbulluara sipas nenit 4, të këtij vendimi do të paguhen në llogari të Komunës së Gjilanit, me dedikim të posaçëm për rregullimin e tokës ndërtimore në bazë të programit të rregullimit të aprovuar nga Kuvendi i Komunës së Gjilanit.

Programi nga paragrafi 1 i këtij neni duhet të përfshijë:

- 1) përgatitjen e tokës për ndërtim dhe
- 2) ndërtimin e objekteve të infrastrukturës Komunale dhe instalimeve për shfrytëzim dhe konsum të përbashkët.

Neni 6

Përfshirim nga obligimet për kompensimin e rregullimit të tokës ndërtimore, në vështirësi të nenit 1, paragrafi 2, të këtij vendimi, bëjnë objektet investues I të cilave janë institucionet shtetërore të Kosovës TMK, institucionet dhe organet themeluese i të cilave është Komuna e Gjilanit, objektet e karakterit të përgjithshëm shtetëror dhe shoqëror, objektet e infrastrukturës Komunale, mbrojtjes shëndetësore, sociale të arsimit, kulturës, rekreacionit dhe Sportit si dhe objektet fetare.

Neni 7

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Urbanizëm, Rindërtim dhe Ambient si dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa të KK-ës së Gjilanit.

Neni 8

Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit.

KUVENDI I KOMUNËS SË GJILANIT

Nr. 01-1892/020
Gjilan, 11.04.2001

Kryetari i Kuvendit
Lutfi Haziri



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më datë 29.06.2001, e duke u bazuar në nenin 12 alineja 1 pika (c) të Statutit të Komunës së Gjilanit nxori këtë:

VENDIM

**PËR LEJIMIN E EKSPLOATIMIT TË PÛRKOHSHËM TË RESURSEVE
NATYRORE.**

-I-

I lejohet N.P” 10 VËLLËZËRIT” nga Fshati Uglarë eksploatimi i përkohshëm i resurseve natyrore në ngastrën kadastrale nr.140, me kulturë- pyll e klasit të 5-të, fleta poseduese nr.60, KK-Uglarë, në vendin e quajtur “ klisura”, me sipërfaqe 01.03.57 Ha.

II

N.P “ 10 VËLLËZËRIT”, është e obligua ti i drejtohet Drejtorisë për Urbanizëm, Rindërtim dhe Ambient për Procedurën e nxjerrjes së lejes me komplet dokumentacionin e nevojshëm.

III

Lidhur me eksploatimin dhe kushtet tjera specifike do të lidhet kontrata e posaçme me përfaqësuesi të Kuvendit të Komunës.

IV

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

Nr. 01-3619/020
Gjilan, 29.06.2001

Kryetari i KK-ës
Lutfi Haziri



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më datë 29.06.2001, e duke u bazuar në nenin 12 alinea 1 pika (ë) dhe nenin 15 të Statutit të Komunës së Gjilanit nxori këtë:

VENDIM
PËR LEJIMIN E VENDOSJES SË BLETORËS

I

I lejohet Z. Metush Maksutit nga fshati Cërnicë, vendosja e përkohshme e Bletores në ngastrën kadastrale nr.1594, fleta poseduese nr. 442, Komuna kadastrale- Cërnicë, në sipërfaqe në sipërfaqe prej 00.50.00 Ha, në vendin e quajtur Kolibisht.

II

Z. Metush Maksuti, tokën në pronësi shoqërore nga pika I e këtij vendimi mund ta shfrytëzojë vetëm për zhvillimin e veprimtarisë së Bletores në të kundërtën e humb të drejtën e shfrytëzimit.

III

Z. Metush Maksuti për procedurën e mëtejme duhet të i drejtohet Drejtorisë për Urbanizëm, Rindërtim dhe Ambient.

IV

Detajet e dhënies në shfrytëzim e tokës nga pika I e këtij vendimi do të precizohen me kontratë të veçantë.

V

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

Kuvendi i Komunës- Gjilan

Nr. 01-3625/020
Gjilan, 29.06.2001

Kryetari:
Lutfi Haziri



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Në bazë të nenit 12, pika (ë) dhe (n) të Statutit të Komunës së Gjilanit, në propozim të Komitetit për Politikë dhe Financa, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në mbledhjen e mbajtur më 31.08.2001, bie këtë:

VENDIM
PËR ANULIMIN E KOTRATËS MBI CEDIMIN E TOKËS NDËRTIMORE DHE
FORMIMIN E KOMISIONIT PËR VLERSIMIN E INVESTIMEVE

I

Anulohet kontrata Nr.463-9/97 të datës 24.02.1997 (protokoli i “Moravës së Binqës”) dhe nr.2/97 të datës 24.02.1997 (protokoli i “AS-ingeniering”), me të cilën kontratë bëhet cedimi i tokës ndërtimore nga ish –pronari juridik KK- Gjilan në pronarët e rinj ndërmarrjen “AS-ingeniering” – Gjilan dhe ndërmarrjen “Morava e Binqës”- Gjilan proporcionalisht nga 50% apo (nga ½) e sipër. Së përgjithshme të tokës ndërtimore prej 03.32.44 Ha. Mbi cedimin e tokës ndërtimore nga pronari i mëparshëm KK- Gjilan në shfrytëzuesin e rinj nga 50% (nga ½) ndërmarrjes “Morava e Binqës” - Gjilan dhe ndërmarrjes “AS-ingeniering” Gjilan, të këtyre palujtshmërive:

1. Ng.kad.- nr.3304;fl.posed.nr.2593 KK-Gjilan, sip.01.26.80 Ha.
2. Ng.kad.-nr. 3299; fl.posed. nr.3299 KK-Gjilan. Sip.01.59.86 Ha.
3. Ng..kad.-nr.3300;fl.posed. nr. 3300.KK- Gjilan, sip. 00.25.00. Ha.
4. Ng.kad. –nr. 3302.fl;posedo.nr.1736. KK-Gjilan, sip.00.20.78.Ha.

II

Formohet komisioni për vlerësimin dhe analizimin e investimeve të përgjithshme në pjesët e ngastrave kadastrale nr.3300.3302. dhe 3304. KK-Gjilan në përbërje:

- 1) Xhemajl Hyseni
- 2) Murat Hoxha
- 3) Habib Mahmuti
- 4) Shefik Kurteshi
- 5) Azem Mujku
- 6) Hetem Bajrami
- 7) Nehat Sherif

III

Komisioni do t'i propozojë Kuvendit të Komunës përmes Komitetit për Politikë financa pranë KK-Gjilan, Solucionin për objektin në fjalë.

IV

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryeshefi ekzekutiv –KK- Gjilan dhe Drejtorit përkatëse.

V

Ky vendim hynë në fuqi ditën e miratimit

Kuvendi i Komunës – Gjilan

Nr.01.5430/10
Gjilan, 31.08.2001

Kryetari i KK-ës
Lutfi Haziri



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më datë 31.08.2001, e duke u bazuar në nenin 45 alineja 4 pika (ii) të Statutit të Komunës së Gjilanit, nxori këtë:

VENDIM
PËR LEJIMIN E NDRYSHIMIT –PËRPUNIMIT TË PLANIT DETAL URBANISTIK

I

Lejohet ndryshimi – përpunimi I Planit Urbanistik (PDU) në vendin e quajtur “ BANJA” e Qytetit, në parcelën nr. 2080, 2083,2088,2089 dhe 2085, fleta poseduese nr. 1750, KK- Gjilan, për nevojat e ndërmarrjes “ Hidroteknika” në Gjilan.

II

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Urbanizëm, Rindërtim dhe Ambient dhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.

III

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS – GJILAN

Nr. 01.5434/10
Gjilan, 31.08.2001

Kryetari i KK-ës
Lutfi Haziri



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Në bazë të nenit 13.par.2. nenit 23,24,25 dhe 45 të Ligjit mbi Planifikimin dhe rregullimin e hapësirës (Gazeta Zyrtare e Kosovës “), nr. 2/89), dhe nenit 12 pika (b) të Statutit të Komunës së Gjilanit, Kuvendi i Komunës së Gjilanit, në Seancën e vet të mbajtur më 31.08.2001 bie këtë:

VENDIM
MBI QASJEN E NDRYSHIMIT DHE PLOTËSIMIT TË PLANIT TË
PËRGJITHSHËM URBANISTIK TË QYTETIT TË GJILANIT

I

Me këtë vendim lejohet qasja për ndryshimin dhe plotësimin e Planit të Përgjithshëm Urbanistik të Qytetit të Gjilanit, (në tekstin e mëtejme: PPU).

II

PPU i Qytetit të Gjilanit, duhet të përfshijë Komunën Kadastrale të Gjilanit dhe disa pjesë të të gjitha Komunave Kadastrale që kufizohen me komunën kadastrale të qytetit të Gjilanit.

III

Bartës I përgatitjes së hartimit të ndryshimit dhe plotësimit të PPU, është Bordi i Drejtorëve i Kuvendit të Komunës së Gjilanit në propozim të Drejtorisë për Urbanizëm, Rindërtim e Ambient dhe Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.

IV

Bartës i të drejtës së hartimit të ndryshimit dhe plotësimit të PPU duhet të jetë ndërmarrja e autorizuar dhe e kualifikuar për hartimin e PPU të cilës punët do ti besohen në bazë të procedurës mbi cedimin e punëve, përmes tenderit.

V

Ndërmarrja e autorizuar të cilës do t’i besohen punët e hartimit të ndryshimit dhe plotësimit të PPU duhet të përgatisë.

- Detyrat programore të PPU,
- Afatet dhe dinamikën e realizimit të hartimit të planit,
- Propozimin për mjetet e nevojshme për hartimin e planit.

VI

Bordi i Drejtorëve, në bazë të detyrave programore do të përgatisë konstruksionin financiar për mjetet e nevojshme për hartimin e ndryshimit dhe plotësimit të PPU.

VII

Mbi zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Bordi i Drejtorëve i KK-ës së Gjilanit dhe Drejtoria për Urbanizëm, Rindërtim dhe Ambient.

VIII

Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit.

KUVENDI I KOMUNËS SË GJILANIT

Nr. 01.5425/10
Gjilan, 31.08.2001

Kryetari i Kuvendit
LUTFI HAZIRI



KOMUNA E GJILANIT OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Kuvendi i Komunës së Gjilanit në mbledhjen e mbajtur më datë 28.09.2001, e duke u bazuar në nenin 3.1 pika (ë), nenin 14.4 të Rregullores Nr. 2000/45 mbi Vetëqeverisjen e Komunave të Kosovës, dhe nenin 12 alineja 1 pika (ë) dhe nenin 48 alineja 4 të Statutit të Komunës së Gjilanit, nxori këtë:

VENDIM

I

REFUZOHEK kërkesa e Qendrës Regjionale për Punësim për të ndërtuar Qendrën e Trajnimeve Profesionale në hapësirën e Zyrës Regjionale për Punësim në Gjilan, me që kjo kërkesë është në disproporcion me Planin Detal Urbanistik të Qytetit të Gjilanit.

II

AUTORIZOHEK Drejtoria për Urbanizëm, Rindërtim dhe Ambient që për nevojat e Qeverisë Daneze e me qëllim të ndërtimit të Qendrës së Trajnimeve Profesionale të Caktojë një Lokacion të përshtatshëm për ndërtimin e kësaj Qendre I cili lokacion do të jetë në harmoni me planin Detal Urbanistik të Komunës së Gjilanit.

III

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Urbanizëm, Rindërtim dhe Ambient dhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.

IV

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit

KUVENDI I KOMUNËS – GJILAN

Nr. 01.6504/020
Gjilan, 28.09.2001

Kryetari i KK-ës
Lutfi Haziri



KOMUNA E GJILANIT OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më datë 30.11.2001, e duke u bazuar në nenin 3.1 pika (b) të Rregullores nr. 2000/45 mbi vetëqeverisjen e Komunave të Kosovës dhe nenin 12 alineja 1 pika (b) të Statutit të Komunës së Gjilanit, nxori këtë:

VENDIM
MBI NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE PËR HARTIMIN E PLANIT DETAL
URBANISTIK TË QYTETIT TË GJILANIT- ZONA PERENDIMORE

I

Me këtë vendim ndahen mjete financiare në shumë prej 100.000 DM për hartimin e Planit Detal Urbanistik të qytetit të Gjilanit- Zona perëndimore që përfshinë hapësirën në mes të rrugëve magjistrale Gjilan-Ferizaj respektivisht Gjilan- Prishtinë në sipërfaqe prej 250 Ha.

II

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Urbanizëm, Rindërtim dhe Ambient, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë dhe Drejtoria për Buxhet, Financa dhe Investime.

III

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS – GJILAN

Nr.01/7400/020
Gjilan, 30.11.2001

Kryetari i KK-ës
Lutfi Haziri



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më datë 30.11.2001, e duke u bazuar në nenin 3.1 pika (ë) të Rregullores nr. 2000/45 mbi Vetëqeverisjen e Komunave të Kosovës dhe nenin 12 alineja 1 pika (ë) të Statutit të Komunës së Gjilanit, nxori këtë:

VENDIM
PËR DHËNJEN E PRONËS KOMUNALE DHE PËLQIMIT TMK-ËS PËR
NDËRTIMIN E KAZERMËS NË GJILAN

I

Me këtë vendim epet prona komunale dhe pëlqimi TMK-ës, zona nr.6 (gjashtë) në Gjilan, për ndërtimin e kazermës, në ngastrën kadastrale 1382, fleta poseduese nr. 1742, numri i planit të skicës 8/24 me kulturë kullosë, klasa e tretë, në sipërfaqe prej 03.59.50 Ha, në vendin e quajtur “Zabeli i Sahit Agës”. Komuna Kadastrale Gjilan.

II

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë dhe Drejtoria për Urbanizëm, Rindërtim dhe Ambient.

III

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS- GJILAN

Nr, 01.7396/020
Gjilan, 30.11.2001

Kryetari i KK-ës
Lutfi Haziri



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më datë 30.11.2001, e duke u bazuar në nenin 3.1 pika (c) dhe (ë) të Rregullores nr. 2000/45 mbi vetëqeverisjen e Komunave të Kosovës dhe nenin 12 alineja 1 pika (c) dhe (ë) të Statutit të Komunës së Gjilanit, nxori këtë:

VENDIM
PËR DHËNJEN E PËLQIMIT PËR EKSPLOATIMIN E PËRKOHSHËM TË
RESURSEVE NATYRORE NGA VENDBURIMI “ GLLAMA” PËR NHNI “
MORAVA E BINQËS “- GJILAN

I

Me këtë vendim NHNI “ MORAVA E BINQËS”, nga Gjilani i epet pëlqimi për eksploatimin e përkohshëm të Resurseve natyrore- rezervave të gurit teknik ndërtimore, në ngastrën kadastrale Nr. 1261, fleta poseduese Nr.139, Komuna kadastrale Gjilan, në vendin e quajtur “ GLLAMA”, klasa e pestë dhe e shtatë me sipërfaqe të përgjithshme prej 102.40.22 Ha, dhe në ngastrën kadastrale Nr. 1/1, ½ dhe 1/3, fleta poseduese Nr. 1750, Komuna kadastrale Gjilan, në vendin e quajtur “ GLLAMA” me kulturë- kullosë- klasa e katërt, me sipërfaqe të përgjithshme prej 28.19.21 Ha.

II

Lidhur me eksploatimin dhe kushtet tjera specifike do të lidhet kontrata e posaçme me organin përkatës.

III

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Urbanizëm, Rindërtim dhe Ambient.

IV

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS- GJILAN

Nr, 01.7363/020
Gjilan, 30.11.2001

Kryetari i KK-ës
Lutfi Haziri



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më datë 30.11.2001, e duke u bazuar në nenin 3.1 pika (c) dhe (ë) të Rregullores Nr. 2000/45 mbi vetëqeverisjen e Komunave të Kosovës dhe nenin 12 alinea 1 pika (c) dhe (ë) të Statutit të Komunës së Gjilanit, nxori këtë:

VENDIM
PËR LEJIMIN E EKSPLOARIMIT TË RESURSEVE NATYRORE PËR
KOMPANIN “BELUSHI”

I

Me këtë vendim i lejohej Kompanisë “Belushi” nga fshati Uglarë, eksplorimi- kërkimi i resurseve natyrore në pjesën e ngastrës kadastrale Nr. 1830, fleta poseduese Nr. 203, Komuna kadastrale Kmetovc, vendi i quajtur Osoj, me sipërfaqe të përgjithshme prej 62.10.15. Ha.

II

Kompania “Belushi”, është e obliguar të i drejtohet Drejtorisë për Urbanizëm, Rindërtim dhe Ambient për procedurën e nxjerrjes së lejes së hulumtimit me komplet dokumentacionin e nevojshëm.

III

Lidhur me eksploatimin dhe kushtet tjera specifike do të lidhet kontrata e posaçme me organin përkatës.

IV

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Urbanizëm, Rindërtim dhe Ambient.

V

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS- GJILAN

Nr.01.7392/020
Gjilan, 30.11.2001

Kryetari i KK-ës
Lutfi Haziri



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Kuvendi i komunës së Gjilanit në mbledhjen e mbajtur më datë 29.03.2002, e duke u bazuar në nenin 3.1 pika (ë) të Rregullores nr 2000/45 mbi Vetëqeverisjen e Komunave të Kosovës dhe nenin 12 alineja 1 p (ë) dhe nenin 48 alineja 4 të Statutit të Komunës së Gjilanit, nxori këtë:

VENDIM
PËR LEJIMIN E VENDOSJES SË SHTYLLËS NË PRONË SHETETRORE

I

Me këtë vendim i lejohet Postës dhe Telekomunikacionit të Kosovës- Telekomit në Gjilan, vendosja e shtyllës (Konstruksionit) me lartësi 5 m në vendin e quajtur “ Osoj” ngastra kadastrale nr. 1761, fleta poseduese nr. 352, me kulturë – pyll, klasa e tretë. Pronë shtetërore, Komuna kadastrale – Dobërçan.

II

Vendosja e shtyllës për pajisje telekomunikuese dhe transmetuese në vendin e përshkruar në pikën I të këtij vendimi do të bëhen në lokacionin me dimensione (10x15)m, sipas zgjedhjes ideore të përshkruar në kërkesën e PTK-ës Telekomit i Gjilanit.

III

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Urbanizëm, Rindërtim dhe Ambient dhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.

IV

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS- GJILAN

Nr.01. 2445/020
Gjilan, 29.03.2002

Kryetari i KK-ës
Lutfi Haziri



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Kuvendi i Komunës së Gjilanit në mbledhjen e mbajtur më datë 29.03.2002, e duke u bazuar në nenin 3.1, pika (dh) dhe (ë) të Rregullores nr. 2000/45 mbi Vetëqeverisjen e Komunave të Kosovës dhe nenin 12 alineja 1 pika (dh) dhe (ë) të Statutit të Komunës së Gjilanit, nxori këtë:

VENDIM
PËR LEJIMIN E SHFRYTËZIMIT TË RESURSEVE NATYRORE

I

Me këtë vendim i Lejohet z. Vehbi Behlulit nga fshati Pasjak, shfrytëzimi I resurseve natyrore – Ujit të pijshëm, për nevojat e veta dhe të familjes së tij në pjesën e ngastrës kadastrale nr. 4841, fleta poseduese nr. 594, me kulturë- përrua, Komuna kadastrale Koretishtë, vendi I quajtur Pasjak- pronë shtetërore, me sipërfaqe prej 0.03.00 Ha nga sipërfaqja e gjithëmbarshme prej 2.06.35 ha.

II

Z. Vehbi Behluli është i obliguar të i drejtohet Drejtorisë për Urbanizëm, Rindërtim dhe Ambient për procedurën e nxjerrjes së lejes së shfrytëzimit të ujit të pijshëm me komplet dokumentacionin e nevojshëm.

III

Lidhur me shfrytëzimin dhe kushtet tjera specifike do të lidhet kontrata e posaçme me organin përkatës.

IV

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Urbanizëm, Rindërtim dhe Ambient Drejtoria për Gjeodezi kadastër dhe Pronë.

V

Ky vendim hyn në ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS - GJILAN

Nr. 01. 2446/ 020
Gjilan, 29.03.2002

Kryetari i KK-ës
Lutfi Haziri



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Në bazë të nenit 39 paragrafi 1 të Ligjit mbi Planifikimin dhe Rregullimin e Hapësirës (Gazeta Zyrtare e Kosovës nr. 2/89, nenit 44 pika q të Statutit të Komunës së Gjilanit, dhe Rekomandimit të Komitetit për Planifikim dhe Resurseve Natyrore të KK-ës Gjilan. Kuvendi i Komunës së Gjilanit, ne seancën e mbajtur me datë 29.03.2002, nxjerr këtë:

VENDIM

**MBI AUTORIZIMIN E ORGANIT PËR NDRYSHIME DHE PLOTËSIME TË
VOGLA TË PLANEVE DETALE URBANISTIKE TË QYTETIT TË GJILANIT**

Neni 1

Autorizohet Drejtoria për Urbanizëm, Rindërtim dhe Ambient e Komunës së Gjilanit që mund të bëjë ndryshime dhe plotësime të vogla të zgjedhjeve Urbanistike, caktimin e planeve dhe vijave të rregullacionit, të përfshira me Plan të Përgjithshëm, planeve Detale Urbanistike të Qytetit të Gjilanit si zgjedhjeve urbanistike dhe planeve të rregullacionit nëpër fshatra të Komunës së Gjilanit.

Neni 2

Me ndryshime dhe plotësime të vogla nga neni paraprak nënkuptojmë: ndërrimi i kateve, përcaktimin e gabaritit, radhitjen e objekteve në zonat industriale, dislokimin e vogël të trasesë, vijës së ndërtimit dhe rregullimit.

Neni 3

Ndryshimet dhe plotësimet nga neni paraprak duhet te inkorporohen në Planet përkatëse Urbanistike.

Neni 4

Mbi zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryeshefi Ekzekutiv i KK-ës së Gjilanit

Neni 5

Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit.

KUVENDI I KOMUNËS- GJILAN

Nr. 01. 2447/020
Gjilan, 29.03.2002

K R Y E T A R I
Lutfi Haziri



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Në bazë të nenit 29,38,42,45 dhe 47 të Ligjit mbi Planifikimin dhe Rregullimin e Hapësirës (Gazeta Zyrtare e Kosovës nr. 2/89), nenit 12 pika b të Statutit të Komunës së Gjilanit, Rekomandimit të Komitetit për Planifikim dhe Resurse natyrore të KK-ës Gjilanit, Kuvendi i Komunës së Gjilanit, në seancën e mbajtur më datë 29.03.2002, bie këtë:

VENDIM
MBI QASJEN E HARTIMIT TË PROPOZIM PROJEKTIT URBANISTIK TË PJESËS
SË RRUGËS QARKORE “JUGU-1” NË GJILAN

Neni 1

Me këtë vendim i qaset hartimit të projektit urbanistik të pjesës së rrugës Qarkore “JUGU -1, në Lagjen “ILIRIA” Gjilan, duke filluar nga kryqëzimi i rrugëve Gjilan – Preshevë. Afër Kombinatit të Tekstilit dhe Vazhduar në mes të TS. Gjilani-1 dhe fabrikës së Stabilimenteve Klimatike prerë rrugën Gjilan- “Zabeli i Sahit Agës”, lumen “Mirusha” deri në kthesën 45 shkallës të rrugës Gjilan- Malishevë afër Tregut të gjelbër në Gjilan, në gjatësi prej afro 1150 m.

Neni 2

Me Project do të parashiheshin: traseja e rrugës e paraqitur në mënyrë grafike, ngastrat kadastrale me shënime përcjellëse, zgjidhjet dhe qasjet komunikuese, ndërlihdja e tyre me gjendjen ekzistuese si dhe përmbajtjet tjera urbane dhe te infrastrukturës Komunale.

Neni 3

Projektin do ta kryej Drejtoria për Urbanizëm, Rindërtim dhe Ambient, ndërsa shënimet kadastrale, matjet dhe elaboratin e eksproprijimit Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Prone të Komunës së Gjilanit.

Neni 4

Projekti do të ekspozohet për shqyrtim publik, në vende publike- tabela të shpalljeve në Drejtorit nga neni 3 të këtij vendimi si dhe në tabelën e shpalljeve të ndërtesës së KK-ës së Gjilanit, me qëllim të dhënies së vërejtjeve, sugjerimeve dhe propozimeve nga palët e interesuara.

Shqyrtimi publik zgjatë 15 ditë nga dita e publikimit në tabelat e shpalljeve Brenda të cilit afat mund të paraqiten vërejtjet, sugjerimet dhe propozimet në formë të shkruar të cilat do të i dërgohen për shqyrtim komisionit profesional, i cili pas shqyrtimit të tërësishëm, jep mendimin profesional dhe propozim projektin me elabore ia dërgon Kryeshefit Ekzekutiv të KK-ës dhe Kuvendit për aprovim.

Neni 5

Mbi zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryeshefi Ekzekutiv i KK-ës së Gjilanit.

Neni 6
Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit.

KUVENDI I KOMUNËS – GJILAN

Nr. 01.2448/020
Gjilan, 29.03.2002

K R Y E T A R I
Lutfi Haziri



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën mbajtur më 03.06.2002, e në bazë të rekomandimit të Komitetit për Planifikim dhe resurse natyrore të datës 28.05.2002, nxori këtë:

VENDIM
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E VENDIMIT MBI NDËRTIMIN E
OBJEKTEVE NDËRTIMORE NË TERITORIN E KOMUNËS SË GJILANIT

I

Me këtë vendim ndryshimi dhe plotësimi i vendimit mbi ndërtimin e objekteve ndërtimore në territorin e Komunës së Gjilanit nr. 01.1425/020 i aprovuar më datë 16.03.2001, dhe atë:

- Në nenin 48, paragrafi 1. shuma prej “ 1000-3000 DM” zëvendësohet me shumën prej “ 500-1500” .
- Në nenin 48 paragrafi 2. shuma prej “3000-6000 DM”. zëvendësohet me Shumën prej “ 1500-3000 E”.
- Në nenin 49 paragrafi 1. shuma prej “ 1500-3000 DM”, zëvendësohet me shumën prej “750-1750”.
- Në nenin 49 paragrafi 1. pas pikës 7 shtohet pika 8. e cila thotë:

Ekzistuesi i punëve ndërtimore, personi juridik dhe fizik, që kryen punë ndërtimore pa iu siguruar leja e ndërtimit nga investitori, kryesi i punëve do të gjobitet në lartësi prej 20.000 E.

- Në nenin 49 paragrafi 2. shuma prej “3500-5000 DM” . zëvendësohet me shumën prej “ 1750-2500”.

II

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Urbanizëm, Rindërtim dhe Ambient dhe Drejtoria për Buxhet, Financa dhe Investime.

III

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS – GJILAN

Nr. 01.3781/020
Gjilan, 03.06.2002

K R Y E T A R I
Lutfi Haziri



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën mbajtur më 03.06.2002, e duke u bazuar në nenin 3.1 pika (ë) të Rregullores nr. 2000/45 mbi Vetëqeverisjen e Komunave të Kosovës dhe nenin 12 alineja 1 p. (ë) dhe nenin 48 alineja 4 të Statutit të Komunës së Gjilanit, nxori këtë:

VENDIM

PËR LEJIMIN E VENDOSJES SË TRANSMETUESIT TË TËLEVIZIONIT “ MEN “ NË PRONË SHETETRORE

I

Me këtë vendim i lejohet Televizionit “ MEN “ në Gjilan, vendosja e Transmetuesit (konstruksionit) në pjesën e sipërfaqes prej 116.99.16 ha, në vendin e quajtur “ Maja e Gjelhër “- ngastra nr. 2, fleta poseduese nr. 441, me kulturë – mal, klasa e tretë pronë shtetërore, Komuna kadastrale – Kufcë e Epërme.

II

Vendosja e konstruksionit për transmetim në vendin e përshkruar në pikën I të këtij vendimi do të bëhet në lokacionin me Dimensione (10x10)m , sipas zgjedhjes ideore të përshkruar në kërkesën e Televizionit “ MEN “. Në Gjilan.

III

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Urbanizëm, Rindërtim dhe Ambient dhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.

IV

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.
KUVENDI I KOMUNËS – GJILAN

Nr. 01. 3831/020
Gjilan, 03.06.2002

K R Y E T A R I
Lutfi Haziri



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Në bazë të nenit 14.26.27.42.43 dhe 45 të Ligjit mbi planifikimin dhe Rregullimin Hapësinor (Gazeta Zyrtare e Kosovës nr. 2/89) , nenit 12 pika b të Statutit të Komunës së Gjilanit, Kuvendi i Komunës së Gjilanit, në seancën e mbajtur më datë 08.07.2002, bie këtë:

VENDIM

mbi qasjen e hartimit të bazës së rregulluar urbanistike “ Zona Industriale” – ana e majtë përmbi rrugën magjistrale Gjilan- Bujanovc

Neni 1

Me këtë vendim i qaset hartimit të bazës së rregulluar urbanistike “ Zona Industriale” – ana e majtë përmbi rrugës magjistrale Gjilan- Bujanovc duke filluar nga brezi I rrugës qarkore përballë Fabrikës së Baterive NICD në Gjilan, deri te “ Bunari i Përlepnicsë”, respektivisht këndi i kyçjes së rrugës lokale të fshatit Përlepnice në rrugën magjistrale në një sipërfaqe prej afro 47 ha, kështu që me këtë hapësirë do të përfshiheshin objektet e ndërtuara industriale, ekonomike – afariste – tregtare dhe parashikohet mundësia e ndërtimit i objekteve të reja të destinimit të tillë dhe përmbajtjet tjera të karakterit të Infrastrukturës Komunale.

Neni 2

Gjatë hartimit të këtij plani do të respektoheshin aq sa do të jetë e mundur gjendja ekzistuese dhe do të parashiheshin mundësitë e lidhjeve komunikuese me objektet e infrastrukture ekzistuese dhe ato të planifikuara.

Neni 3

Financimi i këtij plani do të bëhet nga mjetet buxhetore të KK-ës Gjilan- pjesa e rregullimit të tokës ndërtimore, ndërsa hartimin e të njëjtit do ta kryente Sektori i Planifikimit dhe Rindërtimit i Drejtorisë për Urbanizëm, Rindërtim dhe Ambient i Komunës së Gjilanit.

Neni 4

Pas hartimit të Planit të Rregullacionit, Drejtoria për Urbanizëm dhe Ambient e Komunës së Gjilanit është e obliguar që të njejtin të ia dërgojë Komisionit për shikim publik me qëllim të aprovimit të të njëjtit.

Neni 5

Mbi zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Urbanizëm, Rindërtim dhe Ambient e Komunës së Gjilanit dhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronësi e KK-ës Gjilan.

Neni 6

Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit.

KUVENDI I KOMUNËS – GJILAN

Nr.01. 4732/020
Gjilan, 08.07.2002

Zv. KRYETARI
Xhemajl HYSENI



KOMUNA E GJILANIT OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Në bazë të neni 27,42,43,44 dhe 45 të Ligjit mbi Planifikimin dhe Rregullimin Hapësinor (“Gazeta Zyrtare e Kosovës”, nr.2/89), dhe nenit 12 pika b. dhe 44 pika i.i. të Statutit të

Komunës së Gjilanit, e në vështrim të Vendimit mbi qasjen e ndryshimit dhe plotësimit të Planit të Përgjithshëm Urbanistik të Qytetit të Gjilanit, nr. 01- 5425/020 prej 31.08.2002, Kuvendi i Komunës së Gjilanit, në seancën e mbajtur më datë: 04.10.2002 nxori këtë:

VENDIM

Mbi aprovimin e Planit Detal Urbanistik “ Zona Perëndimore” e qytetit të Gjilanit

Neni 1

Aprovohet Plani detaj Urbanistik “ Zona Perëndimore “ e qytetit të Gjilanit e cila përfshinë hapësirën në mes të rrugës magjistrale : Gjilan- Prishtinë dhe Gjilan- Ferizaj nga njëra anë dhe pjesën tjetër jugore të Kodrës së Dëshmorëve deri te disa pjesë lindore të fshatrave Livoq i Ultë dhe Livoq i Epërm duke përfshirë edhe disa pjesë të Komunave kadastrale të atyre fshatrave në sipërfaqe prej gjithsej: 300.0 ha, si dhe incizimin gjeodezik të sipërfaqeve prej 350.0 ha, I hartuar nga fakulteti I Arkitekturës dhe “ URBA “ nga Prishtina.

Neni 2

Elaborati nga neni paraprak i këtij vendimi, është i vërtetuar me vulën e Kuvendit të Komunës së Gjilanit dhe nënshkrimin e Kryetarit të Kuvendit të Komunës së Gjilanit dhe i njëjti përbëhet nga pjesa tekstuale dhe grafike.

- a. Pjesa tekstuale përmban : Arsyeshmërinë e aprovimit të Planit Detaj Urbanistik të lokalitetit “ Zona Perëndimore “ ndërsa.
- b. Pjesa grafike përmban : Planin sinkronik të organizimit hapësinor dhe rregullimit të hapësirës të lokalitetit “ Zona Perëndimore “.

Neni 3

Plani detaj Urbanistike nga neni 1. i këtij vendimi përbën dokumentin themelor për zbatimin e programit të rregullimit të hapësirës për këtë lokalitet, përcakton rrjetin e infrastrukturës , kushtet Urbanistiko- teknike dhe përmbajtjet tjera të nevojshme për realizimin e tij.

Neni 4

Për zbatimin e këtij plani do të kujdeset Drejtoria për Urbanizëm, Rindërtim dhe Ambient e Komunës së Gjilanit.

Neni 5

Ky vendim është pjesë përbërëse e planit të përgjithshëm Urbanistik të Qytetit të Gjilanit, (“Gazeta Zyrtare e Kosovës “ nr. 21/81).

Neni 6

Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit.

KUVENDI I KOMUNËS- GJILAN

Nr. 01. 8030/020
Gjilan, 04.10.2002

K r y e t a r i
Lutfi Haziri



KOMUNA E GJILANIT OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Në bazë të Rregullores së UNMIK-ut nr. 10/99, nenit 12 pika b. nenit 44 pika ç. Të Statutit të Komunës së Gjilanit dhe Rekomandimit të Komitetit për Planifikim dhe Resurse, Kuvendi i Komunës së Gjilanit, në seancën e mbajtur më 04.10.2002, bie këtë:

VENDIM

mbi lejimin e hartimit të planeve të rregullacionit për pjesë të caktuara të Qytetit të Gjilanit

I

Drejtorisë për Urbanizëm, Rindëritm dhe Ambient të Komunës së Gjilanit i **L e j o h e t** qasja e hartimit të Planeve të Rregullacionit për pjesë të caktuara të Qytetit të Gjilanit, me kusht që me këto plane do të përfshiheshin objektet e ndërtuara dhe parashikohet mundësia e ndërtimit të objekteve të reja të karakterit Urban dhe përmbajtjet tjera të infrastrukturës Komunale-banesore.

II

Gjatë hartimit të këtyre Planeve do të respektoheshin aq sa të jetë e mundur PDU-të ekzistuese harmonizimi me gjendjen faktike dhe do të parashiheshin mundësitë e lidhjeve dhe qasjeve Komunikuese me karakter dhe përmbajtjet që do të planifikoheshin.

III

Financimi i këtyre planeve do të bëhet nga mjetet buxhetore të KK-ës Gjilan- pjesa tjetër e tokës ndërtimore.

IV

Hartimin e këtyre planeve do ta kryente Sektori për Planifikim pranë Drejtorisë për Urbanizëm, Rindëritm dhe Ambient të Komunës së Gjilanit ose subjekti tjetër i regjistruar dhe kualifikuar për hartimin e tillë në përputhje me Ligjin.

V

Pas hartimit të planit të rregullacionit, Drejtoria për Urbanizëm, Rindëritm dhe Ambient është e obliguar që të njëjtin të ia dërgoj Komisionit Profesional për shikim me qëllim të zbatimit të Procedurës së diskutimit publik.

VI

Mbi zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryeshefi Ekzekutiv dhe Drejtoria për Urbanizëm, Rindëritm dhe Ambient e Komunës së Gjilanit.

VII

Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit

KUVENDI I KOMUNËS- GJILAN

Nr. 01.8032/020
Gjilan, 04.10.2002

K R Y E T A R I
Lutfi Haziri



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Në bazë të rregullores së UNMIK-ut, nr. 10/99, dhe nenit 12 pika b, dhe nenit 44 pika ç, të Statutit të Komunës së Gjilanit, Kuvendi i Komunës së Gjilanit, në seancën e vetë të mbajtur më datë 04.10.2002. bie këtë:

VENDIM

Mbi anulimin e Vendimeve mbi Plotësimet dhe ndryshimet e PGJU të Qytetit të Gjilanit dhe PDU-ve të vendbanimeve dhe Lokacioneve të Caktuara

Neni 1

Anulohen dhe nuk zbatohen vendimet mbi ndryshimet dhe plotësimet e Planit Gjeneral Urbanistik të Qytetit të Gjilanit dhe Planeve Detaj Urbanistike dhe Vendimet mbi aprovimin e PDU-të, të vendbanimeve dhe lokaliteteve të caktuara të qytetit të Gjilanit, dhe aktet juridike që rrjedhin nga ato vendime, e të cilat janë nxjerrë nga ish Kuvendi i Komunës së Gjilanit, organet dhe trupat e tija punuese në periudhën prej datës : 05.07.1990, deri më 12. 06.1999, dhe atë:

1. Vendimi mbi aprovimin ose ndryshimin dhe plotësimin e Planit Detaj Urbanistik “ Parku” i aprovuar në periudhën prej datës 05.07.1990 deri më 1998.
2. Vendimi mbi qasjen e hartimit të Plotësimit të PDU-ish “ Gavran” I. nr. 350-35 /98-01 prej 18.12/98, i shpallur në të ashtuquajturën “ Gazeta Zyrtare e Rrethit të Anamoravës” nr. 2/98 të datës 21.12.1998.
3. Vendimi mbi qasjen e ndryshimit të pjesës së PDU, vendi i quajtur “ Varre “, I. nr. 350-4/99-01 prej 17.03.99, i shpallur në të ashtuquajturën: “Gazeta Zyrtare e Rrethit të Anamoravës” . nr. 2/99, të datës 18.03.1999.
4. Vendimi mbi qasjen e hartimit të projektit Urbanistik për varrezat ortodokse në Gjilan. I. nr. 352-8/99, prej 17.03.99 , i shpallur në të ashtuquajturën: “ Gazetën Zyrtare të Rrethit të Anamoravës” nr. 2/99 të datës 18.03.1999.

Neni 2

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronësi dhe Drejtoria për Urbanizëm, Rindërtim dhe Ambient të Komunës së Gjilanit.

Neni 3

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS SË GJILANIT

Nr.01. 8031/020
Gjilan, 04.10.2002

K R Y E T A R I
Lutfi Haziri



KOMUNA E GJILANIT OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Duke u mbështetur në nenin 12 alineja 1 pika (ë), alineja 2 pika (p) dhe (t) të Statutit të Komunës së Gjilanit, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 27.03.2003, miratoi këtë:

V E N D I M PËR

CAKTIMIN E LOKACIONIT PËR VËNDOSJEN E SHTATORËS SË DËSHMORIT “AGIM RAMADANI”

I

Me këtë vendim caktohet lokacioni për vendosjen e Shtatores së dëshmorit “Agim Ramadani”.

II

Shtatorja e Dëshmorit “Agim Ramadani” do të vendosët në ngastrën kadastrale nr.4520, vendi i quajtur “Ul.M.Tita”, me kulturë shtëpi-oborr, klasi-0, Fleta poseduese nr.1739, Zona kadastrale-Gjilan.

III

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen: Drejtoria për Urbanizëm, Rindërtim dhe Ambient, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë dhe Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport të KK-Gjilan.

IV

Ky vendim hyn në fuqi ditë e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS – GJILAN

Nr.01.2946 / 020
Gjilan, më 27.03.2003

Zv.Kryetari i KK-së
Xhemajl HYSENI



KOMUNA E GJILANIT OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 11.07.2003, duke u mbështetur në Nenin 12 alineja 1 pika (e) të Statutit të Komunës së Gjilanit si dhe duke shqyrtuar kërkesën e Bashkësisë Islame në Gjilan nxori këtë:

V E N D I M

-I-

I lejohet Bashkësisë Islame rrënimi i objektit të tashëm të Xhamisë së Madhe në Gjilan i cili ka pësuar dëme nga tërmeti.

-II-

Objekti i ri i Xhamisë së madhe të ndërtohet në të njëjtat dimensione dhe sipas arkitekturës së tashme.

-III-

Autorizohet drejtoria për Urbanizëm, Rindërtim dhe Ambient që në harmoni me dispozitat ligjore pozitive të aplikueshme në Kosovë të lëshojë lejen e ndërtimit.

-IV-

Emërohet ing.Muhamet Sadriu që të përfaqësojë interesat e bashkësisë Islame të Gjilanit në projektimin e objektit të ri.

-V-

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Urbanizëm, Rindërtim dhe Ambient.

-VI-

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit

KUVENDI I KOMUNËS – GJILAN

Nr.01.6529 / 07
Gjilan, më 11.07.2003

KRYETARI
Lutfi HAZIRI



KOMUNA E GJILANIT OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më datë 11.07.2003 e duke u bazuar në nenin 12 alineja 1 pika (ë) dhe (g), nenin 48 alineja 3 dhe 4 të Statutit të Komunës së Gjilanit e në bazë të rekomandimit të Komitetit për Pronë, Banim dhe Rindërtim, nxori këtë:

V E N D I M

**PËR NDARJEN E SIPËRFAQËS SË TOKËS PËR NDËRTIMIN E PIKËS SË
KARBURANTIT NË FSHATIN VELEKINCË**

I

Me këtë vendim z.Fevzi Hajrullahut nga fshati Velekincë i ndahet sipërfaqja e tokës prej 0.10.00 ha (dhjetë ari) në shfrytëzim të përkohshëm për ndërtimin e Pikës së karburantit në fshatin Velekincë.

II

Objekti nga pika I i këtij vendimi do të ndërtohet në ngastrën kadastrale nr.214/2 te vendi i quajtur “Iliana Gllava”, KK-Velekincë, me kulturë – mal, klasa e pestë, e evidentuar si pasuri shoqërore KK-Gjilan.

III

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Urbanizëm, Rindërtim dhe Ambient dhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër e Pronë.

IV

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS – GJILAN

Nr.01. 6527 / 020
Gjilan, më 11.07.2003

KRYETARI,
Lutfi HAZIRI



**KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI**

Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 09.09.2003, e duke u bazuar në nenin 3 të Statutit të Komunës së Gjilanit, e në bazë të rekomandimit të Komitetit për Politikë dhe Financa, nxori këtë:

V E N D I M

I

Me këtë vendim epet pëlqimi për hartimin e projekteve për rrugët:

- Gjilan-Zhegër-Stanqi
- Bresalc-Kishnapole në kufi me Gadimen (Lipjan),

II

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryeshefi ekzekutiv dhe Drejtoria për Urbanizëm, Rindërtim dhe Ambient.

IV

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS – GJILAN

Nr.01. 8624 / 07
Gjilan, më 09.09.2003

K R Y E T A R I
Lutfi HAZIRI



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 12.11.2003, e duke mbështetur në nenin 3 dhe nenin 12 alineja 1 pika (b) të Statutit të Komunës së Gjilanit, nxori këtë:

V E N D I M
PËR SHPALLJEN E KONKURSIT PËR RREGULLIMIN URBANISTIK TË
QENDRËS SË QYTETIT

I

Me këtë vendim shpallet konkursi për rregullimin urbanistik të Qendrës së qytetit të Gjilanit.

II

Obligohet Drejtoria për Urbanizëm, Rindërtim dhe Ambient që të hartojë projektin ideor të pamjes urbanistike të qendrës së qytetit, i cili projekt do të shqyrtohet para këshilltarëve të KK-së, ndërsa Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë të bëjë përkufizimin e pikave brenda të cilave do të rregullohet qendra e qytetit.

III

Për zbatimin e këtij vendimi obligohen Drejtoria për Urbanizëm, Rindërtim dhe Ambient dhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.

IV

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS – GJILAN

Nr.01. 10507 / 020
Gjilan, më 12.11.2003

K R Y E T A R I
Lutfi HAZIRI



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Në bazë të nenit 27, 29, 39 dhe 42-45 të Ligjit mbi Planifikimin dhe Rregullimin e Hapësirës, ("Gazeta Zyrtare e Kosovës" nr. 42/89,) nenit 12 pika b. të Statutit të Komunës së Gjilanit, Rekomandimit të Komitetit për Planifikim dhe Resurse prej datës 05.12.2003. , Kuvendi i Komunës së Gjilanit, në seancën e vetë të mbajtur më 18.12.2003, bie këtë:

V E N D I M

Mbi qasjen e ndryshimit, plotësimit dhe harmonizimit të pjesës së Planit Detaj Urbanistik "ILIRIA" në Gjilan

I

Me këtë Vendim i qaset ndryshimit, plotësimit dhe harmonizimit të pjesës së Planit Detaj Urbanistik "Iliria" (ish "Parku") në Gjilan. dhe hartimit të Planit të ri urbanistik i cili do të përfshijë pjesën e hapësirës në anën e djathtë të rrugës regjionale Gjilan-Preshevë nga udhëkryqi mbi Çerdhen e fëmijëve të Kombinatit të Tekstilit "Integj" në Gjilan deri të oborri i Shkollës Fillore "Abaz Ajeti", duke u kthyer në të djathtë deri të rruga në mes të varrezave të qytetit, duke vazhduar nga qendra e qytetit deri te udhëkryqi të Kombinati i Duhanit dhe Kompleksi i banimit kolektiv "Iliria" ku kthehet në të djathtë deri te udhëkryqi para Çerdhes së fëmijëve të Kombinatit të Tekstilit, ku tangohet në pikën fillestare, në sipërfaqe rreth 14 hektarësh.

II

Gjatë hartimit të këtij plani, do të respektohet aq sa të jetë e mundur gjendja faktike ekzistuese dhe Plani Detaj ekzistues i realizuar si dhe do të parashihen dhe planifikohen përmbajtje të reja urbanistike duke i marrë parasysh edhe kërkesat e banorëve-qytetarëve të lokalitetit në fjalë të parashtruara me rastin e anketimit të tyre në kuadër të programit të bashkëpunimit në mes të Komunës së Iperit nga Belgjika dhe Komunës së Gjilanit lidhur me planifikimin.

III

Pas hartimit të planit, Kryeshefi Ekzekutiv i KK-së Gjilan dhe Drejtoria për Urbanizëm, Rindërtim dhe Ambient, do të organizojnë shikimin dhe diskutimin publik dhe aprovimin e të njëjtit konform dispozitave ligjore.

IV

Financimi i harmonizimit të këtij plani do të bëhet nga mjetet buxhetore të KK-së së Gjilanit.

V

Financimi i realizimit të planit të ri për disa objekte të karakterit të përgjithshëm (hapësirave të dedikuara për pushim, sport, rekreacion, dhe ndërtimi i objekteve të infrastrukturës komunale-banesore si ndriçimi publik, lokalet për aktivitete rinore etj) do të bëhet me pjesëmarrjen e qytetarëve të atij lokaliteti, komunës së Gjilanit dhe Komunës së Iperit nga Belgjika.

VI

Mbi zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Kryeshefi Ekzekutiv dhe Drejtoria për Urbanizëm, Rindërtim dhe Ambient si dhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronësi e Komunës së Gjilanit.

VII

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit.

VIII

Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi, pushon të vlejë Vendimi mbi aprovimin e PDU- "Parku" në Gjilan, i aprovuar në viti 1975 si dhe plotësimet dhe ndryshimet e mëvonshme, për pjesën e përshkruar në pikën I. të këtij Vendimi.

KUVENDI I KOMUNËS - GJILANIT



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Në bazë të nenit 27, 29, 39 dhe 42-45 të Ligjit mbi Planifikimin dhe Rregullimin e Hapësirës, ("Gazeta Zyrtare e Kosovës" nr. 42/89,) nenit 12 pika b. të Statutit të Komunës së Gjilanit, Rekomandimit të Komitetit për Planifikim dhe Resurse prej datës 05.12.2003. , Kuvendi i Komunës së Gjilanit, në seancën e vetë të mbajtur më 18.12.2003, bie këtë:

V E N D I M

Mbi qasjen e ndryshimit, plotësimit dhe zgjerimit respektivisht hartimit të Planit të ri Detaj Urbanistik "Kodra e Thatë" në Gjilan

I.

Me këtë Vendim i qaset ndryshimit, plotësimit dhe zgjerimit të Planit Detaj Urbanistik "Kodra e Thatë" (ish "Parku") në Gjilan, dhe hartimit të Planit të ri urbanistik i

cili do të përfshijë hapësirën në mes të rrugës magjistrale Gjilan-Ferizaj dhe PDU "Arbëria I" (ish "Q. Qeshme I") respektivisht pjesën e hapësirës në anën e Majtë të rrugës Magjistrale Gjilan-Ferizaj duke filluar nga Ndërtesa e banimit kolektiv "B+P+4" te udhëkryqi përballë Spitalit Regjional të Gjilanit, në drejtim të lagjes "Iliria" deri te udhëkryqi, ku kthehet në të majtë duke vazhduar rrugës ekzistuese në mes varrezave të Qytetit, del në lagjen "Arbëria" duke përcjellë rrugën ekzistuese mbi varreza, deri te rruga e vjetër e Kumanovës, ku kthehet dhe e përcjell të njëjtën deri ne kufirin kadastral të komunës së Gjilanit, kthehet në të djathtë duke përcjellë rrugën Qarkore të paraparë me Plan Gjeneral Urbanistik të Qytetit të Gjilanit, respektivisht tokën e përfshirë në Komunën Kadastrale të Gjilanit deri të rruga magjistrale Gjilan-Ferizaj ku kthehet në të djathtë deri në piken fillestare përballë Spitalit Regjional, në sipërfaqe rreth 80 ha.

II.

Gjatë hartimit të këtij plani, do të tentohet të respektohet vija e ndërtimit dhe rregullimit të Objekteve ekzistuese siç janë: Ndërtesat e banimit kolektiv, Kombinati i Duhanit, Halla e Sporteve, Fusha e sportit, Varrezat e Qytetit dhe hapësira për rreth tyre, si dhe do të parashihen dhe planifikohen përmbajtje të reja urbanistike duke i marrë në konsideratë edhe kërkesat e pronarëve të patundshmërive, aq sa të jetë e mundur dhe aq sa lejojnë kushtet urbanistike-teknike, normativat dhe standardet të lëmisë së planifikimit të hapësirës dhe mbrojtjes së ambientit.

III.

Pas hartimit të planit, Kryeshefi Ekzekutiv i KK-ës Gjilan dhe Drejtoria për Urbanizëm, Rindërtim dhe Ambient, do të organizojnë shikimin dhe diskutimin publik dhe aprovimin e të njëjtut konform dispozitave ligjore.

IV.

Financimi i hartimit të këtij plani do të bëhet nga mjetet buxhetore të KK- së Gjilanit.

V.

Financimi i realizimit të planit të ri për objekte të karakterit të përgjithshëm (hapësirave të dedikuara për pushim, sport, rekreacion, objekte shkollore, shëndetësore dhe objekteve tjera për aktivitete publike si dhe ndërtimi i objekteve të infrastrukturës komunale- rrjetit primar të ujësjellësit, kanalizimit, elektrikes, etj) do të bëhet me pjesëmarrjen e pronarëve të patundshmërive të atij lokaliteti, konform Vendimit mbi kompensimin e rregullimit të tokës ndërtimore të Komunës së Gjilanit.

VI.

Mbi zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Kryeshefi Ekzekutiv dhe Drejtoria për Urbanizëm, Rindërtim dhe Ambient si dhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronësi e Komunës së Gjilanit.

VII.

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit

VIII.

Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi, pushon të vlejë Vendimi mbi aprovimin e PDU-
"Parku" në Gjilan, i aprovuar në vitin 1975 si dhe plotësimet dhe ndryshimet e
mëvonshme, për pjesën e përshkruar në pikën I. të këtij Vendimi.

KUVENDI I KOMUNËS - GJILANIT

Nr. 01.11292 / 020
Gjilan, më 18.12.2003

K R Y E T A R I
Lutfi HAZIRI



KOMUNA E GJILANIT OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 16.01.2004, e duke
mbështetur nenin 12 alineja 1 pika (d) të Statutit të Komunës së Gjilanit, nxori këtë:

V E N D I M PËR APROVIMINE RREGULLORËS PËR MBROJTJEN E MJEDISIT NË KOMUNËN E GJILANIT

I

Me këtë vendim aprovohet Rregullorja për Mbrojtjen e Mjedisit në Komunën e Gjilanit.

II

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Rregullorja për Mbrojtjen e Mjedisit në Komunën e Gjilanit.

III

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryeshefi ekzekutiv i KK-Gjilan.

IV

Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit

KUVENDI I KOMUNËS-GJILAN

Nr.01.469 / 020
Gjilan, më 16.01.2004

K R Y E T A R I
Lutfi HAZIRI



KOMUNA E GJILANIT OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Në bazë të nenit 2 . pika (t),3.4 dhe 7.3 të ligjit për mbrojtjen e mjedisit si dhe në mbështetje të nenit 12. pika (d) statutit të Komunës së Gjilanit, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më 16.01.2004, aprovon këtë:

RREGULLORE

PËR MBROJTJEN E MJEDISIT

NË KOMUNËN E GJILANIT

Dispozitat e përgjithshme

Neni 1

1.1. Përmes kësaj rregullore në Komunën tonë, qëllimi është që të realizohen këto objektiva :

- a. Krijimi i masave të arsyeshme lokale për mbrojtjen e mjedisit në mënyrë që të jenë në pajtim me zhvillimin ekonomik të Komunës,
- b. Zvogëlimi gradual i ndotjes, degradimit dhe i dëmeve mjedisore, si dhe minimizimi ose ndalimi i atyre veprimtarive ekonomike që përbëjnë rrezik të madh për shëndetin e njeriut dhe mjedisit,
- c. Shfrytëzimi racional dhe i qëndrueshëm i burimeve natyrore, dhe tokës prodhuese, si dhe mbrojtja e akumuluesve gjenetik të natyrës.
- d. Mbrojtja e peizazheve të vlefshme të natyrës,
- e. Ruajtja dhe rehabilitimi i diversitetit, vlerave kulturore dhe estetike të peizazhit natyror,

Neni 2

Përgjegjësitë e Komunës

Komunat mund deri në masën që specifikisht kërkohet apo autorizohet me këtë ligj, apo dispozita të akteve normative të nxjerra me këtë ligj, të ushtrojë përgjegjësi për ato çështje që dalin apo ka mundësi të dalin në Komunë, në rast se ato çështje mund të merren përsipër, kontrollohen, parandalohen, financohen ose menaxhohen nga Komuna neni 3.4 i ligjit për mbrojtjen e mjedisit)

Çështjet mjedisore që bëjnë pjesë brenda përgjegjësiave të Komunës janë:

- a) Krijimi i standardeve, në pajtim me ligjin dhe aktet normative plotësuese të nxjerra në pajtim me këtë ligj, për operatorët lokal, që nuk janë nënë menaxhim apo administrimin e PSPP-së, të shërbimeve publike në fushën e mbrojtjes së mjedisit;
- b) Të sigurohet konformiteti i operatorëve me standarde të tilla;
- c) Planifikimi që ka të bëjë me mbrojtjen e mjedisit brenda Komunës;
- d) Krijimi i masave të arsyeshme lokale për mbrojtjen e mjedisit në mënyrë që të jenë në pajtim me zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të Komunës, në pajtim me këtë ligj dhe aktet normative plotësuese të nxjerra në pajtim me këtë ligj;
- e) Krijimi dhe fuqizimi i masave që kanë për qëllim të kontrollojnë nivelin e zhurmës brenda territorit të Komunës.
- f) Çështje të tjera mjedisore që u janë dedikuar Komunave me këtë ligj apo me aktet normative plotësuese të nxjerra në pajtim me këtë ligj.

Disa përkufizime të kuptimeve që kanë të bëjnë me shkallën e ndotjes mjedisore

Neni. 3.

2.1. Sipas kësaj rregulloreje zbatohen përkufizimet si vijon:

- 1) Çrregullim kritik për mjedisin është nocioni i përgjithshëm që ka të bëjë me ndotjen e mjedisit ose plehrat që i tejkalojnë nivelet kritike të parapara me këtë rregullore e nxjerr në pajtim me ligjin e mjedisit,
- 2) Dëm mjedisor, konsiderohet një aktivitet që ka potencial të jashtëzakonshëm që të dëmtojë mjedisin në mënyrë permanente ose të bëjë aksident mjedisor,
- 3) Degradim i mjedisit, konsiderohet degradimi substancial i mjedisit në atë shkallë që ndikon në kualitetin e jetës nga ndotja e mbeturinave dhe plehrat, ose nga përdorimi apo shfrytëzimi i burimeve natyrore,

- 4) Pëlqim mjedisor konsiderohet autorizimi me shkrim në pajtim me ligjin ose aktet tjera normative me qëllim të marrjes së çfarëdo leje për ndërtim, apo çfarëdo leje tjetër,
- 5) “ Ndotje “ do të thotë shkarkimin e një substance (duke përfshirë substanca në formë të lëngët, të ngurtë dhe të gaztë) ose energji duke përfshirë (vibrimin, radiacionin, ngrohjen, dritën, zhurmën apo forma tjera të energjisë) në mjedis, që ka potencial domethënës që t’i shkaktoj dëm shëndetit njerëzor, organizmave të gjallë apo eko – sistemeve apo dëm mjedisor.
- 6) Vlerësimi i ndikimit mjedisor; konsiderohen vlerësimet e determinuara, dëmet e mundshme mjedisore nga ndërtimi dhe aktivitetet tjera zhvillimore.

Programi për Mbrojtjen e Mjedisit

Neni 4

Komunat mund të adaptojnë programe komunale për mbrojtjen e mjedisit dhe programe pune të ngjashme, këto programe do të jenë konform dispozitave të këtij ligji, akteve plotësuese normative, (neni 7.3 i ligjit për mbrojtjen e mjedisit)

- a)Promovimi i një sistemi integral për mbrojtjen e mjedisit dhe promovimin e zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm;
- b)Përmirësime në planifikimin mjedisor dhe rregullimi:
- c)Mbrojtja e ujit:
- d)Mbrojtja e tokës
- e)Mbrojtja e ajrit dhe atmosferës (përfshirë ozonin)
- f)Mbrojtja e biodiversitetit, ekosistemeve ,objekteve dhe zonave të mbrojtura të natyrës :
- g)Rregullimi i aktiviteteve që përfshinë mbeturinat e rrezikshme dhe kemikalie degjeneruese: dhe
- h)Mbrojtja nga hurma dhe vibracioni

Neni 5

5.1. Çdo person që ka dijeni (informacion) se mund të ketë dëmtim të mjedisit ose aksident ekologjik duhet ta njoftoj organin kompetent për punë të mjedisit, inspektorin e mjedisit ose organet tjera përgjegjëse, institucionet publike që do të bashkëpunojnë me inspektoratin e mjedisit me qëllim që të merren masat preventive për evitimin e ndonjë dëmi të madh.

5.2. Komuna do të ketë kujdes në shfrytëzimin e resurseve natyrore dhe se shfrytëzimi i tyre të jetë sa ma racional.

5.3 Institucionet administrative shkencore të Kosovës në bashkëpunim me atë të Komunës duhet të bashkëpunojnë në mes veti, që ta ndihmojnë inspektorin e mjedisit për gjetjen e shkaqeve të çrregullimit mjedisor dhe identitetin e përgjegjësit të çrregullimit mjedisor .

Neni 6.

6.1. Në mbrojtjen e mjedisit, rol të madh luajnë edhe shërbimet publike që ofrohen nga operator të ndërmarrjeve publike, private për mbledhjen dhe menaxhimin e mbeturinave, furnizimin me ujë, mirëmbajtjen e rrjetit të kanalizimit, ujërave fekale, ujërave të zeza, si dhe shërbimeve tjera që në mënyrë të drejtpërdrejtë parandalon ndotjen e mjedisit.

Neni 7

7.1. Me këtë rregullore përcaktohen masat mbi sigurimin dhe mirëmbajtjen e përgjithshme të pastërtisë në sipërfaqet publike dhe sipërfaqet tjera me qëllim të mbrojtjes dhe përparimit të shëndetit të qytetarëve, dhe siguri i kushteve higjienike në interes të drejtpërdrejtë të qytetarëve në tërë territorin e Komunës .

Neni 8

8.1. Materialet që mund ta ndotin mjedisin, konsiderohen të gjitha llojet e hedhurinave në kuptim të këtij teksti, të gjitha llojet e materialeve në gjendje të ngurtë, të lëngët dhe të gaztë, të cilat si hedhurina krijohen në procesin e prodhimit dhe të shërbimeve të ndryshme.

8.2. Materialet e hedhurinave në kuptim të këtij neni janë ; hedhurinat e të gjitha llojeve të metalit , letrave, gomave, qelqeve, vajit, naftës, benzinës, leshit , pambukut, plastikes, eshtrave, lëkurave të shtazëve, kafshëve të ngordhura, kemikalive të ndryshme, mbeturinat nga ushqimi i përdorur, mbeturinat ndërtimore si dhe mbeturinat tjera që nuk janë të parapara me këtë rregullore por me ligj.

8.3. Ndalohen rreptësisht ndezja e hedhurinave të ndezshme sipas pikës 8.2 të këtij neni.

8.4. Ndalohet shitja dhe përdorimi i mjeteve piroteknike gjatë festave të vitit, pasi që mjetet e tilla shkaktojnë ndotje të mjedisit.

Neni 9

9.1. Përveç mbeturinave që ndotin mjedisin në komunën tonë, këtë mund ta bëjnë edhe ndërmarrjet, statusi i të cilave është i përcaktuar në nenin 3 të Rreg. nr.2001/6 mbi shoqëritë tregtare, dhe institucionet tjera që zhvillojnë aktivitetin e tyre në afërsitë e zonave të banimit.

Neni 10

10.1. Ndalohet deponimi i materialit të hedhurinave në gjendje të ngurtë dhe të lëngët në sipërfaqet publike, në rrugë, parqe, në pyje, në sipërfaqet e gjelbëruara, apo të hidhen në rrjedhat e lumenjve , në liqe dhe në vendet që nuk janë të dedikuara për mbeturina, përpos nëse kjo është e lejuar me vendimin e Kuvendit Komunal i bazuar në dispozitat ligjore.

10.2. Ndalohet larja dhe pastrimi i qytetarëve gjatë stinës së verës në liqenin e Përlepnicës dhe përdorimi i i ujit për destinime tjera.

Neni, 11

11.1. Sipërfaqet publike konform të kësaj rregulloreje konsiderohen, sipërfaqet e trafikut publik, stacioni i derivateve të naftës , hapësirat e parkingut, sipërfaqet publike të gjelbëruara (parqet), sipërfaqet me bari, sipërfaqet për pushim dhe rekreacion , fushat e sporteve , tregjet , hapësirat e hapura midis dhe rreth ndërtesave të banimit kolektiv, dhe hapësirat që nuk janë hapësira publike por që shërbejnë për nevojat e ndërmarrjeve , institucioneve dhe qytetarëve.

Neni 12.

12.1. Për mirëmbajtjen e pastërtisë në sipërfaqet publike në qytet dhe në fshatrat për rreth, mbeturinat e çfarëdo lloji të jenë duhet vendosur kontejnerët e mbeturinave të të gjitha llojeve, në vendet e caktuara nga organi kompetent i administratës komunale përkatësisht Drejtoria e Shërbimeve Publike, në marrëveshje me Inspektorët e mjedisit , 12.2. Gropat septike në kuptim të kësaj rregulloreje konsiderohen gropat për ujësjellës dhe kanalizim nëpër

vendet që nuk është i rregulluar rrjeti i kanalizimit dhe i ujësjellësit, pastrimi i tyre bëhet nga ndërmarrja publike përkatëse, me mjete të mbyllura për transport.

Neni 13

13.1. Në interes të shëndetit të njerëzve për sigurimin e kushteve higjienike, në qytet dhe para lagjet e qytetit, rrugët, rrugicat, parqet, kopshtet e fëmijëve, oborret në ndërtesat shoqërore, afariste, trojet e zbrazëta dhe sipërfaqet publike si dhe të gjitha lokalet tjera të përbashkëta duhet të mbahen në gjendje të pastër sipas dispozitave të kësaj rregulloreje.

Neni 14

14.1. Me mbajtje të pastërtisë në kuptim të këtij neni nënkuptojmë bartjen e mbeturinave, fekaleve, dhe mbeturinave tjera nga shtëpitë e banimit, lokalet afariste dhe lokalet tjera, rregullimi dhe mirëmbajtja e vend parkimeve publike, mbajtja në nivele e tregjeve me të gjitha kushtet e kënaqshme për tregtarët pastrimi ,dhe stërpikja e të gjitha sipërfaqeve publike.

Mbrojtja nga zhurma

Neni 15.

15.1 Për zbatimin e ligjit ,Ministria nxjerr dispozitat me të cilat rregullohet niveli i lejuar i zhurmës në mjedis, metodologjinë e matjes së zhurmës, standardet e pajisjeve për matjen zhurmës, kushtet që duhet plotësuar subjektet e licencuara për matjen e zhurmës dhe vibrimeve si dhe përmbajtja e dokumentit për burimet e zhurmës që vihen në qarkullim.(ligji për mbrojtjen e mjedisit, neni 31, alineja 1).

15.2. Komuna në kuadër të kompetencave gjatë zbatimit të ligjit, deri në nxjerrjen e akteve plotësuese dhe akteve të veçanta, nga Ministria operon me dispozitat e ligjit të aplikueshëm nga sfera e matjes së zhurmës dhe ndërmerr masa për mbrojtjen nga zhurma për këtë qëllim në aktet e saja të planifikimit hapësinor i cakton zonat e vendbanimeve, zonat për pushim dhe rekreacion, sipas (neni 31 pika 2 e ligjit për mbrojtjen e mjedisit)

Neni 16

16.1. Burimet e zhurmës duhet të mbahen nën kontroll deri në atë masë që nuk e tejkalojnë nivelin e lejuar në mesin ku banon njeriu,

16.2. Niveli i zhurmës mund të tejkalohet me leje nga organi kompetent në rastet e parapara me ligj , dhe në rastet e jashtëzakonshme

Neni 17.

17.1. Mjedisi në të cilin banon njeriu në vështirësi të kësaj rregulloreje konsiderohen ndërtesat e banimit, objektet publike si dhe vendbanimet dhe zonat e pushimit dhe të rekreacionit.

Neni 18

18.1. Komuna rregullon dhe ndërmerr masa për mbrojtjen nga zhurma, cakton zonat e vendbanimeve, zonat e pushimit dhe rekreacionit dhe siguron matjet sistematike të zhurmës

Mbikëqyrja dhe dispozitat ndëshkimore

Neni 19

19.1. Mbikëqyrjen mbi zbatimin e dispozitave të kësaj rregulloreje e bënë organi komunal i administratës, kompetent për punët e ambientit është inspekcioni i mjedisit.

19.2. Në kuadër të kompetencave dhe detyrave, inspektori komunal i mjedisit kryen këto detyra:

- a) Është përgjegjës për mbikëqyrjen e çrregullimeve mjedisore, të karakterit lokal, ndikimi i të cilave nuk kalon kufijtë e komunave dhe të cilat mund të zgjidhen, kontrollohen , parandalohen, nga vet Komuna,
- b) Ndërmerr këto masa:
 - i. Lëshon urdhëresa mbi mënjanimin gjërave dhe sendeve të tjera nga sipërfaqet publike të cilat do të jenë rrezik potencial për ndotjen e mjedisit, rrezikimin e shëndetit dhe jetës së njerëzve
 - ii. Inspektori i mjedisit nxjerrë aktvendim,
 - iii. Të urdhëroj kryerjen e obligimeve dhe marrjen e masave për mënjanimin e të metave (rikthimin në gjendjen e mëparshme të mjedisit),
 - iv. Të shqiptojë dhe të arkëtojë gjokat e parashikuara me vendimet e Kuvendit Komunal dhe të ndërmarrë masa tjera për të cilat është i autorizuar me këtë rregullore dhe dispozita të veçanta,
 - v. Në zbatimin e kësaj rregulloreje dhe të dispozitave tjera të veçanta, inspektorët komunal të ambientit i shqiptojnë masat administrative dhe marrin veprime të tjera të cilat janë të autorizuar me vendimin e Kuvendit të Komunës.

19.3. Kundër vendimit të inspektorit komunal për mjedis, ankesa i drejtohet organit kompetent komunal.

19.4. Në ankesën kundër vendimit të organit kompetent komunal respektivisht inspektorit mjedisor në nivel të Kosovës, vendos Ministria.

Neni 20.

20.1. Të gjitha aktet normative të nxjerra në pajtim me ligjin e mjedisit , do të përmbajnë dispozita që specifikojnë, gjokat që mund të imponohen për kundërvajtje .

20.2. Çdo dispozitë mbi një gjobë të tillë të akteve plotësuese normative do të sigurojë që një gjobë e tillë është proporcionale deri në mënyrën e dënimit të shkaktuar dhe interesit nga një kundërvajtje.

Neni 21.

21.1. Me gjobë në të holla në shumë prej 80 € deri në 160 € do të gjobiten për kundërvajtje personat fizik, kurse ata juridik nga 400 deri 1200 € nëse nuk i përmbahen dispozitave sipas neneve 1, 5, 6 dhe 8.

21.2. Nëse ndërmarrja e kontraktuar për mbajtjen e higjienës në Komunë nuk vepron në përputhje me nenin 5 do të dënohet me të holla nga 650 deri 950 €.

Neni 22

22.1. Do të gjobitet me të holla prej 400 € deri në 1200 për kundërvajtje të gjitha ndërmarrjet që veprojnë në kundërshtim me nenin 9 të kësaj rregulloreje.

22.2. Për kundërvajtje në kundërshtim me nenin 9,10,11,12,13 Inspektori Komunal për mbrojtje të mjedisit ka autorizim të shqiptojë dënimin(gjobë) mandator në shumë prej 150 € për personat fizik, kurse për personat juridik nga 800 €.

Neni 23

Për kundërvajtje do të gjobiten me të holla 80 deri 150 € personat fizik që veprojnë në kundërshtim me nenin,14,15,16,17, ndërsa për shkelje të dispozitave të njëjta, personat juridik do të gjobiten me të holla 250 deri në 400 € .

Neni 24

24.1. Për kundërvajtje të caktuar me këtë rregullore që bëjnë jo madhorët (të miturit) do të dënohen me gjobë prindërit e tyre respektivisht kujdestarët.

Neni 25

25.1. Kundërvajtësit të cilët nuk i përgjigjen gjobave mandatore, Inspektori i mjedisit do të bëjë kërkesë për fillimin e procedurës pranë gjykatës Komunale për kundërvajtje

Dispozitat kalimtare dhe të fundit

Neni 26

26.1. Për zbatimin e kësaj rregulloreje për mbrojtje të mjedisit do të kujdeset Inspektori komunal për Mbrojtje të Mjedisit.

26.2. Kjo rregullore hynë në fuqi në ditën e miratimit nga ana e Kuvendit Komunal.

KUVENDI I KOMUNËS – GJILAN

Nr.01.469 / 020
Gjilan, më 16.01.2004

K R Y E T A R I
Lutfi HAZIRI



**KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI**

Duke u bazuar në nenin 12 alineja 1 pika (e) dhe (n) të Statutit të Komunës së Gjilanit, dhe nenin 29 të Ligjit mbi Eksproprijimin, e në bazë të Rekomandimit të Komitetit për Pronë, Banim dhe Rindërtim, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 29.04.2004, nxori këtë:

**V E N D I M
PËR CAKTIMIN E ÇMIMIT PËR TOKËN NDËRTIMORE TË
EKSPROPRIUAR**

I

Me këtë vendim caktohet çmimi i tokës ndërtimore të eksproprijuar për vitin kalendarik 2004, dhe atë:

- Për Zonën e parë, çmimi për 1m² i tokës ndërtimore të eksproprijuar është 100-150€;

- Për Zonën e dytë, çmimi për 1m² i tokës ndërtimore të eksproprijuar është 50-100€;
- Për Zonën e tretë, çmimi për 1m² i tokës ndërtimore të eksproprijuar është 20-50€;

II

Procedurën për punët përgatitore rreth eksproprijimit dhe eksproprijimin e kryen Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.

III

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, kurse mbikëqyrjen e bënë Kryeshefi ekzekutiv.

IV

Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit.

KUVENDI I KOMUNËS-GJILAN

Nr.01. _____
Gjilan, më 29.04.2004

K R Y E T A R I
Lutfi HAZIRI



KOMUNA E GJILANIT OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Në bazë të nenit 3.1 pika (f) të Rregullores mbi vetëqeverisjen e komunave të Kosovës, nenit 12 pika (g) të Statutit të Komunës së Gjilanit, e në vështirim të Rekomandimit të Komitetit për Arsim dhe Komitetit për Pronë dhe Banim të KK-ës Gjilan, për sigurimin e lokacionit për ndërtimin e Shkollës Filllore për nevoja të lagjes "Zabeli i Sahit Agës" në Gjilan, Kuvendi i Komunës së Gjilanit, në seancën e mbajtur më datë: 29.04.2004, bie këtë:

V E N D I M

Për dhënien e pëlqimit për blerjen e lokacionit për ndërtimin e Shkollës Filllore në lagjen "Zabeli i Sahit Agës" në Gjilan

I.

Me këtë Vendim, Kuvendit të Komunës së Gjilanit-Drejtorisë për Arsim, i epet Pëlqimi për blerjen-sigurimin e lokacionit në sipërfaqe prej 0.50.00 deri 0.60.00 ha (pesëdhjetë deri gjashtëdhjetë ari) për ndërtimin e objektit të Shkollës Filllore për nevojat e banorëve të Lagjes "Zabeli i Sahit Agës" të Qytetit të Gjilanit.

II.

Lokacioni për ndërtimin e objektit nga pika I. e këtij Vendimi duhet t'i plotësojë këto kushte:

- Të jetë i përshtatshëm për kycje në objekte ekzistuese të infrastrukturës komunale (rrugë, rrjetin elektrik, PTT, kanalizim dhe ujësjellës);
- Të jetë i koncentruar në mes të lagjes;
- T'i kenë të zgjidhura marrëdhëniet pronëso-ro-juridike, me qëllim të bartjes të së drejtës së pronësisë pa zvarritje;

III.

Obligohet Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër, Pronë dhe Banim e KK-së Gjilan, që me pronarin e mëparshëm të lidhë marrëveshje mbi kompensimin, konform Ligjit mbi eksproprijimin dhe Vendimit mbi përcaktimin e lartësisë së kompensimit për tokën e eksproprijuar ndërtimore në territorin e Qytetit të Gjilanit.

IV.

Obligohet Drejtoria për Urbanizëm, Rindërtim dhe Ambient e Komunës së Gjilanit që të caktojë kushtet urbanistike-teknike të lokacionit dhe të bëjë zgjidhjen urbanistike të projektit për ndërtimin e objektit-shkollës.

V.

Për Zbatimin e këtij Vendimi do të Kujdeset Kryeshefi i Ekzekutivit të KK-së Gjilan.

VI.

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS – GJILAN

Nr. 01.3792 / 020
Gjilan, më 29.04. 2004

K R Y E T A R I,
Lutfi Haziri



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Në bazë të nenit 27, 38, 44, 45 dhe 46 paragrafi 6. të Ligjit për Planifikimin e Hapësirës ("Gazeta Zyrtare e Kosovës" nr. 2/89,), nenit 12 pika b. dhe nenit 44 pika i.i. të Statutit të Komunës së Gjilanit, e në vështrim të Vendimit mbi qasjen e ndryshimit, plotësimit dhe harmonizimit të pjesës së Planit Detaj Urbanistik "Iliria" në Gjilan, nr. 01.11293/020 të datës 18.12/2003, Kuvendi i Komunës së Gjilanit , në seancën e mbajtur më datë: 29. 04.2004, nxori këtë:

V E N D I M

Për miratimin e Planit Detaj Urbanistik "ILIRIA" në Gjilan

Neni 1.

Miratohet Plani Detaj Urbanistik: "ILIRIA", në Gjilan, i cili përfshinë hapësirën në anën e djathtë të rrugës Gjilan-Preshevë, duke filluar nga udhëkryqi përballë Çerdhes së Fëmijëve të Kombinatit të Tekstilit në Gjilan, deri të oborri I Shkollës Fillore "Abaz Ajeti" , ku kthehet në të djathtë në vijë të drejtë deri të rruga në mes varrezave të Qytetit, kthehet në të djathtë në drejtim të Qytetit deri te udhëkryqi përbri Kombinatit të Duhanit dhe Kompleksit të banesave "Iliria", ku kthehet në të djathtë deri te udhëkryqi përballë Çerdhes së Fëmijëve të Kombinatit të Tekstilit, ku është edhe pika fillestare, në sipërfaqe prej gjithsej 14,0 hektarësh, i hartuar nga Sektori për Planifikim i Drejtorisë për Urbanizëm, Rindërtim dhe Ambient të Komunës së Gjilanit.

Neni 2.

Elaborati nga neni paraprak i këtij Vendimi, vërtetohet me vulën e Kuvendit të Komunës së Gjilanit dhe nënshkrimin e Kryetarit të Komunës së Gjilanit dhe i njëjti përbëhet nga pjesa tekstuale dhe pjesa grafike.

a. Pjesa tekstuale përmban: Arsyeshmërinë e miratimit të Planit Detaj Urbanistik të lokalitetit "Iliria" dhe

b. Pjesa grafike përmban: planin e sinkronizuar të organizimit dhe rregullimit të hapësirës të lokalitetit "Iliria".

Neni 3.

Plani Detaj Urbanistik nga neni 1. i këtij Vendimi, përbën dokumentin themelor për realizimin e programit të rregullimit të hapësirës të këtij lokaliteti, përcakton rrjetin e infrastrukturës, kushtet urbanistike-teknike dhe përmbajtjet tjera të nevojshme për realizimin e tij.

Neni 4.

Për zbatimin e këtij Plani do të përkujdeset Drejtoria për Urbanizëm, Rindërtim dhe Ambient e Komunës së Gjilanit.

Neni 5.

Ky Vendim, është pjesë përbërëse e Planit të Përgjithshëm Urbanistik të Qytetit të Gjilanit, ("Gazeta Zyrtare e Kosovës", nr. 21/81.)

Neni 6.

Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi, pushon të vlejë Vendimi mbi miratimin e PDU "Parku", i vitit 1975 me ndryshimet dhe plotësimet e mëvonshme, për pjesën e përshkruar në nenin 1. të këtij Vendimi.

Neni 7.

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS – GJILAN

Nr. 01.3790 / 020
Gjilan, më 29.04. 2004.

K R Y E T A R I,
Lutfi Haziri



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Tekst i spastruar

Në bazë të nenit 12 pika (c) dhe (e) të Statutit të Komunës së Gjilanit, e në vështrim të nenit 2 të Vendimit për kompensimin e rregullimit të tokës ndërtimore nr.1892/020 prej 11.04.2001, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 29.04.2004, bie këtë:

V E N D I M

PËR LIRIMIN NGA KOMPENZIMI NË EMËR TË RREGULLIMIT TË TOKËS NDËRTIMORE

I

Me këtë vendim, lirohen nga obligimi për pagimin e kompensimit në emër të rregullimit të tokës ndërtimore në territorin e qytetit të Gjilanit, pronarët e objekteve të dëmtuara nga pasojat e luftës, të tërmetit dhe fatkeqësive tjera, nëse paraprakisht plotësohen kushtet si vijon:

1. Pronarët e objekteve ekzistuese për të cilat dëshmohet se kanë pasur leje të ndërtimit në harmoni me Planet Detale Urbanistike me destinim për ndërtim individual banesor;

2. Pronarët e objekteve ekzistuese për të cilat komisioni kompetent, profesional konstaton se duhet të rrënohet ose rikonstruktohet;
3. Që objekti i banimit të ndërtohet ekskluzivisht në gabarite dhe katësi, siç ka qenë para se objekti të dëmtohet si pasojë e luftës, tërmetit apo fatkeqësive tjera;
4. Që të jenë rregulluara marrëdhëniet pronëso-ro-juridike për ngastrën kadastrale ku gjendet objekti i dëmtuar.

II

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Urbanizëm, Rindërtim dhe Ambient e Komunës së Gjilanit.

III

Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit dhe do të vlejë për të gjitha lëndët e kompletuara deri më 31.12.2004

KUVENDI I KOMUNËS-GJILAN

Nr.01.3789 / 020
Gjilan, më 29.04.2004

K R Y E T A R I
Lutfi HAZIRI



KOMUNA E GJILANIT OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Në bazë të nenit 27, 42 43, 44, 45 dhe 46 paragrafi 6. të Ligjit për Planifikimin e Hapësirës ("Gazeta Zyrtare e Kosovës" nr. 2/89,), nenit 12 pika b. dhe nenit 44 pika i.i. të Statutit të Komunës së Gjilanit, e në vështrim të Rekomandimit të Komitetit për Planifikim, Resurse Natyrore, Urbanizëm dhe Ambient të KK-ës Gjilan, për Qasjen e hartimit të Projektit Urbanistik të hapësirës-platesë përballë Hotelit "Kristal" në Qendër të Qytetit të Gjilanit, prej datës 14.04.2004, Kuvendi i Komunës së Gjilanit, në seancën e mbajtur më 29.04.2004, nxori këtë:

V E N D I M

Për Miratimin e Projektit Urbanistik për rregullimin e hapësirës së lirë para Hotelit "Kristal", në Qendër të Qytetit të Gjilanit

Neni 1.

Miratohet Projekti Urbanistik për rregullimin e hapësirës së lirë para Hotelit "Kristal", në Qendër të Qytetit të Gjilanit, në tërësi sipas zgjidhjes urbanistike të hartuar nga Sektori për Planifikim i Drejtorisë për Urbanizëm, Rindërtim dhe Ambient i Komunës së Gjilanit

Neni 2.

Projekti Urbanistik nga neni paraprak i këtij Vendimi, vërtetohet me vulën e Kuvendit të Komunës së Gjilanit dhe nënshkrimin e Kryetarit të Komunës së Gjilanit dhe i njëjti përbëhet nga pjesa tekstuale dhe pjesa grafike.

a. Pjesa tekstuale përmban: Arsyeshmërinë e miratimit të Projektit Urbanistik dhe

b. Pjesa grafike përmban: zgjidhjen e organizimit dhe rregullimit të hapësirës së lirë përballë Hotelit "Kristal" në Qendër të Qytetit të Gjilanit.

Neni 3.

Projekti Urbanistik nga neni 1. i këtij Vendimi, përbën dokumentin themelor për realizimin e programit të rregullimit dhe shfrytëzimit të kësaj hapësire, përcakton rrjetin e infrastrukturës, kushtet urbanistike-teknike dhe përmbajtjet tjera të nevojshme për realizimin e tij.

Neni 4

Në kuadër të projektit urbanistik nga neni 1 i këtij vendimi është paraparë edhe vendosja e Shtatores së dëshmorëve "Rexhep Mala dhe Nuhi Berisha".

Neni 5.

Për zbatimin e këtij Projekti do të përkujdeset Drejtoria për Urbanizëm, Rindërtim dhe Ambient e Komunës së Gjilanit.

Neni 6.

Ky Vendim, është pjesë përbërëse e Planit të Përgjithshëm Urbanistik të Qytetit të Gjilanit, ("Gazeta Zyrtare e Kosovës", nr. 21/81.)

Neni 7.

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS – GJILAN

Nr. 01.3788 / 020
Gjilan, më 29.04. 2004.

K R Y E T A R I,
Lutfi Haziri,



KOMUNA E GJILANIT OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Në bazë të nenit 37, 43, 44 dhe 46 të Ligjit mbi tokën ndërtimore, ("Gazeta Zyrtare e Kosovës", nr.14/80 dhe 42/86), nenit 12 të Vendimit mbi tokën ndërtimore të Komunës së Gjilanit, ("Gazeta Zyrtare e Kosovës". nr.29/86) dhe nenit 12. pika b. dhe c. të Statutit të Komunës së Gjilanit, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e vet të mbajtur më datën: 29. 04 / 2004, bie këtë:

V E N D I M

PËR KOMPENZIMIN E RREGULLIMIT TË TOKËS NDËRTIMORE

Neni 1.

Me këtë vendim përcaktohet lartësia e kompensimit për rregullimin e tokës ndërtimore në territorin e Komunës së Gjilanit.

Kompensimin e paraparë me këtë vendim, janë të obliguar ta paguajnë të gjithë investuesit e ndërtimit të të gjitha llojeve, tipave dhe dedikimeve të objekteve, me rastin e marrjes së lejes së rekonstruktimit të objekteve ekzistuese, ndërtimit të objekteve të reja, aneks ndërtimit, mbindërtimit, legalizimit të objekteve ekzistuese, respektivisht lejes së përdorimit të objekteve ekzistuese të ndërtuara pa leje, si dhe vendosjes-ndërtimit dhe legalizimit të objekteve të tipit montues të karakterit të përkohshëm.

Neni 2.

Bazat, masat dhe kriteret për caktimin e lartësisë së kompensimit për rregullimin e tokës ndërtimore në rajonin e Qytetit të Gjilanit janë:

- shkalla reale e rregullimit të tokës ndërtimore,
- përshtatshmëria për banim që ofron toka ndërtimore dhe
- programi i rregullimit të tokës ndërtimore.

Neni 3.

Sipas kushteve në vështrim të nenit 2. të këtij vendimi, toka ndërtimore e Qytetit të Gjilanit ndahet në tri zona:

Zona e I-rë përfshinë : pjesën e vjetër të Qytetit, të paraparë me PDU, respektivisht ngastrat kadastrale që janë brenda këtyre kufijve dhe atë duke filluar nga: ura mbi lumin Stanishor përballë Kazermës Ushtarake, duke vazhduar rrjedhës së lumit në drejtim të Malishevës, deri te trasa e rrugës së re qarkore "Jugu 1", ku kthehet në të djathtë dhe e përcjellë të njëjtën deri në kryqëzimin e saj me rrugën magjistrale Ferizaj-Gjilan përballë Spitalit Regjional, ku kthehet në drejtim të qendrës së Qytetit deri të rruga në mes Arkivit Historik dhe Parkut të Qytetit, kthehet në të majtë e përcjell të njëjtën deri në kryqëzimin me rrugën "Lidhja e Prizrenit" ku kthehet në drejtim të Prishtinës deri të udhëkryqi në Kodrën e Dëshmorëve, kthehet në të djathtë rrugës kryesore nëpër lagjen "Dardani" deri te kryqëzimi me rrugën Gjilan-Koretishtë, përballë Tyrbes, ku kthehet të djathtë në drejtim të Qendrës deri mbi Shkollën e Lartë "Skenderbeu", kthehet në të majtë deri te rruga "Rexhep Malaj", kthehet në të djathtë dhe e pret rrugën "A. Presheva" dhe vazhdon deri në rrugën "7.Korriku", kthehet në të majtë deri në fund të rrugës ku kthehet në të djathtë deri në lumin Stanishor ku kthehet në të djathtë dhe e përcjellë rrjedhën e poshtme deri në pikën fillestare te ura mbi lumin Stanishor.

Zona e II-të përfshinë vendbanimet që kanë PDU dhe disa hapësira që nuk kanë janë të përfshira me ato plane por gjinden në mes lokaliteteve që kanë plane detaje e që nuk janë të përfshira në zonën e I-rë, respektivisht ngastrat kadastrale që janë brenda këtyre kufijve dhe atë duke filluar nga: kryqëzimi i rrugës Shillove-Kufcë e Epërme me rrugën magjistrale Gjilan-Bujanoc përballë Fabrikës "Çeliku" ku përfshinë hapësirën e "Zonës Industriale" në anën e epërme të rrugës qarkore deri te pika nisës e përfshirë me PDU "Dheu i Bardhë" dhe vazhdon duke e përcjellë vijën e jashme të atij plani deri te afër Fabrikës për përpunimin e gurit "Gllama" ku del në rrugën qarkore deri te udhëkryqi Gjilan-Prishtinë, ku kthehet në të djathtë në drejtim të Prishtinës deri në pikën ku është përfshirë me PDU "Qarku", ku kthehet në të majtë duke e përcjellë vijën e planit deri në rrugën magjistrale Gjilan-Ferizaj, ku kthehet në drejtim të Gjilanit deri në pikën ku fillon PDU "Kodra e Thatë", ku kthehet në të djathtë dhe e përcjellë vijën e jashtme të saj në drejtim të lagjes "Arbëria" dhe vazhdon duke përcjellë PDU "Arbëria I", e pret rrugën Gjilan-Preshevë, dhe vazhdon me përcjelljen e vijës së jashtme të PDU "Arbëria II" deri te Kazerma e re e TMK në lagjen "Zabel" e përcjell kufirin deri te hyrja kryesore te pika me e ultë, ku kthehet në të djathtë ne vijë të drejtë e përcjell deri në rrugën "Zabel-Malishevë", e pret rrugën Gjilan-Malishevë të Kulla, dhe vazhdon duke e përcjellë kufirin e Kampit ushtarak në drejtim të fabrikës së Baterive ku del në rrugën Magjistrale Gjilan-Bujanoc ku kthehet në të majtë dhe vazhdon deri në pikën fillestare të udhëkryqi i rrugës Shillovë-Kufc e Epërme.

Zona e III-të përfshinë vendbanimet që janë brenda Komunës Kadastrale të Qytetit, por nuk janë të përfshira në zonën I-rë, II-të.

Për objektet ekonomike-tregtare-shërbyese (depo, servise, etj.) dhe industriale-prodhuese në zonat rurale, kompensimi bëhet sipas çmimit të paraparë për zonën e III-të.

Toka ndërtimore Rurale ndahet në dy zona

Zona e I-rë e cila përfshinë fshatrat dhe vendbanimet e rrafshëta dhe atë: Velekincë, Pasjan, Llashticë, Zhegër, Lladovë, Nasalë, Budrigë, Partesh, Cërnice, Livoq i Ultë, Livoq i Epërm, Pasjak, Bresalc, Koretishtë, Stanishor, Kufcë e Epërme, Shillovë, Përlepnice, Kmetoc, Mireshe, Pogragjë, Uglar dhe Malishevë e Ulët.

Zona e II-të, e cila përfshinë fshatrat dhe vendbanimet kodrinore-malore dhe që nuk janë të përfshira në zonën e I-rë rurale.

Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është edhe paraqitja grafike e ndarjes së Zonave në ortofoto të Qytetit të Gjilanit.

Neni 4.

Lartësia e kompensimit të shpenzimeve për rregullimin e tokës ndërtimore , varësisht nga lloji, tipi, dedikimi dhe zona, llogaritet në m² bruto sipërfaqes së objektit (**gabariti i jashtëm x etazhite duke përfshirë bodrumin dhe nën kulmin, respektivisht hapësirën e zënë**) dhe përcaktohet si vijon:

Kategorizimi i objekteve sipas llojit, tipit, dedikimit dhe zonave

Z	o	n	a	t.
	I.	II.	III.	

A. OBJEKTET E BANIMIT:

1. Ndërtesat kolektive dhe individuale, vikend shtëpizat e të ngjashme

(Ndërtimi i ri, Aneks ndërtimi, Mbindërtimi, Rekonstruktimi, Legalizimi:)..... **10,00 7,00 4,00**
€/1m²

2. Objektet e banimit kolektiv (ndërtimi i ri , Legalizimi) 15,00 12,00 9,00 €/1m²

3. Rekonstruktimi i obj. ekzistuese me leje të mëhershme: 5,00 3,50 2,00 €/1m²

4. Shndërrimi i objekteve banesore dhe objekteve tjera në lokale

Komerciale, Afariste, Tregtare: (zyra, shitore, restorante, kafiteri, depo):.. 10,00 7,00 4,00 €/1m²

B. OBJEKTET KOMERCIALE- AFARISTE-TRGTARE:

(Zyret, shitoret, magazinat, depot, qendra rekreative-sportive, parkingjet, pompat e karburanteve-gasit e të ngjashme)

1. Ndërtimi i ri, Aneks ndërtimi, Mbindërtimi, Legalizimi: 20,00 14,00 8,00
€/1m²

2. Rekonstruktimi: me leje të mëhershme..... 10,00 7,00 4,00
€/1m²

C. OBJEKTET EKONOMIKE - INDUSTRIALE:

(Hallat prodhuese, serviset, puntoritë, e të ngjashme)

1. Ndërtimi i ri, Aneks ndërtimi, Mbindërtimi, Legalizimi: 15,00 10,00 7,00
€/1m²

2. Rekonstruktimi: 7,50 5,00 3,50
€/1m²

D. OBJEKTET BUJOËSORE:

(fermat, stallat, hambarët, e të ngjashme)

1. Ndërtimi i ri, Aneks ndërtimi, Mbindërtimi, Legalizimi (nuk lejohen) 2,00
€/1m²

E. OBJEKTET NDIHMËSE:

(garazhet, kuzhinat verore, depot e druve etj.):

1. Ndërtimi i ri, Legalizimi, Aneks ndërtimi, Mbindërtimi..... 10,00 7,00 4,00
€/1m²

F. OBJEKTET E KARAKTERIT TË PËRKOUSHËM MONTUESE-LËVIZËSE:

(garazhet, barakat, kiosqet, autofurgonët, tendat, lojërat zbavitëse e të ngjashme):

1. Vendosja, Legalizimi: 10,00 7,00 4,00
€/1m²

Lartësia e kompensimit për sipërfaqen e Bodrumeve për objektet nga pika A, B,C dhe D, llogaritet 50% më pak nga shuma përkatëse .

Neni 5.

Lartësia e kompensimit për sipërfaqen e mbuluar dhe të pa mbuluar për objektet nga pika B,C,D,E dhe F. llogaritet:

Sipërfaqja e mbuluar: = 50% më pak nga shuma përkatëse.

Sipërfaqja e pambuluar: = 75% më pak nga shuma përkatëse.

Fshatrat dhe vendbanimet që i përkasin zonës së I-rë rurale, paguajnë në 80% nga shuma e paraparë për zonën e III-të të Qytetit të Gjilanit.

Fshatrat dhe vendbanimet që i përkasin zonës së II-të rurale, paguajnë 50% nga shuma e paraparë për zonën e III-të të Qytetit të Gjilanit

Neni 6.

Mjetet e grumbulluara sipas nenit 4. dhe 5. të këtij vendimi do të paguhet në llogari të Komunës së Gjilanit, me dedikim të posaçëm për rregullimin e tokës ndërtimore në bazë të programit të rregullimit të aprovuar nga Kuvendi i Komunës së Gjilanit.

Programi nga paragrafi 1 i këtij neni duhet të përfshijë:

1. përgatitjen e tokës për ndërtim,
2. ndërtimin e objekteve të infrastrukturës komunale dhe instalimeve për shfrytëzim të përbashkët dhe
3. ndërtimin e objekteve komunale dhe instalimeve për nevoja individuale.

Neni 7.

Përfshirje nga obligimi për kompensimin e rregullimit të tokës ndërtimore, në vështrim të nenit 1, paragrafit 2, të këtij vendimi, bëjnë objektet investues i të cilave janë institucionet shtetërore të Kosovës, TMK, si dhe institucionet dhe organet themelues i të cilave është Komuna e Gjilanit, objektet e karakterit të përgjithshëm shtetëror dhe publik, objektet e infrastrukturës komunale, mbrojtjes shëndetësore, sociale, të arsimit, shkencës, kulturës, rekreacionit dhe sportit si dhe objektet fetare, nëse objektet e tilla nuk shërbejnë për afarizëm dhe përfitim.

Neni 8.

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen Drejtoria për Urbanizëm, Rindërtim dhe Ambient, Drejtoria për Buxhet dhe Financa si dhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër, Pronësi dhe Banim të KK-së së Gjilanit.

Neni 9.

Ky vendim hun në fuqi ditën e aprovimit.

Neni 10.

Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi, pushon të vlejë Vendimi për kompensimin e rregullimit të tokës ndërtimore në territorin e Komunës së Gjilanit, nr. 01-1892/020 prej 16. Prill 2001, Vendimi mbi ndryshimin dhe plotësimin e vendimit mbi kompensimin e rregullimit të tokës ndërtimore nr. 01-2879-020 prej 25. Maj 2001 dhe nr. 01-5022/020 prej datës 29.05 2003 si dhe Vendimi për caktimin e lartësisë së kompensimit për rregullimin e tokës ndërtimore të përfshirë me PDU-"Zona Perëndimore-Qarku", nr. 01-5023/020 prej 29.05.2003.

KUVENDI I KOMUNËS-GJILAN

Nr.01.3791 / 020
Gjilan,, më 29.04.2004

K R Y E T A R I
Lutfi HAZIRI



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Në bazë të nenit 12 pika c. dhe e. të Statutit të Komunës së Gjilanit, e në vështrim të nenit 2 të Vendimit për kompensimin e rregullimit të tokës ndërtimore nr. 1892/020 prej 11/04/2001, Kuvendi i Komunës së Gjilanit, në seancën e mbajtur më date 02.07.2004, bie këtë:

VENDIM
PËR LIRIM NGA KOMPENZIMI NË EMËR TË RREGULLIMIT TË TOKËS NDËRTIMORE

I.

Me këtë vendim, lirohen nga obligimi për pagimin e kompensimit në emër të rregullimit të tokës ndërtimore në territorin e Qytetit të Gjilanit, pronarët e objekteve të dëmtuara nga pasojat e luftës, të tërmetit dhe të fatkeqësive tjera, nëse paraprakisht plotësohen kushtet si vijon:

1. Pronarët e objekteve ekzistuese të banimit, për të cilat Komisioni kompetent Profesional ka konstatuar apo konstaton, se të njëjtat duhet të rrënohen ose të rekonstruktohen;
2. Që të jenë të rregulluara marrëdhëniet pronëso-ro-juridike për ngastrën kadastrale në të cilën gjendet objekti i dëmtuar.

3. Që objekti të ndërtohet në kuadër të ngastrës ndërtimore në të cilën gjendet objekti ekzistues, në harmoni me kushtet urbanistike-teknike.

II.

Lirimi nga pika I. e këtij vendimi ka të bëjë vetëm me sipërfaqen dhe gabaritin e objektit ekzistues i cili duhet të rrënohet-rekonstruohet.

III.

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Urbanizëm, Rindërtim dhe Ambient e Komunës së Gjilanit.

IV.

Ky Vendim hynë në fuqi ditën e aprovimit dhe do të vlejë për të gjitha lëndët e kompletuara deri më datë: 31.12. 2004.

KUVENDI I KOMUNËS- GJILAN

Nr.01.5807 / 020
Gjilan, më 02.07.2004

KRYETARI
Lutfi HAZIRI



KOMUNA E GJILANIT

OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 02.07.2004, e në bazë të Rekomandimit të Komitetit për Pronë, Banim dhe Rindërtim,, nxori këtë:

V E N D I M PËR LEGALIZIMIN EKZISTUES TË HAPSIRAVE NË LAGJËN “DARDANIA”

I

Me këtë vendim bëhet legalizimi ekzistues i hapësirave ndërtimore në Lagjen “Dardania”

II

Të gjitha uzurpimet e qytetarëve në Lagjen “Dardania”, do të trajtohen uzurpime dhe për to do të veprohet sipas ligjit.

III

Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.

IV

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS – GJILAN

Nr.01.5805 / 020
Gjilan, më 02.07.2004

KRYETARI
Lutfi HAZIRI



KOMUNA E GJILANIT OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Duke u mbështetur në nenin 12 alineja 1 pika (ë) të Statutit të Komunës së Gjilanit, e në bazë të rekomandimit të Komitetit për Pronë, Banim dhe Rindërtim, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 02.07.2004, nxori këtë:

V E N D I M PËR LEJIMIN E VËNDOSJES SË KONTENJERIT-SHPK-SË

I

Me këtë vendim i lejohej Shërbimit Policor të Kosovës-Prishtinë, vendosja e kontejnerit me dimensione 9x9m², nga sipërfaqja e gjithëmbarshme prej 78.60.27 ha, në vendin e quajtur “Maja e Gjelbërt”, ngastrat kadastrale Nr.466/1, klasa e tretë, me kulturë-mal, fletës poseduese nr.43, Zona kadastrale Dragancë

II

Vendosja e kontejnerit bëhet me qëllim të përmirësimit të radio komunikimit për policët e SHPK-së dhe mbulimit të hapësirës së Komunës së Gjilanit me pajisje iner-regjionale.

III

Të gjitha shpenzimet rreth vendosjes së kontejnerit do t'i bartë Shërbimi Policor i Kosovës-Prishtinë.

IV

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë-KK Gjilan.

V

Ky vendim hyn në fuqi ditë e aprovimit.

KUVENDI I KOMUNËS – GJILAN

Nr.01.5791 / 020
Gjilan, më 02.07.2004

Kryetari i KK-së
Lutfi HAZIRI



KOMUNA E GJILANIT OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Teksti i spastruar

Duke u mbështetur në nenin 12 alineja 1 pika (ë) dhe (h) të Statutit të Komunës së Gjilanit, e në bazë të Rekomandimit të Komitetit për Pronë, Banim dhe Rindërtim, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në Seancën e mbajtur më 18.11.2004, miraton këtë:

V E N D I M PËR NDARJEN E LOKACIONIT AFËR QENDRËS SË SHËNDETIT MENDOR PËR NDËRTIMIN E ANEKSIT TË QENDRËS

I

Me këtë vendim ndahet lokacioni afër Qendrës së Shëndetit Mendor për ndërtimin e aneksit të Qendrës, pronë e Stacionit të Veterinarisë, në sipërfaqe prej 771m² nga sipërfaqja e gjithëmbarshme prej 0,23.78ha, ngastra kadastrale nr. 2141/1, vendi i quajtur “Rasadnik/Veterinarsaka”, me kulturë-ndërtesë, oborr, arë, Fleta poseduese nr.1743, KK-Gjilan.

II

Shpenzimet për ndërtimin e Aneksit të Qendrës së Shëndetit mendor do t'i bartin: 50 % nga buxheti i shërbimeve të Shëndetit Mendor, 25% nga buxheti i komunës dhe 25% nga KFOR-i Amerikan nga Kampi Montith.

III

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë e KK-Gjilan.

IV

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS – GJILAN

Nr.01.9206 / 020
Gjilan, 18.11.2004

Kryetari i KK-së
Lutfi HAZIRI



KOMUNA E GJILANIT OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Në bazë të nenit 24.1 të Ligjit për Planifikimin Hapësinor, Nr. 14/2003 dhe nenit 12 pika a. b. dhe c. të Statutit të Komunës së Gjilanit, Kuvendi i Komunës së Gjilanit, në seancën e vetë të mbajtur më 18.11.2004, miraton këtë:

V E N D I M

për ndërrimin e destinimit të shfrytëzimit hapësirës së një pjese të Planit Detaj Urbanistik " Arbëria " të Qytetit të Gjilanit

I

Me këtë Vendim Drejtorisë për Urbanizëm, Rindërtim dhe Ambient të Komunës së Gjilanit, i lejohet ndërrimi i destinimit të shfrytëzimit të hapësirës-objektit të paraparë, në një pjesë të Planit Detaj Urbanistik "Arbëria " (ish "Qenar Qeshme."), të Qytetit të Gjilanit, nga vitit 1984.

II

Ndërrimi i destinimit të shfrytëzimit të hapësirës-objektit nga pika I. e këtij vendimi ka të bëjë me objektin e paraparë për ndërtim në pjesët e ngastrave kadastrale nr. 1567 dhe 1568, vendi i quajtur "Bregu i Djegur", KK. Gjilan, kështu që në vend të: "Objektit parashkollor (Çerdhe fëmijësh-kopsht)", ndërron destinimi i shfrytëzimit të objektit dhe: "Objekt për persona të moshuar dhe pa përkujdesje familjare" në gabarit të njëjtë dhe katësi "P+1".

III

Obligohet Drejtoria për Urbanizëm, Rindërtim dhe Ambient e Komunës së Gjilanit që ndërrimin e destinimit nga pika II. e këtij vendimi ta inkorporojë në Planin Detaj Urbanistik "Arbëria" nga viti 1984.

IV

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është edhe: ekstrakti i lokacionit konkret nga PDU' Arbëria" e Qytetit të Gjilanit.

V

Obligohet Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronësi e KK-ës Gjilan, që të bëjë parcelimin e ngastrave kadastrale në përputhje me kushtet e parcelimit sipas këtij vendimi.

VI

Mbi zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Kryeshefi Ekzekutiv, Drejtoria për Urbanizëm, Rindërtim dhe Ambient si dhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronësi e Komunës së Gjilanit.

VII

Ky Vendim hynë në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS SË GJILANIT

Nr. 01.9205 / 020
Gjilan, më 18.11.2004

K R Y E T A R I
Lutfi HAZIRI



KOMUNA E GJILANIT OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Duke u mbështetur në nenin 12 alineja 1 pika (ë) të Statutit të Komunës së Gjilanit, e në bazë të Rekomandimit të Komitetit për Pronë, Banim dhe Rindërtim, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 18.11.2004, miraton këtë:

V E N D I M PËR LEJIMIN E VËNDOSJES SË OBJEKTEVE TË PËRKOHSHME

I

Me këtë vendim i lejohet PTK-së-njësia në Gjilan, vendosja e objekteve të përkohshme-montazhe për zyra postare dhe atë:

-vendosja e objektit të përkohshëm-montazhe në sipërfaqe prej 49m² nga sipërfaqja e gjithëmbarshme prej 02.10.67ha, në Lagjen "Arbëria", në ngastrën kadastrale nr.1880/1, me kulturë tokë jo pjellore, fleta poseduese nr.1751, Komuna kadastrale-Gjilan;

- vendosja e objektit të pakohshëm-montazhe në sipërfaqe prej 25m² nga sipërfaqja e gjithëmbarshme prej 0.41.22ha, në Lagjen "Dheu i Bardhë", në ngastrën kadastrale nr.2053/1, me kulturë Shkollë-tokë jo pjellore, fleta poseduese nr.1750, Zona kadastrale-Gjilan;

II

Të gjitha shpenzimet rreth vendosjes së objekteve nga pika I të këtij vendimi do t'i bartë PTK-njësia në Gjilan.

III

Obligohet organi përkatës komunal-Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë e KK-Gjilan që për të gjitha detajet e dhënies në shfrytëzim të përkohshëm të sipërfaqeve nga pika I të këtij vendimi të lidhë kontratë me PTK-njësia në Gjilan

IV

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Gjeodezi,Kadastër dhe Pronë-KK Gjilan.

V

Ky vendim hyn në fuqi ditë e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS – GJILAN

Nr.01.9207 / 020
Gjilan,më 18.11.2004

Kryetari i KK-së
Lutfi HAZIRI



KOMUNA E GJILANIT OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Në bazë të nenit 27, 38, 44, 45 dhe 46 paragrafi 6. të Ligjit për Planifikimin e Hapësirës (“Gazeta Zyrtare e Kosovës” nr. 2/89,), nenit 12 pika b. dhe nenit 44 pika i.i. të Statutit të Komunës së Gjilanit, e në vështtrim të Vendimit mbi qasjen e ndryshimit, plotësimit dhe harmonizimit të pjesës së Planit Detaj Urbanistik “Kodra e Thatë” në Gjilan, nr. 01.11292/020 të datës 18.12/2003, Kuvendi i Komunës së Gjilanit, në Seancën e mbajtur më datë:21.12.2004, miraton këtë:

V E N D I M

Për miratimin e Planit Detaj Urbanistik “Kodra e Thatë” në Gjilan- Pjesa nën Hallën e Sporteve

Neni 1.

Miratohet e Plani Detaj Urbanistik: “Kodra e Thatë” -pjesa nën Hallën e Sporteve “Bashkim Selishta” në Gjilan, i cili përfshinë hapësirën në mes rrugës nën Hallën e Sporteve dhe rrugës “Fehmi Lladrovci”, respektivisht rrugës Magjistrale Gjilan-Ferizaj dhe Kompleksit të Kombinatit të Duhanit, duke përfshirë edhe pjesën e Kombinatit të Duhanit, në të cilën ekzistojnë objekte të banimit individual, si dhe 3 objekteve-lamelave ekzistues të banimit kolektiv, të ndërtuara në P.SH. të KK-ës Gjilan.

Plani Detaj i këtij blloku urbanistik është hartuar nga Ndërmarrja “AS INGINIERING” nga Gjilani.

Neni 2.

Elaborati nga neni paraprak i këtij Vendimi, vërtetohet me vulën e Kuvendit të Komunës së Gjilanit dhe nënshkrimin e Kryetarit të Komunës së Gjilanit dhe i njëjti përbëhet nga pjesa tekstuale dhe pjesa grafike.

a. Pjesa tekstuale përmban: Arsyeshmërinë e miratimit të Planit Detaj Urbanistik të lokalitetit “Kodra e Thatë-pjesa nën Hallën e Sporteve” dhe

b. Pjesa grafike përmban: planin e parcelimit, planin e infrastrukturës ekzistuese, bazën gjeodezike me objektet e incizuara në terren, ortofoto-gjendja Qershor/2000, planin e rrugëve, gabaritin dhe etazhitetin,prerjet dhe dukjet të hapësirës-Bllokut urbanistik-Pjesa nën Hallën e Sporteve”.

Neni 3.

Plani Detaj Urbanistik nga neni 1. i këtij Vendimi, përbën dokumentin themelor për realizimin e programit të rregullimit të hapësirës së këtij lokaliteti, përcakton rrjetin e infrastrukturës, kushtet urbanistike-teknike dhe përmbajtjet tjera të nevojshme për realizimin e tij.

Neni 4.

Për zbatimin e këtij Plani do të përkujdeset Drejtoria për Urbanizëm, Rindërtim dhe Ambient e Komunës së Gjilanit.

Neni 5.

Ky Vendim, është pjesë përbërëse e Planit të Përgjithshëm Urbanistik të Qytetit të Gjilanit, ("Gazeta Zyrtare e Kosovës", nr. 21/81.)

Neni 6.

Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi, pushon të vlejë Vendimi mbi miratimin e PDU "Parku", i vitit 1975 me ndryshimet dhe plotësimet e mëvonshme, për pjesën e përshkruar në nenin 1. të këtij Vendimi.

Neni 7.

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS – GJILAN

Nr. 01.10249 / 020
Gjilan, më 21.12.2004

K R Y E T A R I,
Xhemajl HYSENI



KOMUNA E GJILANIT OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Në bazë të nenit 6.1 dhe 6.2. të Ligjit për Planifikimin Hapësinor nr. 14/2003, nenit 12. pika b. dhe nenit 45. pika ii. të Statutit të Komunës së Gjilanit, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 21.12.2004, miraton këtë:

V E N D I M PËR FORMIMIN E KËSHILLIT TË EKSPERTËVE PËR PLANIFIKIM ZHVILLIMOR TË KOMUNËS SË GJILANIT

Neni 1.

Për sigurimin e kushteve për planifikim të qëndrueshëm dhe të barabartë hapësinor të territorit të Komunës së Gjilanit, mbështetjes profesionale dhe shkencore të dokumenteve të planifikimit hapësinor dhe dokumenteve tjera, Formohet Këshilli i ekspertëve për planifikimin zhvillimor të territorit të Komunës së Gjilanit, (në tekstin e mëtejme: Këshilli) si Organ konsultativ i Kuvendit të Komunës së Gjilanit, në përbërje prej:

1. Vehbi Salihu-Kryetarë
2. Florina Orana-Zëvendës Kryetare
3. Elhane Shefkiu-Anëtare
4. Skender Muja-Anëtarë
5. Rrahim Azemi-anëtarë
6. Abdyl Aliu-Anëtarë
7. Habib Mahmuti-Anëtarë
8. Avni Shabani-Anëtarë
9. Sabri Tahiri-Anëtarë
10. Ali Arifi-Anëtarë

11. Nazim Rapuca-Anëtarë
12. Selami Sahiti-Anëtarë
13. Sasha Milosheviq-Anëtarë

Neni 2.

2.1. Këshilli përbëhet prej kryetarit, zëvendës kryetarit dhe 11 anëtarëve nga radha e personave profesional, shkencor, publik dhe personave tjerë kompetent për planifikim hapësinor.

2.2. Këshillin e udhëheqë dhe e kryeson kryetari i Këshillit, kurse në mungesë të tij, zëvendësi i kryetarit të Këshillit.

Neni 3.

Detyrat e Këshillit

3. Këshilli ka për detyrë të:

- jep mendime, propozime dhe vërejtje në dokumentet e planifikimit hapësinor (Planin Zhvillimor të Komunës dhe Planet zhvillimore për zona të veçanta) dhe në dokumentet tjera të përcaktuara me Ligjin për Planifikim Hapësinor të Kosovës të cilat i nxjerr Qeveria e Kosovës, Kuvendi i Kosovës, Kuvendi i Komunës dhe Këshilli Ekzekutiv i Kuvendit të Komunës së Gjilanit nga fusha e planifikimit hapësinor.

* shqyrtojë dhe propozojë zgjidhje përkatëse në rastet e jo harmonizimit të strategjive zhvillimore për sektor të ndryshëm të rëndësishëm për planifikimin hapësinor.

* përcjell dhe kujdeset për procedurat nëpër të cilat duhet të kalojnë dokumentet e planifikimit hapësinor të cilat miratohen nga organet e Kuvendit dhe Qeverisë së Kosovës, Kuvendit dhe Qeverisë të Komunës së Gjilanit në vështirësi të Ligjit për planifikim hapësinor dhe akteve tjera nga fusha e planifikimit hapësinor.

* kryej edhe punë tjera që dalin nga aktet juridike të organeve kompetente nga fusha e planifikimit hapësinor.

3.2. Këshilli duhet ti raportojë Kuvendit të Komunës për punën e vetë.

Neni 4.

Kompensimi për anëtarët e Këshillit

Këshilli është organ konsultativ i Kuvendit, kështu që kompensimi për punën e Këshillit do të caktohet me akt të veçantë.

Neni 5.

Punët administrative-teknike të Këshillit

Për punët administrativo-teknike dhe çështje tjera lidhur me punën e Këshillit është përgjegjës Shërbimi Civil Komunal.

Neni 6.

Këshilli përcakton rregullat e procedurës për punën e tij.

Neni 7.

Ky vendim hynë në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS-GJILAN

Nr.01.10254 / 020
Gjilan, më 21.12.2004

K R Y E T A R I
Xhemajl HYSENI



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Në bazë të nenit 10.2, 13. dhe 16 të Ligjit për Planifikimin Hapësinor, Nr. 2003/14 dhe Udhëzimit Administrativ për zbatimin e Ligjit për planifikimin hapësinor mbi elementet e themelore të Planit Zhvillimor të Komunës, nr. 33/03, dhe nenit 12 pika a. dhe b. të Statutit të Komunës së Gjilanit, Kuvendi i Komunës së Gjilanit, në seancën e mbajtur më 21.12.2004, miraton këtë:

V E N D I M
Mbi qasjen e hartimit të Planit Zhvillimor të Komunës së Gjilanit

I.

Me këtë Vendim i qaset hartimit të Planit Zhvillimor të Komunës së Gjilanit (në tekstin e mëtejme: Plani), i cili përfshinë tërë territorin brenda Komunës së Gjilanit, në sipërfaqe prej gjithsejtë: 51. 496.72.77 ha.

II.

Plani Zhvillimor është plan strategjik multisektorial i cili ka për detyrë të përcaktojë caqet afatgjata të zhvillimit ekonomik, shoqëror dhe hapësinor të territorit të Komunës së Gjilanit dhe i njëjti përfshinë edhe planin e zhvillimit të zonave urbane dhe rurale si dhe planin për zona të veçanta.

III.

Plani, duhet të jetë në përputhje me Planin Hapësinor të Kosovës.

IV.

Plani duhet të përmbajë : pjesën tekstuale dhe grafike;

Pjesa tekstuale e planit përmban: profilin e zhvillimit hapësinor dhe analizën e gjendjes; vizionin, parimet dhe caqet; kornizën e zhvillimit hapësinor; strategjitë dhe veprimet për zbatim si dhe dispozitat për zbatim.

Pjesa grafike duhet të përmbajë: të dhënat hartografike dhe shtojcat tjera grafike në të cilat paraqiten gjendja dhe ndërhyrjet në hapësirë dhe të njëjtat mund të jenë analoge ose digjitale si dhe të paraqesin tërësinë e zgjidhjeve të planifikuara.

V.

Gjatë hartimit të këtij plani, veçmas duhet të sigurohet:

- harmonizimi i organizimit, rregullimit dhe i shfrytëzimit të hapësirës dhe ndërtimi i vendbanimeve me qëllimet e zhvillimit shoqëror-ekonomik;
- mbrojtja dhe përparimi i vlerave natyrore dhe vlerave të krijuara me punë;
- mbrojtja e ambientit jetësor;
- ruajtja dhe shfrytëzimi racional i resurseve dhe pasurive natyrore,
- mbrojtja nga fatkeqësitë elementare;
- kushtet hapësinore dhe të planit për realizimin e masave me interes të përgjithshëm shoqëror;
- kushte hapësinore të zonave me karakteristika të veçanta të cilat kërkojnë një regjim të veçantë të organizimit, zhvillimit, shfrytëzimit dhe mbrojtjes së vlerave të veçanta natyrore, ekonomike, bujqësore, kulturore-historike etj.

-

VI.

Pas hartimit të planit, Kryeshefi Ekzekutiv i KK-ës Gjilan, Këshilli i Ekspertëve për Planifikim dhe Drejtoria për Urbanizëm, Rindërtim dhe Ambient, do të organizojnë shikimin dhe diskutimin publik dhe miratimit e të njëjtit konform dispozitave ligjore.

VII.

Financimi i hartimit të këtij plani do të bëhet nga mjetet buxhetore të KK-ës së Gjilanit.

VIII.

Mbi zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Ekzekutivi i Kk-ës Gjilan, Drejtoria për Urbanizëm, Rindërtim dhe Ambient si dhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronësi e Komunës së Gjilanit.

IX.

Ky Vendim hynë në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS SË GJILANIT

Nr.01.10250 / 020
Gjilan, më 21.12.2004

K R Y E T A R I
Xhemajl HYSENI



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Në bazë të nenit 10.2, 15 dhe 16 të Ligjit për Planifikimin Hapësinor, Nr.14/ 2003 dhe Udhëzimit Administrativ për zbatimin e Ligjit për planifikimin hapësinor mbi elementet e themelore të Planit Zhvillimor të Urban, nr. 34/03, dhe nenit 12 pika a. dhe b. të Statutit të Komunës së Gjilanit, Kuvendi i Komunës së Gjilanit, në seancën e vetë të mbajtur më 21.12.2004, miraton këtë:

V E N D I M

Mbi qasjen e hartimit të Planit Rregullativ Urban të Qytetit të Gjilanit

I.

Me këtë Vendim i qaset hartimit të Planit Rregullativ Urban të Qytetit të Gjilanit (në tekstin e mëtejshëm: Plani Rregullativ Urban), i cili përfshinë tërë hapësirën brenda Planit Zhvillimor Urban të Qytetit të Gjilanit.

II.

Plani Rregullativ është plan afatmesëm multisektorial i cili ka për detyrë të përcaktojë caqet e zhvillimit ekonomik, shoqëror dhe të rregullimit hapësinor të territorit të Qytetit të Gjilanit.

III.

Plani rregullativ, duhet të jetë në përputhje me Planin Zhvillimor Urban të Qytetit të Gjilanit.

Plani rregullativ mundë të hartohet për tërësi më të vogla urbane dhe lokacione të veçanta, e të cilat janë të përfshira me PZHU.

IV.

Plani duhet të përbëjë : pjesën tekstuale dhe grafike;

-Pjesa tekstuale e planit përmban: profilin e zhvillimit hapësinor dhe analizën e gjendjes; vizionin, parimet dhe caqet; kornizën e zhvillimit hapësinor; përshkrimin e ngastrave kadastrale të përfshira me plan; strategjitë dhe veprimet për zbatim si dhe dispozitat për zbatim.

-Pjesa grafike duhet të përmbajë: të dhënat hartografike dhe shtojcat tjera grafike në të cilat paraqiten gjendja dhe ndërhyrjet në hapësirë dhe të njëjtat mund të jenë analoge ose digjitale si dhe të paraqesin tërësinë e zgjidhjeve të planifikuara.

V.

Gjatë hartimit të këtij plani, veçmas duhet të sigurohet:

- harmonizimi i organizimit, rregullimit dhe i shfrytëzimit të hapësirës dhe ndërtimi i vendbanimeve me qëllimet e zhvillimit shoqëror-ekonomik;
- mbrojtja dhe përparimi i vlerave natyrore dhe vlerave të krijuara me punë;
- mbrojtja e ambientit jetësor;
- ruajtja dhe shfrytëzimi racional i resurseve dhe pasurive natyrore,
- mbrojtja nga fatkeqësitë elementare;
- kushtet hapësinore dhe të planit për realizimin e masave me interes të përgjithshëm shoqëror;
- inkorporimin e gjendjes ekzistuese duke pasur parasysh kushtet urbanistike- teknike dhe oportunitetin e interesave subjekteve pjesëmarrëse.

VI.

Pas hartimit të planit, Kryeshefi Ekzekutiv i KK-ës Gjilan, Këshilli i Ekspertëve për Planifikim dhe Drejtoria për Urbanizëm, Rindërtim dhe Ambient, do të organizojnë shikimin dhe diskutimin publik dhe miratimit e të njëjtit konform dispozitave ligjore.

III.

Financimi i hartimit të këtij plani do të bëhet nga mjetet buxhetore të KK-ës së Gjilanit.

VIII.

Mbi zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Ekzekutivi i KK-ës Gjilan, Drejtoria për Urbanizëm, Rindërtim dhe Ambient si dhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronësi e Komunës së Gjilanit.

IX.

Ky Vendim hynë në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS SË GJILANIT

Nr.01.10252 / 020
Gjilan, më 21.12.2004

K R Y E T A R I
Xhemajl HYSENI



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Në bazë të nenit 10.2, 14, dhe 16 të Ligjit për Planifikimin Hapësinor, Nr. 2003/14 dhe Udhëzimit Administrativ për zbatimin e Ligjit për planifikimin hapësinor mbi elementet e themelore të Planit Zhvillimor të Urban, nr. 34/03, dhe nenit 12 pika a. dhe b. të Statutit të Komunës së Gjilanit, Kuvendi i Komunës së Gjilanit, në seancën e vetë të mbajtur më 21.12.2004, miraton këtë:

V E N D I M

Mbi qasjen e hartimit të Planit Zhvillimor Urban të Qytetit të Gjilanit

I.

Me këtë Vendim i qaset hartimit të Planit Zhvillimor Urban të Qytetit të Gjilanit (në tekstin e mëtejme: Plani Zhvillimor Urban), i cili përfshinë tërë territorin brenda Komunës Kadastrale të Qytetit të Gjilanit, në sipërfaqe prej 1.701.72.24 ha si dhe ngastrat kadastrale të Fshatrave të cilat përkufizohen me Komunën Kadastrale të Qytetit të Gjilanit, të cilat do të përbëjnë zonën mbrojtëse të Planit Zhvillimor Urban të Qytetit të Gjilanit.

II.

Plani është plan strategjik multisektoral i cili ka për detyrë të përcaktojë caqet afatgjata të zhvillimit ekonomik, shoqëror dhe hapësinor të territorit të Qytetit të Gjilanit dhe i njëjti përfshinë edhe planin e zhvillimit të vendbanimeve dhe Fshatrave të cilat përkufizohen me Qytetin e Gjilanit.

III.

Plani, duhet të jetë në përputhje me Planin Zhvillimor të Komunës së Gjilanit.

IV.

Plani duhet të përbëjë : pjesën tekstuale dhe grafike;

-Pjesa tekstuale e planit përmban: profilin e zhvillimit hapësinor dhe analizën e gjendjes; vizionin, parimet dhe caqet; kornizën e zhvillimit hapësinor; përshkrimin e ngastrave kadastrale të përfshira me plan; strategjitë dhe veprimet për zbatim si dhe dispozitat për zbatim.

-Pjesa grafike duhet të përmbajë: të dhënat hartografike dhe shtojcat tjera grafike në të cilat paraqiten gjendja dhe ndërhyrjet në hapësirë dhe të njëjtat mund të jenë analoge ose digjitale si dhe të paraqesin tërësinë e zgjidhjeve të planifikuara.

V.

Gjatë hartimit të këtij plani, veçmas duhet të sigurohet:

- harmonizimi i organizimit, rregullimit dhe i shfrytëzimit të hapësirës dhe ndërtimi i vendbanimeve me qëllimet e zhvillimit shoqëror-ekonomik;
- mbrojtja dhe përparimi i vlerave natyrore dhe vlerave të krijuara me punë;
- mbrojtja e ambientit jetësor;
- ruajtja dhe shfrytëzimi racional i resurseve dhe pasurive natyrore,
- mbrojtja nga fatkeqësitë elementare;
- kushtet hapësinore dhe të planit për realizimin e masave me interes të përgjithshëm shoqëror;
- inkorporimin e gjendjes ekzistuese duke pasur parasysh kushtet urbanistike-teknike dhe oportunitetin e interesave subjekteve pjesëmarrëse.

VI.

Pas hartimit të planit, Kryeshefi Ekzekutiv i KK-ës Gjilan, Këshilli i Ekspertëve për Planifikim dhe Drejtoria për Urbanizëm, Rindërtim dhe Ambient, do të organizojnë shikimin dhe diskutimin publik dhe miratimit e të njëjtat konform dispozitave ligjore.

VII.

Financimi i hartimit të këtij plani do të bëhet nga mjetet buxhetore të KK-ës së Gjilanit.

VIII.

Mbi zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Ekzekutivi i KK-ës Gjilan, Drejtoria për Urbanizëm, Rindërtim dhe Ambient si dhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronësi e Komunës së Gjilanit.

IX.

Ky Vendim hynë në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS SË GJILANIT

Nr. 01.10251 / 020
Gjilan, më 21.12.2004

K R Y E T A R I
Xhemajl HYSENI



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Tekst i spastruar

Në bazë të nenit 12 pika (c) dhe (e) të Statutit të Komunës së Gjilanit, e në vështrim të nenit 7 të Vendimit për kompensimin e rregullimit të tokës ndërtimore nr.01.3191/020/020 prej 29.04.2004, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 24.02.2005, bie këtë:

V E N D I M
PËR LIRIMIN NGA KOMPENZIMI NË EMËR TË RREGULLIMIT TË
TOKËS NDËRTIMORE

I

Me këtë vendim, lirohen nga obligimi për pagimin e kompensimit në emër të rregullimit të tokës ndërtimore në territorin e qytetit të Gjilanit, pronarët e objekteve të dëmtuara nga pasojat e luftës, të tërmetit dhe fatkeqësive tjera, nëse paraprakisht plotësohen kushtet si vijon:

1. Pronarët e objekteve ekzistuese për të cilat dëshmohet se kanë pasur leje të ndërtimit në harmoni me Planet Detale Urbanistike me destinim për ndërtim individual banesor;
2. Pronarët e objekteve ekzistuese për të cilat komisioni kompetent, profesional konstaton se duhet të rrënohet ose rekonstruktohet;
3. Që objekti i banimit të ndërtohet ekskluzivisht në gabarit dhe katësi, siç ka qenë para se objekti të dëmtohet si pasojë e luftës, tërmetit apo fatkeqësive tjera;
4. Që të jenë rregulluara marrëdhëniet pronëso-ro-juridike për ngastrën kadastrale ku gjendet objekti i dëmtuar.

II

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Urbanizëm, Rindërtim dhe Ambient e Komunës së Gjilanit.

III

Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit dhe do të vlejë për të gjitha lëndët e kompletuara deri më 31.12.2005.

KUVENDI I KOMUNËS-GJILAN

Nr.01.1632 / 020
Gjilan, më 24.02.2005

K R Y E T A R I
Xhemajl HYSENI



KOMUNA E GJILANIT OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Duke u mbështetur në nenin 6 të Ligjit për Planifikim hapësinor, nr. 2003/14 të datës 03.07.2003, nenit 4 të Udhëzimit Administrativ nr.4 për zbatimin e Ligjit për Planifikim hapësinor të datës 27.04.2004 dhe nenit 45. pika II të Statutit të Komunës së Gjilanit, nenit 4 të Vendimit mbi formimin e Këshillit të ekspertëve të planifikimit zhvillimor të Komunës së Gjilanit nr. 01.10254/020 të datës 21.12.2004, e në bazë të Rekomandimit të Komitetit për Planifikim, Resurse Natyrore. Urbanizëm dhe Ambient, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 31.03.2005, miratoi këtë:

VENDIM

PËR CAKTIMIN E SHUMËS SË KOMPENZIMIT PËR ANËTARËT E KËSHILLIT TË EKSPERTËVE PËR PLANIFIKIM ZHVILLIMOR TË KOMUNËS SË GJILANIT

I

Caktohet shuma e kompensimit të anëtarëve të Këshillit të ekspertëve për planifikim zhvillimor të Komunës së Gjilanit.

II

Shuma nga pika I. e këtij vendimi do të epet në formë të mëditjes në shumë prej 50 €, dhe ate më së shumti dy mëditje brenda një muaji.

III

Anëtarëve të Këshillit të cilët janë me banim jashtë qytetit të Gjilanit iu takon edhe kompensimi i shpenzimeve të udhëtimit sipas çmimeve në transportin publik.

IV

Shuma e kompensimit do të paguhet në formë të mëditjes nga mjetet buxhetore të KK-Gjilan.

V

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryeshefi ekzekutiv dhe Drejtoria për Buxhet, Financa dhe Investime e KK-Gjilan.

VI

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS – GJILAN

Nr.01.2501 / 020
Gjilan, më 31.03.2005

KRYETARI
Xhemajl HYSENI



KOMUNA E GJILANIT OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Në bazë të nenit 22 të Ligjit për Planifikim të Hapësirës nr. 2002/14, nenit 12 pika b. dhe 45 pika (ii). të Statutit të Komunës së Gjilanit si dhe nenit 6 të Vendimit mbi aprovimin e “Zona Perëndimore-Qarku” e Qytetit të Gjilanit, nr.01-8030/020 prej 04.10.2002, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më datë 31.05.2005, miraton këtë:

V E N D I M PËR AUTORIZIMIN E ORGANIT PËR NDRYSHIME DHE PLOTËSIME TË VOGLA TË PDU “QARKU” NË GJILAN

Neni 1.

Autorizohet Drejtoria për Urbanizëm, Rindërtim dhe Ambient e Komunës së Gjilanit që të bëjë ndryshime dhe plotësime të vogla të planit Detaj Urbanistik “Qarku” në Gjilan, të miratuar me Vendimin nr.01-8030/020, të datës 04.10.2002.

Neni 2.

Me ndryshime dhe plotësime të vogla në vështrim të nenit 1. të këtij vendimi nënkuptojmë: caktimi i kushteve urbanistike-teknike në aspekt të katësisë-etazhitetit të objekteve të banimit individual në raport me gjendjen ekzistuese dhe dimensionet horizontale dhe vertikale.

Neni 3.

Ndryshimet dhe plotësimet nga neni paraprak duhet të inkorporohen në tërësinë e Planit Detaj Urbanistik në fuqi.

Neni 4.

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryeshefi ekzekutiv i KK-Gjilan.

Neni 5.

Ky vendim hynë në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS-GJILAN

Nr.01.3959 / 020
Gjilan, më 31.05.2005

KRYETARI
Xhemajl HYSENI



KOMUNA E GJILANIT OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Duke u mbështetur në nenin 45 alineja 4 pika (ii), nenin 48 alineja 4 të Statutit të Komunës së Gjilanit, pas shqyrtimit të iniciativës për qasjen e ndryshimit dhe plotësimin e një pjese të Planit Detaj Urbanistik “Qyteti i Vjetër” në Gjilan, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 31.05.2005, nxori këtë:

REKOMANDIM

I

I Rekomandohet Drejtorisë për Urbanizëm, Rindërtim dhe Ambient të i qaset iniciativës për ndryshimin dhe plotësimin e një pjese të Planit Detaj Urbanistik “Qyteti i Vjetër” në Gjilan.

II

Për zbatimin e këtij Rekomandimi obligohet Drejtoria për Urbanizëm, Rindërtim dhe Ambient.

KUVENDI I KOMUNËS-GJILAN

Nr.01.3962 / 020
Gjilan, më 31.05.2005

KRYETARI
Xhemajl HYSENI



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Duke u mbështetur në nenin 12 alineja 1 pika (ë) të Statutit të Komunës së Gjilanit, si dhe në bazë të Rekomandimit të Komitetit për Planifikim, Resurse natyrore, Urbanizëm dhe Ambient, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 30.06.2005, miratoi këtë:

V E N D I M
PËR ZHVENDOSJEN E NDËRTIMIT TË OBJEKTIT TË XHAMISË NGA
THEMELET EKZISTUESE

I

Me këtë vendim bëhet zhvendosja e ndërtimit të objektit të Xhamisë nga themelet ekzistuese në këndin prej 45 shkallë në brendi të ngastrës ndërtimore ekzistuese nr.3680 (pronë e Bashkësisë Islame).

II

Objekti i Xhamisë do të ndërtohet dhe kompletohet me pjesën e ngastrës kadastrale nr.3679 dhe 3682 (pronë e KK-Gjilan), dhe atë në sipërfaqe prej 122.59m² me kusht që kjo sipërfaqe të ndërrohet me sipërfaqen e njëjte të ngastrës kadastrale nr.3680-pronë e Bashkësisë islame.

III

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë dhe Drejtoria për Urbanizëm, rindërtim dhe Ambient.

IV

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS-GJILAN



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 23.02.2006, mbështetur në Rekomandimin e Komitetit për Planifikim, Resurse Natyrore, Urbanizëm dhe Ambient, miratoi këtë:

V E N D I M
PËR PËRKRAHJEN E INICIATIVËS PËR FILLIMIN E SHPALLJES SË VLERAVE
TË NATYRËS NËN MBROJTJE NË KOMUNËN E GJILANIT

I

Me këtë vendim përkrahet iniciativa për fillimin e shpalljes së vlerave të natyrës nën mbrojtje në Komunën e Gjilanit.

II

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari dhe Drejtoria për Urbanizëm, Rindërtim dhe Ambient e KK-Gjilan.

III

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS-GJILAN



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Mbështetur në nenin 12 alineja 1 pika (ë) dhe (h) të Statutit të Komunës së Gjilanit, si dhe në bazë të Rekomandimit të Komitetit për Planifikim, Resurse Natyrore, Urbanizëm dhe Ambient, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 29.06.2006, miratoi këtë:

V E N D I M
PËR NDRYSHIMIN E DESTINIMIT TË NGASTRËS KADASTRALE NR.635 NË
LAGJËN “QARKU”-GJILAN

I

Me këtë vendim bëhet ndryshimi i destinimit të ngastrës kadastrale nr.635 në lagjën “Qarku” në Gjilan, dhe ate nga ndërtimi individual i paraparë sipas PDU, në ndërtim publik.

II

Ngastara kadastrale nr.635 do të destinohet për ndërtimin e objektit të qendrës së Mjekësisë familjare.

III

Zbatimin e këtij vendimi e bën Drejtoria për Urbanizëm, Rindërtim dhe Ambient dhe Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenje Sociale, ndërsa për zbatimin e tij kujdeset Kryetari i KK-Gjilan.

IV

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS – GJILAN



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Duke u mbështetur në nenin 12 alineja 1 pika (ë) të Statutit të Komunës së Gjilanit, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 03.10.2006, miraton këtë:

V E N D I M
PËR NDARJEN E LOKACIONIT NË LAGJËN “DARDANIA II” PËR NDËRTIMIN E
OBJEKTIT TË XHAMISË

I

Me këtë vendim i ndahet lokacioni në Lagjen “Dardania II”, Bashkësisë Islame të Kosovës-dega në Gjilan në sipërfaqe prej 5 ari (pesë ari) për ndërtimin e objektit të xhamisë.

II

Obligohet Drejtoria për Urbanizëm, Rindërtim dhe Ambient që të bëjë ndryshimin e Planit Detal Urbanistik në Lagjen “Dardania II”, ndërsa Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë obligohet që të bëjë parcelimin e pronës pas ndryshimit të PDU.

III

Zbatimin e këtij vendimi e bënë Drejtoria për Urbanizëm, Rindërtim e Ambient dhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë e KK-Gjilan, ndërsa për zbatimin e tij do të kujdeset Kryetari dhe Kryeshefi ekzekutiv i KK-Gjilan

IV

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS – GJILAN



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Mbështetur në nenin 12 alineja 1 pika (ë), të Statutit të Komunës së Gjilanit, si dhe në bazë të Rekomandimit të Komitetit për Pronë, Banim dhe Rindërtim, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 26.03.2007, miratoi këtë:

V E N D I M
PËR NDARJËN EHAPSIRËS BANORËVE TË FSHATIT PARTESH PËR
NDËRTIMIN E TERENEVE SPORTIVE

I

Me këtë vendim banorëve të fshatit Partesh u ndahet sipërfaqja e nevojshme për ndërtimin e terreneve sportive në parcelën nr. 53/2 në sipërfaqe prej 0.18.00 ha dhe në parcelën 1909/2 në sipërfaqe prej 0.04.38 ha, Komuna kadastrale Partesh, Pasuri shoqërore, pronë e KK-Gjilan.

II

Autorizohet Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë që pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi të bëjë definimin e sipërfaqes së nevojshme për ndërtimin e terreneve sportive në fshatin Partesh.

III

Zbatimin e këtij vendimi do ta bëjë Drejtoria për Urbanizëm, rindërtim dhe Ambient dhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë e KK-Gjilan, ndërsa për zbatimin e tij kujdeset Kryetari i KK-Gjilan.

IV

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS – GJILAN

Nr.01.1970/0101_____

KRYETARI



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Mbështetur në nenin 6 të Statutit të Komunës së Gjilanit, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e datës 14.06.2007, miratoi këtë:

V E N D I M

I

Me këtë vendim AUTORIZOHEN shefat grupeve parlamentare, pjesëmarrës në Kuvendin Komunal, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër e Pronë dhe Drejtoria për Urbanizëm, Rindërtim dhe Ambient që të përshpejtojnë konsultimet me Shoqatën e Zejtarëve dhe faktorët tjerë relevant të involvuar në këtë çështje, për definimin e hapësirës për ndërtimin e Qendrës Zejtare.

II

Po ashtu me këtë vendim obligohen shefat e grupeve parlamentare të KK-Gjilan, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër e Pronë dhe Drejtoria për Urbanizëm, Rindërtim dhe Ambient, që në afat sa më të shkurtër t'i paraqesin Kuvendit të Komunës së Gjilanit propozimin për caktimin e hapësirës për ndërtimin e Qendrës Zejtare.

III

Zbatimin e këtij vendimi e bënë Kryetari i KK-Gjilan.

IV

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS – GJILAN



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Duke u bazuar në nenin 12 alineja 1 pika (e) dhe (n) të Statutit të Komunës së Gjilanit, dhe nenin 29 të Ligjit mbi Ekspropriimin, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 12.02.20008, miraton këtë:

V E N D I M
PËR NDARJEN E ZONAVE DHE ÇAKTIMIN E ÇMIMIT (KOMPENSIMIT) PËR
TOKËN NDËRTIMORE TË EKSPROPRIUAR PËR VITIN 2008

I

Me këtë vendim përcaktohen zonat për kompensimin e çmimit për tokën ndërtimore të ekspropriuar për vitin 2008.

II

Sipas këtij vendimi, Komuna e Gjilanit ndahet në 5 /pesë/ zona. Zona I-IV është e përkufizuar me koordinata dhe e paraqitur grafikisht në planet kadastrale, ndërsa në zonën e pestë përfshihet zona rurale e komunës.

III

Kompensimi për 1m² sipas zonave është si në vijim:

- Zona e parë, kompensimi orientues nga85-110€ për 1m² ;
- Zona e dytë, kompensimi orientues nga..... 65-85€ për 1m² ;
- Zona e tretë, kompensimi orientues nga45-65€ për 1m² ;
- Zona e katërt, kompensimi orientues nga..... .30-45€ për 1m² ;
- Zona e pestë, kompensimi orientues deri në....30€ për 1m² ;

IV

Vlerësimin e çmimit për kompensim në kuadër të një zone për m² e cakton komisioni profesional të cilin e formon Kryetari i Komunës.

V

Ky vendim hynë në fuqi nga dita e miratimit në Kuvendin Komunal të Gjilanit, ndërsa do të aplikohet në mënyrë retroaktive nga 01.01.2008.

VI

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës, Drejtoria për Urbanizëm, kadastrë dhe mbrojtje të ambientit.

KUVENDI I KOMUNËS-GJILAN



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Në bazë të nenit 3.1 pika (b) dhe (h) të Rregullores 2007/30 mbi ndryshimin e Rregullores nr. 2000/45 mbi Vetëqeverisjen e Komunave të Kosovës dhe me qëllim të mbrojtjes së hapësirave publike, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur me 12.02.2008, miraton këtë:

V E N D I M
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR VLERËSIMIN E INVESTIMEVE NË ISH
QENDRËN ZEJTARE

I. Kuvendi i Komunës miraton vendimin për vlerësimin e investimeve të zejtarëve në ish qendrën Zejtare.

II. Për realizimin e pikës I të këtij vendimi Kuvendi i Komunës formon komisionin për vlerësimin e investimeve.

III. Komisioni ka këtë përbërje:

1. Ali Arifi,
2. Hamdi Ismajli,
3. Behar Mehmeti,

IV. Komisioni do të bëjë vlerësimin e investimeve dhe do të paraqes raport për punën e tij Kuvendit të Komunës.

II. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Planifikimit Urban, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit.

III. Ky vendim hynë në fuqi nga dita e miratimit në Kuvendin e Komunës së Gjilanit.

KUVENDI I KOMUNËS SË GJILANIT



**KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI**

Duke u bazuar në nenin 29 të Ligjit mbi eksproprijimin, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më datë 12.02.2008, miratoi këtë:

**V E N D I M
PËR EKSPROPRIIMIN E TOKËS PËR NDËRTIMIN E SHKOLLËS NË LAGJËN
“QARKU” DHE FORMIMIN E KOMISINIT**

I

Me këtë vendim lejohet eksproprijimi i tokës në Lagjen “Qarku” për nevojat e ndërtimit të Shkollës Filllore në këtë Lagje.

II

Nëse me Planin Detal Urbanistik në këtë Lagje është paraparë destinim tjetër, obligohet Kuvendi i Komunës, përkatësisht Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtje të Ambientit që t’i qaset ndryshimit të PDU, dhe t’i ndërrohet destinimi tokës së eksproprijuar në Lagjen “Qarku”.

III

Po ashtu me këtë vendim formohet komisioni i monitoruar nga Drejtori i Drejtorisë për Arsim dhe Kulturë, dhe i cili do të negocioj me pronarët e mundshëm për eksproprijimin e tokës.

Komisioni do të ketë këtë përbërje:

1. Ibrahim Salihu - PDK,
2. Behar Mehmeti - AKR,
3. Burhan Selmani – AAK,
4. Ramadan Ajvazi - LDK,
5. Isah Bunjaku - LDD,

IV

Komisioni i formuar sipas pikës III të këtij vendimi do të negocioj edhe për mundësin e eksproprijimit të parcelave në Lagjen II, (rruga për fshatin Livoç i Epërm).

V

Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Urbanizmit, Kadastër dhe Mbrojtje të Ambientit e KK-Gjilan.

VI

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS-GJILAN

Nr.1093 / 0101
Gjilan, më 12.02.2008

Kryetari i Komunës,
/Qemajl MUSTAFA/



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Në bazë të nenit të nenit 3 paragrafi 2 të Ligjit për Eksproprijimin, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 12.02.2008, miraton këtë:

V E N D I M
PËR SHPALLJEN E ZONËS SË INTERESIT TË PËRGJITHSHËM NË NGASTRËN
KADASTRALE NR.3294 DHE ZONAVE TJERA NË QYTET

I

Me këtë vendim shpallet zonë me interes të përgjithshëm, për nevojat e Kompleksit të shkollave, ngastra kadastrale nr.3294, pronë e Ekonomisë së Pyjeve në sipërfaqe prej 0.09.45ha. (nëntë ari e dyzet e pesë metra)

Po ashtu me këtë vendim shpallen zona të interesit të përgjithshëm edhe të gjitha tokat tjera në qytet dhe për rreth tij e që janë nën menaxhim të AKM-së por që nevojiten për funksionalizimin e jetës të qytetarëve të komunës.

II

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Arsim dhe kulturë dhe Drejtoria për Urbanizëm, kadastër dhe mbrojtje të ambientit e KK-Gjilan.

III

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS SË GJILANIT

Nr. 01.1094 / 0101
Gjilan, më 12.02.2008

Kryetari i Komunës,

/Qemajl MUSTAFA/



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Në bazë të nenit të nenit 3 paragrafi 2 të Ligjit për Eksproprijimin, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 12.02.2008, miraton këtë:

V E N D I M
PËR SHPALLJEN E ZONËS SË INTERESIT TË PËRGJITHSHËM NË NGASTRËN
KADASTRALE NR.2515-1 DHE NË ZONAT TJERA NË QYTET

I

Me këtë vendim shpallet zonë e interesit të Përgjithshëm, për nevojat e Institutit parashkollorë-edukim, ngastra kadastrale nr.2515-1 në sipërfaqe prej 0.90.20ha.

Po ashtu me këtë vendim shpallen zona të interesit të përgjithshëm edhe të gjitha tokat tjera në qytet dhe për rreth tij e që e janë nën menaxhim të AKM-së, por që nevojiten për funksionalizimin e jetës të qytetarëve të komunës.

II

Ngastra kadastrale si në pikën I të këtij vendimi nëse nuk është pronë Komunale, shpallet zonë e interesit të përgjithshëm shoqëror në tërësi sipas ligjit në fuqi.

III

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Arsim dhe Kulturë dhe Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe mbrojtje të ambientit e KK-Gjilan.

IV

Ky Vendim hynë në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Gjilanit.

KUVENDI I KOMUNËS SË GJILANIT

Nr. 01.1097 / 0101
Gjilan, më 12.02.2008


Kryetari i Komunës,

/Qemajl MUSTAFA/



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: r. "Adem Jashari" pn, www.gjilani-komuna.org; e-mail: zip_gjilan@hotmail.com, tel. 0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 486

Në bazë të nenit 15 dhe 16 të Ligjit për Planifikimin Hapësinor, nr.14/ 2003 dhe Udhëzimit Administrativ për zbatimin e Ligjit për planifikimin hapësinor mbi elementet e themelore të Planit Rregullues Urban, nr. rend. 41, nr. prot.02/05, dhe nenit 12 pika a. dhe b. të Statutit të Komunës së Gjilanit, nenit 6 të Vendimit për aprovimin e Planit Detaj Urbanistik "Zona Perëndimore-Qarku" të Qytetit të Gjilanit, nr. 01-8030/020, të dt. 04. 10/2002, Kuvendi i Komunës së Gjilanit, në seancën e vetë të mbajtur më 16.04.2008, miraton këtë:

V E N D I M

Mbi qasjen e Revidimit të Planit Rregullues Urban (ish PDU): "Zona Perëndimore-Qarku", në Gjilan

I.

Me këtë Vendim i qaset Revidimit të Planit Rregullues Urban (ish Planit Detaj Urbanistik): "Zona Perëndimore-Qarku" të Gjilanit (në tekstin e mëtejme: Plani, i cili përfshinë tërë hapësirën brenda "Zonës Perëndimore-Qarku", në sipërfaqe prej: S= 290 ha. (dyqind e nëntëdhjetë hektar).

II.

Me Planin nga pika 1 e këtij vendimi do të ri planifikohet zgjidhja e hapësirës në kontekst të ndryshimeve të bëra dhe harmonizimin e tyre me nevojat reale dhe mundësitë për të arritur kushte optimale të zhvillimit dhe organizimit hapësinor, rregullimit të tokës ndërtimore, ndërtimit të objekteve për banim dhe destinime tjera sekondare si dhe ndërtimin e objekteve të infrastrukturës komunale me përmbajtje përcjellëse, me qëllim të krijimit të kushteve dhe për zhvillim të qëndrueshëm, kompakt dhe racional Zonës Perëndimore si pjesë e tërësisë së Qytetit të Gjilanit

III.

Plani, duhet të jetë në përputhje me Planin Zhvillimor Urban të Qytetit të Gjilanit.

Plani, mundë të hartohet si tërësi apo në pjesë më të vogla urbane përkatësisht në gjashtë nën zona: "A", "B", "C", "D", "E", "F", të ndara sipas PDU / 2002.

IV.

Plani duhet të përmbajë: Pjesën tekstuale dhe Pjesën grafike.

Pjesa tekstuale dhe pjesa grafike e planit duhet të përmbajë të gjitha elementet e parapara me U.A. për zbatimin e Ligjit për planifikimin hapësinor mbi elementet e themelore të Planit Rregullues Urban, nr. rend. 41, nr. prot.02/05,

V.

Gjatë hartimit të këtij plani, veçmas duhet të sigurohet:

- harmonizimi i organizimit, rregullimit dhe i shfrytëzimit të hapësirës dhe tokës ndërtimore;
- harmonizimin dhe inkorporimin e gjendjes dhe ndërtimeve ekzistuese si dhe organizimin e ndërtimeve të reja përbrenda kufijve të ngastrave kadastrale përkatësisht ndërtimore, duke pasur parasysh kushtet urbanistike teknike dhe hapësimore si dhe oportunitetin e interesave publiko-private;
- organizimin e ndërtimeve të objekteve të karakterit të përgjithshëm publik me përmbajtje përcjellëse (objekteve të arsimit, edukimit, shëndetësisë, mirëqenies sociale, kulturës, sportit, administratës publike etj);
- organizimin e ndërtimeve të objekteve të infrastrukturës komunale me përmbajtje përcjellëse (rrugëve, gjelbërimit publik, hapësirave të lira, rrjeteve të ujësjellësit, kanalizimit fekale dhe atmosferik, rrjetit të përçuesve elektrik, telekomunikues, optik etj);
- mbrojtjen dhe përparimin i vlerave mjedisore, natyrore dhe vlerave të krijuara me punë;
- mbrojtjen e ambientit jetësor dhe mbrojtjen nga fatkeqësitë elementare;
- kushtet hapësimore dhe të planit për realizimin e masave me interes të përgjithshëm shoqëror;
-
-

VI.

Bartës i hartimit të planit caktohet: Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit e Komunës së Gjilanit.

VII.

Bartësi i hartimit të planit sipas pikës 1 të këtij vendimi, është i obliguar që planin ta hartojë në afat prej _____, nga dita e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

VIII.

Projekti i planit duhet vënë në shqyrtim publik dhe komente. Paraqitja e planit për shqyrtim publik dhe koha për dhënien e komenteve duhet të duhet të shpallen në mjetet e informimit.

IX.

Financimi i hartimit të këtij plani do të bëhet nga mjetet buxhetore të KK-ës së Gjilanit.

X.

Plani do të hartohet për periudhën 5 vjeçare.

XI.

Elaborati i këtij plani do të hartohet në 7 kopje të origjinalit.

XII.

Mbi zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës së Gjilanit, Drejtoria për Urbanizëm Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit e Komunës së Gjilanit.

XIII.

Ky Vendim hynë në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS SË GJILANIT

01.Nr. 3268/ 0101
Gjilan, më 16.04.2008


Kryetari I Komunës,

/Qemajl MUSTAFA/



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, www.gjilani-komuna.org; e-mail: zip_gjilan@hotmail.com, tel. 0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 486

Në bazë të nenit 15 dhe 16 të Ligjit për Planifikimin Hapësinor, nr.14/ 2003 dhe Udhëzimit Administrativ për zbatimin e Ligjit për planifikimin hapësinor mbi elementet e themelore të Planit Rregullues Urban, nr. rend. 41, nr. prot.02/05, dhe nenit 12 pika a. dhe b. të Statutit të Komunës së Gjiçanit, Kuvendi i Komunës së Gjiçanit, në seancën e vetë të mbajtur më: **16. Prill/2008**, miraton këtë:

V E N D I M

për qasjen e hartimit të Planit Rregullues Urban: "FIDANISHTE" në Gjiçan

I.

Me këtë Vendim i qaset hartimit të Planit Rregullues Urban: "Fidanishte" në Gjiçan, (në tekstin e mëtejshëm: PRrU) i cili do të përfshijë hapësirën që shtrihet në trekëndëshin: në mes rrugës magjistrale; Gjiçan- Bujanovc duke filluar nga Ura mbi lumin Stanishor përbri Kazermës së TMK-ës, duke vazhduar në drejtim të Bujanovcit deri te bashkimi i rrugës unazore me rrugën magjistrale përball kufirit të Fabrikës për përpunimin e metaleve: "Çeliku" dhe Fabrikës së Baterive NiCD, në Gjiçan, ku kthehet në anën e majtë në drejtim lagjes "Dheu i Bardhë" duke përcjell rrugën unazore ekzistuese deri te ura mbi lumin Stanishor, ku kthehet në drejtim të Qytetit duke përcjellë rrjedhën e poshtme të shtratit të lumit deri të pika nisëse te Ura përbri Kazermës, në sipërfaqe rreth 50.00.00 ha.

II.

Me PRrU nga pika 1 e këtij vendimi do të planifikohet zgjidhja e hapësirës në kontekst të ndryshimeve të bëra dhe harmonizimin e tyre me nevojat reale dhe mundësitë për të arritur kushte optimale të zhvillimit dhe organizimit hapësinor, rregullimit të tokës ndërtimore, ndërtimit të objekteve banesore-afariste dhe destinime tjera sekondare si dhe ndërtimin e objekteve të infrastrukturës komunale me përmbajtje përcjellëse, me qëllim të krijimit të kushteve dhe për zhvillim të qëndrueshëm, kompakt dhe racional kësaj zone dhe inkorporimin e sajë si pjesë e tërësisë së Qytetit të Gjiçanit

III.

PRrU, duhet të jetë në përputhje me Planin Zhvillimor Urban të Qytetit të Gjiçanit.

IV.

PRrU duhet të përmbajë: Pjesën tekstuale dhe Pjesën grafike.

Pjesa tekstuale dhe pjesa grafike e planit duhet të përmbajë të gjitha elementet e parapara me U.A. për zbatimin e Ligjit për planifikimin hapësinor mbi elementet e themelore të Planit Rregullues Urban, nr. rend. 41, nr. prot.02/05,

V.

Gjatë hartimit të këtij plani, veçmas duhet të sigurohet:

- harmonizimi i organizimit, rregullimit dhe i shfrytëzimit të hapësirës dhe tokës ndërtimore;

- harmonizimin dhe inkorporimin e gjendjes dhe ndërtimeve ekzistuese si dhe organizimin e ndërtimeve të reja përbrenda kufijve të ngastrave kadastrale përkatësisht ndërtimore, duke pasur parasysh kushtet urbanistike teknike dhe hapësinore si dhe oportunitetin e interesave publiko-private;
- organizimin e ndërtimeve të objekteve të karakterit të përgjithshëm publik me përmbajtje përcjellëse (objekteve të arsimit, edukimit, shëndetësisë, mirëqenies sociale, kulturës, sportit, administratës publike etj);
- organizimin e ndërtimeve të objekteve të infrastrukturës komunale më përmbajtje përcjellëse (rrugëve, gjelbërimit, publik, hapësirave të lira, rrjeteve të ujësjellësit, kanalizimit fekale dhe atmosferik, rrjetit të përçuesve elektrik, telekomunikes, optik etj);
- mbrojtjen dhe përparimin i vlerave mjedisore, natyrore dhe vlerave të krijuara me punë;
- mbrojtjen e ambientit jetësor dhe mbrojtjen nga fatkeqësitë elementare;
- kushtet hapësinore dhe të planit për realizimin e masave me interes të përgjithshëm publik;

VI.

Bartës i hartimit të planit caktohet: Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit e KK-ës Gjilan.

VII.

Projekti i PRRU duhet vënë në shqyrtim publik dhe komente. Koha për shqyrtim publik dhe dhënien e komenteve duhet të duhet të shpallen në mjetet e informimit.

VIII.

Financimi i hartimit të këtij plani do të bëhet nga mjetet buxhetore të KK-ës së Gjilanit
Financimi mundë të bëhet edhe nga partneriteti publiko-privat, donatorët dhe komuniteti.

IX.

PRRU do të hartohet për periudhën 5 vjeçare, në 7 kopje të origjinalit.

X.

Mbi zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Urbanizëm Kadastër dhe Mbrojtje të **Mjedisit e Komunës së Gjilanit.**

XI.

Ky Vendim hynë në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS SË GJILANIT

Nr. 01.3267 / 0101
Gjilan, më: 16. 04. 2008


Kryetari i Komunës

/ Qemajl MUSTAFA/



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, www.gjilani-komuna.org; e-mail: zip_gjilan@hotmail.com, tel. 0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 486

Në bazë të nenit 15 dhe 16 të Ligjit për Planifikimin Hapësinor, nr.14/2003 dhe Udhëzimit Administrativ për zbatimin e Ligjit për planifikimin hapësinor mbi elementet e themelore të Planit Rregullues Urban, nr. rend. 41, nr. prot.02/05, dhe nenit 12 pika a. dhe b. të Statutit të Komunës së Gjilanit, Kuvendi i Komunës së Gjilanit, në seancën e vetë të mbajtur më: **16. Prill/2008**, miraton këtë:

V E N D I M

për qasjen e hartimit të Planit Rregullues Urban: "KAMPI MONTITH" në Gjilan

I.

Me këtë Vendim i qaset hartimit të Planit Rregullues Urban: "Kampi Montith" në Gjilan, (në tekstin e mëtejme: PRRU) i cili do të përfshijë hapësirën që shtrihet në trekëndëshin: në mes rrugës magjistrale: Gjilan-Bujanovc, duke filluar nga Ura mbi lumin Stanishor te hyrja në Kazermen e TMK-ës, duke vazhduar në drejtim të Bujanovcit deri te udhëkryqi i rrugës së Shillovës me rrugën magjistrale, kthehet në të djathtë në drejtim të fshatit Shillovë dhe përballë Frigoriferit kthehet në të djathtë, duke vazhduar pas Fabrikës së Çelikut dhe Fabrikës së Baterive NiCD duke përcjellë dhe përfshirë trasën e Hekurudhës dhe Auto rrugës së paraparë me PZHK, përgjatë rrjedhës së përroit nëpër livadhe deri te kthesa e madhe afër-përtej Çeshmes në Kuvçë të Ultë, ku kthehet në drejtim të Gjilanit duke përcjellë rrugën ekzistuese: Malishevë-Gjilan, dhe rrjedhën e lumit deri te përmbri Kazermës së TMKës. në sipërfaqe rreth 115.00.00 ha (njëqind e pesëmbëdhjetë hektarë).

II.

Me PRRU nga pika 1 e këtij vendimi do të planifikohet zgjidhja e hapësirës në kontekst të ndryshimeve të bëra dhe harmonizimin e tyre me nevojat reale dhe mundësitë për të arritur kushte optimale të zhvillimit dhe organizimit hapësinor, rregullimit të tokës ndërtimore, ndërtimit të objekteve banesore-afariste dhe destinime tjera sekondare si dhe ndërtimin e objekteve të infrastrukturës komunale me përmbajtje përcjellëse, me qëllim të krijimit të kushteve dhe për zhvillim të qëndrueshëm, kompakt dhe racional kësaj zone dhe inkorporimin e sajë si pjesë e tërësisë së Qytetit të Gjilanit

III.

PRrU, duhet të jetë në përputhje me Planin Zhvillimor Urban të Qytetit të Gjilanit.

IV.

PRrU duhet të përmbajë: Pjesën tekstuale dhe Pjesën grafike.

Pjesa tekstuale dhe pjesa grafike e planit duhet të përmbajë të gjitha elementet e parapara me U.A. për zbatimin e Ligjit për planifikimin hapësinor mbi elementet e themelore të Planit Rregullues Urban, nr. rend. 41, nr. prot.02/05,

V.

Gjatë hartimit të këtij plani, veçmas duhet të sigurohet:

- harmonizimi i organizimit, rregullimit dhe i shfrytëzimit të hapësirës dhe tokës ndërtimore;
- harmonizimin dhe inkorporimin e gjendjes dhe ndërtimeve ekzistuese si dhe organizimin e ndërtimeve të reja përbrenda kufijve të ngastrave kadastrale përkatësisht ndërtimore, duke pasur parasysh kushtet urbanistike teknike dhe hapësinore si dhe oportunitetin e interesave publiko-private;
- organizimin e ndërtimeve të objekteve të karakterit të përgjithshëm publik me përmbajtje përcjellëse (objekteve të arsimit, edukimit, shëndetësisë, mirëqenies sociale, kulturës, sportit, administratës publike etj);
- organizimin e ndërtimeve të objekteve të infrastrukturës komunale më përmbajtje përcjellëse (rrugëve, stacionit të Autobusëve, stacionit të Trenit, gjelbërimit publik, hapësirave të lira, rrjeteve të ujësjellësit, kanalizimit fekale dhe atmosferik, rrjetit të përçuesve elektrik, telekomunikues, optik etj);
- mbrojtjen dhe përparimin i vlerave, kulturore, mjedisore, natyrore dhe vlerave të krijuara me punë;
- mbrojtjen e ambientit jetësor dhe mbrojtjen nga fatkeqësitë elementare;
- kushtet hapësinore dhe të planit për realizimin e masave me interes të përgjithshëm publik, me theks të veçantë për trasetë dhe e Auto rrugës dhe Hekurudhës, Stacionit të Autobusëve dhe Trenit dhe ndërlidhjen e tyre urbane dhe ndër urbane.

VI.

Bartës i hartimit të planit caktohet: Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit e KK-ës Gjilan.

VII.

Projekti i PRrU duhet vënë në shqyrtim publik dhe komente. Koha për shqyrtim publik dhe dhënien e komenteve duhet të duhet të shpallen në mjetet e informimit.

VIII.

Financimi i hartimit të këtij plani do të bëhet nga mjetet buxhetore të KK-ës së Gjilanit

Financimi mundë të bëhet edhe nga partneriteti publiko-privat, donatorët dhe komuniteti.

IX.

PRrU do të hartohet për periudhën 5 vjeçare, në 7 kopje të origjinalit.

X.

Mbi zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit e Komunës së Gjilanit.

XI.

Ky Vendim hynë në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS SË GJILANIT


Nr.01.3748 / 0101
Gjilan, më 16.04.2008

Kryetari i Komunës,
/Qemajl MUSTAFA/



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, www.gjilani-komuna.org; e-mail: zip_gjilan@hotmail.com, tel. 0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 486

Në bazë të nenit 6.1 dhe 6.2. të Ligjit për Planifikimin Hapësinor nr. 14/2003, nenit 12. pika b. dhe nenit 45. pika ii. të Statutit të Komunës së Gjiçanit, Kuvendi i Komunës së Gjiçanit në seancën e mbajtur më 16.04.2008, miraton këtë:

V E N D I M

PËR FORMIMIN E KËSHILLIT TË EKSPERTËVE PËR PLANIFIKIM ZHVILLIMOR TË KOMUNËS SË GJILANIT DHE PLANIFIKIM URBAN TË QYTETIT TË GJILANIT

Neni 1.

Për sigurimin e kushteve për planifikim të qëndrueshëm dhe të barabartë hapësinor të territorit të Komunës së Gjiçanit, mbështetjes profesionale dhe shkencore të dokumenteve të planifikimit hapësinor dhe dokumenteve tjera, Formohet Këshilli i ekspertëve për planifikimin zhvillimor të Komunës së Gjiçanit DHE Planit Zhvillimor Urban të qytetit të Gjiçanit (në tekstin e mëtejshëm: Këshilli) si Organ konsultativ i Kuvendit të Komunës së Gjiçanit, në përbërje prej:

1. Sabri Tahiri,
2. Ali Arifi,
3. Abdyl Hasani,
4. Qefsere Sadriu,
5. Abdyl Aliu,
6. Ismet Mehmeti,
7. Arben Dubova,
8. Bujar Shkodra,
9. Vebi Salihu,
10. Sevdije Hyseni,
11. Zeqirja Rrahmani

Neni 2.

- 2.1. Këshilli përbëhet prej kryetarit, zëvendës kryetarit dhe 6 anëtarëve nga radha e personave profesional, shkencor, publik dhe personave tjerë kompetent për planifikim hapësinor.
- 2.2. Këshillin e udhëheqë dhe e kryeson kryetari i Këshillit, kurse në mungesë të tij, zëvendësi i kryetarit të Këshillit.
- 2.3. Përbërja e këshillit duhet të reflektojë barazi gjinore dhe mundësi të barabarta.
- 2.4. Kuvendi me vendim të veçantë emëron personat e lartshënuar si anëtarë të këshillit

Neni 3.

3. Këshilli ka për detyrë të:

- jep mendime, propozime dhe vërejtje në dokumentet e planifikimit hapësinor (Planin Zhvillimor të Komunës, Planet zhvillimore për zona të veçanta dhe Planin Zhvillimor Urban të Qytetit të Gjilanit) dhe në dokumentet tjera të përcaktuara me Ligjin për Planifikim Hapësinor të Kosovës të cilat i nxjerr: Qeveria e Kosovës, Kuvendi i Kosovës, Kuvendi i Komunës dhe organet e tij nga fusha e planifikimit hapësinor, e që kanë ndërlidhje me territorin e Komunës së Gjilanit.
- shqyrtojë dhe propozojë zgjidhje përkatëse në rastet e mos harmonizimit të strategjive zhvillimore për sektor të ndryshëm të rëndësishëm për planifikimin hapësinor.
- përcjell dhe kujdeset për procedurat nëpër të cilat duhet të kalojnë dokumentet e planifikimit hapësinor të cilat miratohen nga organet e Kuvendit dhe Qeverisë së Kosovës, Kuvendit dhe Qeverisë të Komunës së Gjilanit dhe organeve të tij, në vështirësi të Ligjit për planifikim hapësinor dhe akteve tjera nga fusha e planifikimit hapësinor.
- kryej edhe punë tjera që dalin nga aktet juridike të organeve kompetente nga fusha e planifikimit hapësinor.

3.2. Këshilli duhet ti raportojë Kuvendit të Komunës për punën e vetë.

Neni 4.

Kompensimi për anëtarët e Këshillit

Këshilli është organ konsultativ i Kuvendit, kështu që kompensimi për punën e Këshillit do të caktohet me akt të veçantë.

Neni 5.

Punët administrative-teknike të Këshillit

Për punët administrativo-teknike dhe çështje tjera lidhur me punën e Këshillit është përgjegjës Kuvendi Komunal.

Neni 6.

Këshilli përcakton rregullat e procedurës për punën e tij.

Neni 7.

Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, pushon të vlej Vendimi për formimin e Këshillit të ekspertëve për Planifikim Zhvillimor të Komunës së Gjilanit, nr.01.10254/020 i datës 21.12.2004

Neni 8.

Ky vendim hynë në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS-GJILAN

Nr.01.3740 / 0101
Gjilan, më 16.04.2008


Kryetari i Komunës,

/Qemajl MUSTAFA/



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, www.gjilani-komuna.org; e-mail: zip_gjilan@hotmail.com, tel. 0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 486

Duke u mbështetur në nenin 6 të Ligjit për Planifikim hapësinor, nr. 2003/14 të datës 03.07.2003, nenit 4 të Udhëzimit Administrativ nr.4 për zbatimin e Ligjit për Planifikim hapësinor të datës 27.04.2004 dhe nenit 4 të Vendimit mbi formimin e Këshillit të ekspertëve për planifikim zhvillimor të Komunës së Gjiçanit dhe Planifikim Zhvillimor Urban të Qytetit të Gjiçanit, nr.3740/0101 të datës 16.04.2008, e në bazë të Rekomandimit të Komitetit për Politikë dhe Financa, Kuvendi i Komunës së Gjiçanit në seancën e mbajtur më 16.04.2008, miratoi këtë:

VENDIM

PËR CAKTIMIN E SHUMËS SË KOMPENSIMIT PËR ANËTARËT E KËSHILLIT TË EKSPERTËVE PËR PLANIFIKIM ZHVILLIMOR TË KOMUNËS SË GJILANIT DHE PLANIFIKIM URBAN TË QYTETIT TË GJILANIT

I

Caktohet shuma e kompensimit të anëtarëve të Këshillit të Ekspertëve për planifikim Zhvillimor të Komunës së Gjiçanit, përkatësisht Planifikim Zhvillimor Urban të Qytetit të Gjiçanit.

II

Shuma nga pika I. e këtij vendimi do të epet në formë të mëditjes në shumë prej **50 €**, dhe atë më së shumti dy mëditje mesatarisht brenda 1 muaji.

III

Anëtarëve të Këshillit të cilët janë me banim jashtë qytetit të Gjiçanit iu takon edhe kompensimi i shpenzimeve të udhëtimit sipas çmimeve në transportin publik.

IV

Shuma e kompensimit do të paguhet në formë të mëditjes nga mjetet buxhetore të KK-Gjiçan.

V

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Shërbimi i Kuvendit të Komunës së Gjiçanit

VI

Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, pushon të vlejë vendimi për caktimin e shumës së kompensimit të anëtarëve të Këshillit të Ekspertëve për Planifikim Zhvillimor të Komunës së Gjiçanit, nr.01.2501/020 i datës 31.03.2005.

VI

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Gjiçanit.

KUVENDI I KOMUNËS – GJILAN

Nr.01.3741 / 0101
Gjiçan, më 16.04.2008


Kryetari i komunës,

/Qemajl MUSTAFA/



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, www.gjilani-komuna.org; e-mail: zip_gjilan@hotmail.com, tel. 0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 486

Në bazë të nenit 15 dhe 16 të Ligjit për Planifikimin Hapësinor, nr.14/ 2003 dhe Udhëzimit Administrativ për zbatimin e Ligjit për planifikimin hapësinor mbi elementet e themelore të Planit Rregullues Urban, nr. rend. 41, nr. prot.02/05, dhe nenit 12 pika a. dhe b. të Statutit të Komunës së Gjilanit, Kuvendi i Komunës së Gjilanit, në seancën e vetë të mbajtur më: **16. Prill/2008**, miraton këtë:

V E N D I M

Mbi qasjen e hartimit të Planit Rregullues Urban: “KODRA E THATË”, në Gjilan

I.

Me këtë Vendim i qaset Revidimit të Planit Rregullues Urban “Kodra e Thatë” (ish “Parku i Epërm”) në Gjilan, (në tekstin e mëtejshëm: PRrU) i cili do të përfshijë hapësirën në mes të rrugës magjistrale Gjilan-Ferizaj dhe PDU “Arbëria I” (ish “Q. Qeshme I”) respektivisht pjesën e hapësirës në anën e majtë të rrugës Magjistrale Gjilan-Ferizaj duke filluar nga Stacioni i Autobusëve në Gjilan (para Arkivit Historik), duke përcjellë rrugën ekzistuese në mes Lagjes “Iliria” dhe Fabrikës së Duhanit, përkatësisht varrezave deri te rruga e parë e lagjes “Arbëria I”, ku kthehet në të djathtë duke përcjellë rrugën ekzistuese mbi varreza, deri te rruga e vjetër e Kumanovës, ku kthehet dhe e përcjell të njëjtën deri të kryqëzimi me rrugën “Arbëri-Livoq i Ultë”, kthehet në të djathtë duke përcjellë rrugën e jashtme unazore të paraparë me Plan Zhvillimor Urban të Qytetit të Gjilanit deri të kryqëzimi me rrugën magjistrale Gjilan-Ferizaj (te Plepat), ku kthehet në të djathtë dhe e përcjell rrugën Magjistrale Ferizaj-Gjilan, deri në piken fillestare përballë Arkivit Historik, në sipërfaqe prej përfaqe rreth 120 ha (Njëqindënjëzet hektarë).

II.

Gjatë hartimit të këtij plani, do të tentohet të respektohet vija e ndërtimit dhe rregullimit të Objekteve ekzistuese si që janë: NP.”Kosovatransi”, QTZ: “Bus”, Ndërtesa e Pensionistëve, Shëndetësisë dhe Çështjeve Sociale, Objekti i zjarrfikësve, Ndërtesat e banimit kolektiv përball Spitalit, Fabrika e Duhanit, Halla e Sporteve, Parku i fëmijëve, Fusha e sportit, Varrezat e Qytetit dhe hapësira për rreth tyre, si dhe do të parashihen dhe planifikohen përmbajtje të reja urbanistike në kontekst të ndryshimeve të bëra dhe harmonizimin e tyre me nevojat reale dhe mundësitë për të arritur kushte optimale të zhvillimit dhe organizimit hapësinor, rregullimit të tokës ndërtimore, ndërtimit të objekteve banesore-afariste dhe destinime tjera sekondare si dhe ndërtimin e objekteve të infrastrukturës komunale me përmbajtje përcjellëse, me qëllim të krijimit të kushteve dhe për zhvillim të qëndrueshëm, kompakt dhe racional kësaj zone dhe inkorporimin e sajë si pjesë e tërësisë së Qytetit të Gjilanit.

III.

PRrU, duhet të jetë në përputhje me Planin Zhvillimor Urban të Qytetit të Gjilanit.

IV.

PRrU duhet të përmbajë: Pjesën tekstuale dhe Pjesën grafike.

Pjesa tekstuale dhe pjesa grafike e planit duhet të përmbajë të gjitha elementet e parapara me U.A. për zbatimin e Ligjit për planifikimin hapësinor mbi elementet e themelore të Planit Rregullues Urban, nr. rend. 41, nr. prot.02/05,

V.

Gjatë hartimit të këtij plani, veçmas duhet të sigurohet:

- harmonizimi i organizimit, rregullimit dhe i shfrytëzimit të hapësirës dhe tokës ndërtimore;
- harmonizimin dhe inkorporimin e gjendjes dhe ndërtimeve ekzistuese si dhe organizimin e ndërtimeve të reja përbrenda kufijve të ngastrave kadastrale përkatësisht ndërtimore, duke pasur parasysh kushtet urbanistike teknike dhe hapësinore si dhe oportunitetin e interesave publiko-private;
- organizimin e ndërtimeve të objekteve të karakterit të përgjithshëm publik me përmbajtje përcjellëse (objekteve të arsimit, edukimit, shëndetësisë, mirëqenies sociale, kulturës, sportit, administratës publike etj);
- organizimin e ndërtimeve të objekteve të infrastrukturës komunale më përmbajtje përcjellëse (rrugëve, Stacionit të Autobusëve, gjelbërimit publik, hapësirave të lira, rrjeteve të ujësjellësit, kanalizimit fekale dhe atmosferik, rrjetit të përçuesve elektrik, telekomunikes, optik etj);
- mbrojtjen dhe përparimin i vlerave, kulturore, mjedisore, natyrore dhe vlerave të krijuara me punë;
- mbrojtjen e ambientit jetësor dhe mbrojtjen nga fatkeqësitë elementare;
- kushtet hapësinore dhe të planit për realizimin e masave me interes të përgjithshëm publik.

VI.

Bartës i hartimit të planit caktohet: Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit e KK-ës Gjilan.

VII.

Projekti i PRrU duhet vënë në shqyrtim publik dhe komente. Koha për shqyrtim publik dhe dhënien e komenteve duhet të shpallen në mjetet e informimit.

VIII.

Financimi i hartimit të këtij plani do të bëhet nga mjetet buxhetore të KK-ës së Gjilanit
Financimi mundë të bëhet edhe nga partneriteti publiko-privat, donatorët dhe komuniteti.

IX.

PRrU do të hartohet për periudhën 5 vjeçare, në 7 kopje të origjinalit.

X.

Mbi zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit e Komunës së Gjilanit.

XI.

Ky Vendim hynë në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS SË GJILANIT

Nr.01.3747 / 0101
Gjilan, më 16.04.2008


Kryetari i Komunës,

/ Qemajl MUSTAFA/



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: r. "Adem Jashari" pn, ee.gjilani-komuna.org; e-mail: zip_gjilan@hotmail.com, tel. 0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 486

Në bazë të nenit 15 dhe 16 të Ligjit për Planifikimin Hapësinor, nr.14/ 2003 dhe Udhëzimit Administrativ për zbatimin e Ligjit për planifikimin hapësinor mbi elementet e themelore të Planit Rregullues Urban, nr. rend. 41, nr. prot.02/05, dhe nenit 12 pika a. dhe b. të Statutit të Komunës së Gjilanit, Kuvendi i Komunës së Gjilanit, në seancën e vetë të mbajtur më 16.04.2008, miraton këtë:

V E N D I M

Mbi qasjen e Revidimit të Planeve Rregulluese Urbane të Qytetit të Gjilanit

I.

Me këtë Vendim i qaset Revidimit të Planeve Rregulluese Urbane (Planeve Detaje Urbanistike ekzistuese) të Qytetit të Gjilanit, (në tekstin e mëtejshëm: PRRU), të cilët do të përfshijnë hapësirat nga Planet Detaje Urbanistike ekzistuese të Qytetit të Gjilanit dhe atë PDU: "Pjesa e Vjetër e Qytetit"/1973, 1984 dhe 1984, "Ekonomia e Pyjeve"/1970, "Dardania"/I dhe II/1976, 1981, "Nën Kodra e Dëshmorëve" /," Kodra e Dëshmorëve" I dhe II/1984, "Dheu i Bardhë" I dhe II/1984, "Spitali Regjional-Kosova Petroll"/1984, "Arbëria" I dhe II/1984 dhe "Banja"/1986 si dhe hapësirat e paplanifikuara brenda dhe në afërsi të këtyre planeve, e të cilat më përafërsisht do të caktohen me detyrën projektuese të çdo plani veç e veç.

II.

Revidimi nga pika I. e këtij vendimi nënkupton: plotësimin, ndryshimin, harmonizimin, riplanifikimin, ndryshimin e destinimit, gabaritit, etazhimit dhe shfrytëzimit të hapësirës të përfshirë me planin konkret.

III.

PRRU, duhet të jetë në përputhje me Planin Zhvillimor Urban të Qytetit të Gjilanit. PRRU, mund të hartohet si tërësi e hapësirës së përfshirë me PDU ekzistuese apo në pjesë më të vogla urbane dhe lokacione të veçanta dhe ka për detyrë të përcaktojë caqet e zhvillimit, shfrytëzimit dhe të rregullimit të hapësirës si dhe ndërlidhjen e këtyre planeve me planet apo hapësirat që korrespondojnë dhe përkufizohen me këtë plan.

IV.

Me Planin nga pika 1 e këtij vendimi do të riplanifikohet, ndryshohet, plotësohet dhe harmonizohet zgjidhja e hapësirës në kontekst të ndryshimeve të bëra dhe harmonizimin e tyre me nevojat reale dhe mundësitë për të arritur kushte optimale të zhvillimit dhe organizimit hapësinor, rregullimit të tokës ndërtimore, ndërtimit të objekteve për banim dhe destinime tjera si dhe ndërtimin e objekteve të infrastrukturës komunale me përmbajtje përcjellëse, me qëllim të krijimit të kushteve dhe për zhvillim të qëndrueshëm, kompakt dhe racional lokacioneve që janë si pjesë e tërësisë së Planit Rregullues Urban përkatësisht Planit Zhvillimor Urban të Qytetit të Gjilanit.

V.

PRRU, përkatësisht pjesa e Planit, duhet të përmbajë: Pjesën tekstuale dhe Pjesën grafike. Pjesa tekstuale dhe pjesa grafike e planit duhet të përmbajë të gjitha elementet e parapara me U.A. për zbatimin e Ligjit për planifikimin hapësinor mbi elementet e themelore të Planit Rregullues Urban, nr. rend. 41, nr. prot.02/05,

VI.

Gjatë hartimit të këtij plani, veçmas duhet të sigurohet:

- harmonizimi i organizimit, rregullimit dhe i shfrytëzimit të hapësirës dhe tokës ndërtimore;
- harmonizimin dhe inkorporimin e gjendjes dhe ndërtimeve ekzistuese si dhe organizimin e ndërtimeve të reja përbrenda kufijve të ngastrave kadastrale përkatësisht ndërtimore, duke pasur parasysh kushtet urbanistike teknike dhe hapësimore si dhe oportunitetin e interesave publiko-private;
- organizimin e ndërtimeve të objekteve të karakterit të përgjithshëm publik me përmbajtje përcjellëse (objekteve të arsimit, edukimit, shëndetësisë, mirëqenies sociale, kulturës, sportit, administratës publike, tregtisë, zejtarisë, etj);

- organizimin e ndërtimeve të objekteve të infrastrukturës komunale më përmbajtje përcjellëse (bulevardeve, shesheve, rrugëve, gjelbërimit publik, hapësirave të lira, tregjeve, lokacioneve për destinime rrjeteve të ujësjellësit, kanalizimit fekale dhe atmosferik, rrjetit të përçuesve elektrik, telekomunikues, optik etj);
- mbrojtjen dhe përparimin i vlerave mjedisore, natyrore, dhe vlerave të krijuara me punë;
- mbrojtjen e mjedisit jetësor dhe mbrojtjen nga fatkeqësitë elementare;
- kushtet hapësinore dhe të planit për realizimin e masave me interes të përgjithshëm shoqëror dhe
- programin e rregullimit të hapësirës së përfshirë me at plan.

VII.

Bartës i hartimit të planit caktohet: Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit e Komunës së Gjilanit.,

VIII.

Bartësi i hartimit të planit sipas pikës 1 të këtij vendimi, është i obliguar që planin ta hartojë në bazë të prioriteteve dhe afateve të cilat do të i caktojnë Kuvendi i Komunës së Gjilanit dhe organet e tij.

IX.

Projekti i planit duhet vënë në shqyrtim publik dhe komente. Paraqitja e planit për shqyrtim publik dhe koha për dhënien e komenteve duhet të duhet të shpallen në mjetet e informimit.

X.

Financimi i hartimit të këtyre planeve do të bëhet nga mjetet buxhetore të KK-ës së Gjilanit. Financimin e hartimit të PRRU-ve ose pjesëve të PRRU, mund të bëhet edhe nga palët e treta, me pëlqimin paraprak dhe në koordinim e mbikëqyrje të Drejtorisë për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit e Komunës së Gjilanit.

XI.

PRRU, do të hartohet për periudhën 5 vjeçare, në 7 kopje të origjinalit.

XII.

Mbi zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës së Gjilanit, Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit e Komunës së Gjilanit.

XIII.

Ky Vendim hynë në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS SË GJILANIT

01.Nr.3269 / 0101
Gjilan, më 16.04.2008


Kryetari i Komunës,

/Qemajl MUSTAFA/



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, www.gjilani-komuna.org; e-mail: zip_gjilan@hotmail.com, tel. 0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 486

Duke u bazuar në nenin XIV të Vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores mbi për caktimin e lartësisë së kompensimit të anëtarëve të kuvendit dhe ndalesave të stafit të Shërbimit Civil Administrativ, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 05.06.2008, miratoi këtë:

V E N D I M
PËR KOMPENSIMIN E ORGANIT PËR PRANIMIN TEKNIK TË PROJEKTEVE
KAPITALE NË KOMUNËN E GJILANIT

I

Me këtë vendim caktohet lartësia e kompensimit të organit për pranimin teknik të projekteve kapitale në Komunën e Gjilanit, investues i të cilave është Komuna e Gjilanit dhe donatorët tjerë.

II


Lartësia e kompensimit të organit për pranimin teknik të projekteve kapitale në territorin e Komunës së Gjilanit do të jetë si në vijim:

1. për projektet në vlerë deri në 20.000,00€ kompensimi për pranimin teknik do të jetë 300.00€,
2. për projektet në vlerë mbi 20.000,00€ e deri në 40.000,00€, kompensimi për pranimin teknik do të jetë 400,00€,
3. për projektet në vlerë mbi 40.000,00€ e deri në 60.000,00€, kompensimi për pranimin teknik do të jetë 600,00€,
4. për projektet në vlerë mbi 60.000,00€ e deri në 100.000,00€, kompensimi për pranimin teknik do të jetë 1000,00€,
5. për projektet në vlerë mbi 100.000,00€ shuma e projektit ndahet në kufijtë për të cilët aplikohet përqindja sipas indekseve për kompensim, të përcaktuar si në vijim:
 - a) Kufiri i parë me indeks 1.5 % dhe përfshinë pjesët e kontratës mbi 100.000€ e deri në 150.000 €,
 - b) Kufiri i dytë ka indeksin 1.0 % dhe përfshinë pjesët e kontratës mbi 150.000€ e deri në 200.000 €,
 - c) Kufiri i tretë ka indeksin 0.80 % dhe përfshinë pjesët e kontratës mbi 200.000€ e deri në 400.000 €,
 - d) Kufiri i katërtë ka indeksin 0.70 % dhe përfshinë pjesët e kontratës mbi 400.000€ e deri në 600.000 €,
 - e) Kufiri i pestë ka indeksin 0.60 % dhe përfshinë pjesët e kontratës mbi 600.000€ e deri në 800.000 €,
 - f) Kufiri i gjashtë ka indeksin 0.50 % dhe përfshinë pjesët e kontratës mbi 800.000 €,



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, ee.gjilani-komuna.org; e-mail: zip_gjilan@hotmail.com, tel. 0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 486

Në bazë të nenit 2.2. të Rreg. UNMIK-ut, nr. 2006/5, mbi kalimin e pasurisë tokësore që është nën autoritetin e administrimit të Agjencionit Kosovar të Mirëbesimit, të Administratës komunale, për qëllime të përfitimit publik, nenit 3, paragrafi 2. të ligjit për Ekspropriimin dhe duke u bazuar në Rekomandimin e Komitetit për Politikë dhe Financa të KK-ës Gjiçan, e në vështrim të nenit 38.1. pika h. të Statutit të Komunës së Gjiçanit, Kuvendi i Komunës së Gjiçanit në seancën e mbajtur më datë 05.06.2008, miraton këtë:

V E N D I M P A R I M O R

Për Lejimin e ndërrimit të pronës së paluajtshme

I.

Me këtë Vendim, Komunës së Gjiçanit, i l e j o h e t ndërrimi pronave të paluajtshme me Agjencionin Kosovar të Mirëbesimit dhe atë si vijon:

- a. Ngastrat kadastrale nr. 1943; 1973; 1944; 1942; 1941; 1940; 1939; 1938 dhe 1945, ZK-Gjiçan, në sip. të përgjithshme prej: 0.1.84.53 ha, e regjistruar në Fetën Poseduese nr. 3643, në emër të NSH. : Shoqata Auto Moto - " Drita" në Gjiçan, me
- b. Ngastrat kadastrale nr. 2/o, në sip. 0.05.60 ha; ng. kad. 3/0, në sip. 0.28.69 ha; ng. kad. 4/0, në sip. 0.5157 ha; ng. kad. 5/0 në sip. 0.22.47; ng. kad. 6/0, në sip. 0.47.35 ha; ng. kad. 7/0, sip. 0.29.69 ha; ng. kad. ??, sip. 0.28.69 ha; ng. kad. 8/0, sip. 0.35.51 ha; ng. kad. 9/0, sip. 0.17.85 ha; ng. kad. 11/2, sip. 0.34.59 ha; ng. kad. 22/0, sip. 0.15.65 ha; ng. kad., të gjitha në vendin e quajtur: "Gllama", ZK-Gjiçan, në Fletë Posedimin. Nr. 1750 në emër të KK-ës Gjiçan si dhe ng. kad. 4506/2. në sip. 1.86.76 ha, vendi i quajtur "Kalila", ZK-Koretishtë, e evidentuar në Fletë posedimin. Nr. 516, në emër të KK-ës Gjiçan.

II.

Ndërrimi i paluajtshmërive nga pika I. e këtij vendimi, bëhet me qëllim të realizimit të interesit të përgjithshëm publik, për sigurimin e lokacioneve për nevoja të ndërtimit të objekteve të institucioneve të pushtetit Qendror dhe Lokal, përkatësisht ndërtimit të objektit për nevoja të Shërbimit Policor të Kosovës, Njësia Regjionale-Gjiçan.

III.

Autorizohet Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit që në bashkëpunim me AKM-në të angazhojë një Vlerësues të pavarur për vlerësimin e paluajtshmërive konkrete, dhe pas pajtimit të arritur të bëjë nënshkrimin e marrëveshjes për ndërrim dhe regjistrimin e pronave konkrete në emër të pronarëve të rinj.

IV.

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset, Kryetari i Komunës së Gjiçanit dhe Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit të KK-ës Gjiçan.

V.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS SË GJILANIT

Nr. 01. 5468
Gjiçan, më 05.06.2008


Kryetari i Komunës

/ Qemajl MUSTAFA /



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, www.gjilani-komuna.org; e-mail: zip_gjilan@hotmail.com, tel. 0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 486

Në bazë të nenit 3 të Ligjit për Eksproprijimin ("g.z. e Kosovës" nr. 21/78, 46/86), nenit 10.1. pika a, b, dhe c. (Ligji nr. 02/L-18 "GZK-IPVQ" nr. 7/2006), nenit 8.2.a. (Ligji nr. 2002/8, "GZK-IPVQ", nr. 212/2008), nenit 38.1.d. të Statutit të Komunës së Gjilanit, Kuvendi i Komunës së Gjilanit, në seancën e vetë të mbajtur më 05.06.2008, miraton këtë:

VE N D I M

Për shpalljen e Kompleksit: "Kalaja e Pogradjës", zonë turistike me interes të veçantë

I.

Me këtë vendim, kompleksi i Kalasë së Pogradjës, shpallet: Zonë Turistike e Interesit të Veçantë, dhe përbëhet nga 3 zona dhe atë:

1. Zona e I-rë e cila përfshinë këto ngastra kadastrale: nr. 1920; 1919; 1918; 1917; 1916; 1915; 1963 1964; 1962 dhe 1879, duke u përfshirë dhe përkufizuar me shtratin e Lumit "Morava" "Llapusha".
2. Zona e II-të e cila përfshinë këto ngastra kadastrale nr. 1941, 1932; 1933; 1931; 1921; 1940; 1942; 1943; 1945; 1924; 1922; 1921; 1923; 1944; 1929; 1930; 1925; 1928; 1927; 1926; 1914; 1913; 1912; 1911; 1384 pjesërisht); 1984/1; 1985; 1986; 1978; 1976; 1979; 1980; 1981; 1982 1983 dhe 1977 (pjesërisht) duke u përkufizuar pjesërisht me rrugën e vjetër Uglarë-Pogradjë, rrugën e Gjilan-Pogradjë, jazin e mullirit nga lumi "Llapusha" duke u kthyer në dhe vijuar në drejtim të pikës fillestare; si dhe
3. Zona e III-të e cila përfshinë zonën mbrojtëse në të cilën hyjnë të ngastrat kadastrale, përkatësisht pjesët e ngastrave kadastrale që përkufizohen me zonën e II-të e sipas konfiguracionit të terrenit dhe elementeve tjera paraqesin një tërësi fizikisht të përshtatshme.
- 4.

II.

Në territorin e përshkruar në pikën I. të këtij vendimi, ndalohet çdo lloj ndërtimi dhe ndërmarrja e çdo aktiviteti, i cili degradon mjedisin, pa u pajisur paraprakisht me leje-pëlqim përkatës-e.

III.

Autorizohet Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit që të i qaset përgatitjes dhe hartimit të Planit Rregullues të territorit të përfshirë me këtë Vendim.

IV.

Plani nga pika III. e këtij Vendimi do të përbëjë dokumentin themelor për realizimin e programit të rregullimit të hapësirës së këtij kompleksi.

V.

Ngastrat kadastrale të përfshira me këtë plan e të cila nuk janë pronë Komunale, shpallen me interes të përgjithshëm shoqëror në tërësi sipas ligjit në fuqi.

VI.

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është paraqitja grafike në planin situacional.

VII.

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit e Komunës së Gjilanit.

VIII.

Ky Vendim hynë në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS SË GJILANIT


01.Nr. 5471
Gjilan, më 05.06.2008

Kryetari i Komunës,
Qemajl Mustafa



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, www.gjilani-komuna.org; e-mail: zip_gjilan@hotmail.com, tel. 0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 486

Në bazë të nenit 3 të Ligjit për Eksproprijimin ("g.z. e Kosovës" nr. 21/78, 46/86), nenit 10.1. pika a, b, dhe c. (Ligji nr. 02/L-18 "GZK-IPVQ" nr. 7/2006), nenit 8.2.a. (Ligji nr. 2002/8, "GZK-IPVQ", nr. 212/2008), nenit 38.1.d. të Statutit të Komunës së Gjilanit, Kuvendi i Komunës së Gjilanit, në seancën e vetë të mbajtur më 05.06./2008, miraton këtë:

VE N D I M

Për shpalljen e Kompleksit të vargmaleve të Stanishorit, zonë me interes të veçantë për Sport dhe Rekreacion

I.

Me këtë vendim, kompleksi i vargmaleve mbi fshatin Stanishor, shpallen: Zonë e Interesit të Veçantë për Sport dhe Rekreacion, dhe përfshinë hapësirën në anën e djathtë duke filluar nga ura në fshatin Stanishor-rruga Gjilan Artanë (Novobërdë) deri te kufiri kadastral të Komunës së Artanës dhe Komunës së Gjilanit-Maja e Gjelbër-ku kthehet në drejtim të Gjilanit deri mbi fshatin Stanishor.

II.

Në territorin e përshkruar në pikën I. të këtij vendimi, ndalohet çdo lloj ndërtimi dhe ndërmarrja e çdo aktiviteti, i cili degradon mjedisin, pa u pajisur paraprakisht me leje-pëlqim përkatës-e.

III.

Autorizohet Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit që të i qaset përgatitjes dhe grumbullimit të shënimeve dhe hartimit të Elaboratit përkatës të hapësirës dhe Planit Rregullues të territorit të përfshirë me këtë Vendim.

IV.

Plani nga pika III. e këtij Vendimi do të përbëjë dokumentin themelor për realizimin e programit të rregullimit të hapësirës së këtij kompleksi.

V.

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit e Komunës së Gjilanit.

VI.

Ky Vendim hynë në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS SË GJILANIT

01.Nr. 5472
Gjilan, më 05.06.2008


Kryetari i Komunës,

/Qemajl MUSTAFA/



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, www.gjilani-komuna.org; e-mail: zip_gjilan@hotmail.com, tel. 0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 486

Në bazë të Nenit 21 alineja 3 dhe 6 të Ligjit mbi Eksproprijim (Gaz. Zyrtare e Kosovës nr. 21/78), si dhe në bazë të Rekomandimit të Komitetit të për Politikë dhe Financa, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur me 05.06.2008, miraton këtë:

V E N D I M PËR ANULIM DHE DEEKSPROPIJIM

- IV. **Anulohen** Vendimet për eksproprijim të paluajtshmërive në lagjen Arbëria ish "Qenar Qeshme" nr.1 të vitit 1988 dhe 1989 të marra nga poseduesit dhe të cilat janë regjistruar në favor të ish BVI-së për Banim dhe Veprimtari Komunale Banesore të Komunës së Gjilanit me qëllim të realizimit të Planit të atëhershëm Detal Urbanistik.
- V. **Deeksproprijohen** paluajtshmëritë e eksproprijuara sipas vendimeve të cekura në pikën 1 të këtij vendimi, dhe duhet të regjistrohen në emër të pronarëve.
- VI. Sipërfaqet tokësore të cilat janë të parapara për rrugë publike nuk do të përfshihen me këtë vendim.
- VII. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Urbanizimit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit.
- VIII. Ky vendim hynë në fuqi nga dita e miratimit në Kuvendin e Komunës së Gjilanit.

KUVENDI I KOMUNËS SË GJILANIT

Nr. 01/
Gjilan, 05.06.2008


Kryetari i Komunës

/Qemajl Mustafa/



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, www.gjilani-komuna.org; e-mail: zip_gjilan@hotmail.com, tel. 0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 486

Duke u bazuar në nenin 52.1 pika (e) të Statutit të Komunës së Gjiçanit, si dhe bazuar në Rekomandimin e Komitetit për Politikë dhe Financa të datës 16.05.2008, Kuvendi i Komunës së Gjiçanit në seancën e mbajtur më 05.06.2008, miratoi këtë:

V E N D I M
PËR ANULIMIN E VENDIMIT PËR NDARJEN E LOKACIONIT SHËRBIMIT
POLICOR TË KOSOVËS-KOMANDËS REGJIONALE NË GJILAN

I

Me këtë vendim anulohet vendimi nr.01.1241/0101, për ndarjen e lokacionit Shërbimit Policor të Kosovës-Komandës Regjionale në Gjiçan, i miratuar nga Kuvendi i Komunës së Gjiçanit në seancën e datës 27.02.2007, sipas të cilit SHPK-së i është ndarë sipërfaqja prej 0.50.00ha nga sipërfaqja e gjithëmbarshme prej 0.78.88ha për ndërtimin e objektit të Komandës Regjionale të Policisë në Gjiçan.

II

Obligohet Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit që t'i anulojnë të gjitha veprimet procedurale rreth parcelimit të ngastrës sipas vendimit të mëparshëm.

III

Zbatimin e këtij vendimi e bënë Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit, ndërsa për zbatimin e tij kujdeset Kryetari i Komunës së Gjiçanit.

IV

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Gjiçanit.

KUVENDI I KOMUNËS-GJILAN

01.Nr. 5467
Gjiçan, më 05.06.2008


Kryetari i Komunës,

/Qemajl MUSTAFA/



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, [ëëë.gjilani-komuna.org](http://ee.gjilani-komuna.org); e-mail: zip_gjilan@hotmail.com, tel. 0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 486

Duke u bazuar në nenin 38.1 pika (h) dhe nenin 38.2 pika (c) të Statutit të Komunës së Gjilanit, si dhe bazuar në Rekomandimin e Komitetit për Politikë dhe Financa të datës 16.05.2008, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 05.06.2008, miratoi këtë:

V E N D I M

PËR RREGULLIMIN E TERRENE SPORTIVE NË FSHATIN MIRESH

I

Me këtë vendim bëhet rregullimi i terreneve (fushave) sportive në oborrin e Shkollës fillore në fshatin në fshatin Miresh.

II

Rregullimi i terreneve sportive në oborrin e Shkollës fillore në fshatin Miresh do të realizohet sipas projektit të zbatueshëm për këto terrene e të cilat do të shfrytëzohen nga nxënësit dhe rinia e fshatit Miresh.

III

Zbatimin e këtij vendimi e bënë Drejtoria për Planifikimit Urban, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe Drejtoria për Arsim dhe Kulturë, në bashkëpunim me Zyrën për projekte, ndërsa për zbatimin e tij kujdeset Kryetari i Komunës së Gjilanit.

IV

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Gjilanit.

KUVENDI I KOMUNËS-GJILAN

01.Nr. 5459
Gjilan, më 05.06.2008


Kryetari i Komunës,

/Qemajl MUSTAFA/



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, [ëëë.gjilani-komuna.org](http://ee.gjilani-komuna.org); e-mail: zip_gjilan@hotmail.com, tel. 0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 486

Duke u bazuar në nenin XIV të Vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores mbi përcaktimin e lartësisë së kompensimit të anëtarëve të Kuvendit dhe ndalesave të stafit të Shërbimit Civil Administrativ, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 05.06.2008, miratoi këtë:

V E N D I M PËR KOMPENSIMIN E ORGANIT MBIKËQYRËS NË REALIZIMIN E PROJEKTEVE KAPITALE

I

Me këtë vendim caktohet lartësia e kompensimit të Organit mbikëqyrës në realizimin e projekteve kapitale në territorin e Komunës së Gjilanit, investues i të cilave është Komuna e Gjilanit dhe donatorët tjerë.

II

Lartësia e kompensimit për Organin mbikëqyrës në realizimin e projekteve kapitale në Komunën e Gjilanit do të jetë si në vijim:

1. për projektet në vlerë deri në 20.000,00€ kompensimi për mbikëqyrje do të jetë 400.00€,
2. për projektet në vlerë mbi 20.000,00€ e deri në 40.000,00€, kompensimi për mbikëqyrje do të jetë 600,00€,
3. për projektet në vlerë mbi 40.000,00€ e deri në 60.000,00€, kompensimi për mbikëqyrje do të jetë 1000,00€,
4. për projektet në vlerë mbi 60.000,00€ e deri në 100.000,00€, kompensimi për mbikëqyrje do të jetë 1.600,00€,
5. për projektet në vlerë mbi 100.000,00€ shuma e projektit ndahet në kufijtë për të cilët aplikohet përqindja sipas indekseve për kompensim, të përcaktuar si në vijim:
 - a) Kufiri i parë me indeks 2% dhe përfshinë pjesët e kontratës mbi 100.000€ e deri në 150.000€,
 - b) Kufiri i dytë ka indeksin 1.5% dhe përfshinë pjesët e kontratës mbi 150.000€ e deri në 200.000€,
 - c) Kufiri i tretë ka indeksin 1.0% dhe përfshin pjesët e kontratës mbi 200.000€,
 - d) Vlëra e kompensimit për mbikëqyrje të një projekti me vlerë mbi 100.000 €, fitohet duke i mbledhur shumat e fituara nga nënpikat a), b) dhe c), të pikës 5 (pesë).

III

Anëtari i Organit mbikëqyrës në realizimin e projekteve kapitale duhet të jetë person i kualifikuar në lëmin përkatëse profesionale, me përgatitje profesionale superiore. Nëse një projekt kapital realizohet në bashkëfinancim edhe me donatorë tjerë, atëherë komisionit do t'i takoj kompensimi vetëm në pjesën për të cilën bashkë financon Komuna e Gjilanit.

IV

Ky vendim do të jetë i përkohshëm dhe do të vlej deri në nxjerrjen e një Rregullore të re për kompensimin e komisioneve të formuara nga Kuvendi i Komunës së Gjilanit.

V

Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi pushon të vlej Vendimi për kompensimin e organit për mbikëqyrjen profesionale të ndërtimit të objekteve në territorin e Komunës së Gjilanit, nr.01.5024/020 i nxjerr nga Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e datës 29.05.2003.

VI

Zbatimin e këtij vendimi e bënë Zyra e Prokurimit, ndërsa për zbatimin e tij kujdeset Kryetari Komunës së Gjilanit.

VII

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Gjilanit.

KUVENDI I KOMUNËS-GJILAN

01.Nr. 5465
Gjilan, më 05.06.2008


Kryetari i Komunës,

/ Qemajl MUSTAFA/



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, www.gjilani-komuna.org; e-mail: zip_gjilan@hotmail.com, tel. 0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 486

Në bazë të nenit 44.2 të Rregullores nr.2007/30 dhe nenit 38.1 pika (h) të Statutit të Komunës së Gjilanit, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 24.06.2008, miraton këtë:

V E N D I M

Për lejimin e vendosjes së objekteve të karakterit të përkohshëm të tipit montues-Kiosqeve në QTZ "Argjendaria" në Gjilan

I

Me këtë vendim, lejohet vendosja e 21. objekteve të karakterit të përkohshëm, të tipit montues-Kiosqeve, për ushtrimin e veprimtarisë Tregtare Zejtare të Argjendarisë, në lokacionin prapa Xhamisë së Madhe dhe Ndërtesës kolektive banesore afariste "B+P+3" në Gjilan, përkatësisht në pjesën e ngastrës kadastrale nr.3682, vendi i quajtur "Qytet", Zona kadastrale-Gjilan, e evidentuar në Fletë posedimin nr.1751, si Pasuri shoqërore e rrugëve të Komunës së Gjilanit.

II

Vendosja e objekteve nga pika I. e këtij vendimi, do të bëhet në tërësi sipas zgjidhjes urbanistike për organizimin e shfrytëzimit të hapësirës që do ta hartojë Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit e Komunës së Gjilanit, dhe vendosje e objekteve të karakterit montues-kiosqeve do të bëhet përgjatë përdhësës së ndërtesës së banimit.

III

Autorizohet Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit e Komunës së Gjilanit, që në emër të Komunës së Gjilanit, të bëjë nënshkrimin e kontratave për dhënien në shfrytëzim të përkohshëm të paluajtshmërive nga pika I. e këtij vendimi, në afat prej 1 viti nga dita e miratimit të këtij vendimi, me mundësi të vazhdimit.

Kontrata mundë të shkëputet edhe para afatit të paraparë në paragrafin 1 të kësaj pike, me paralajmërim paraprak, përkatësisht një (1) muaj para shkëputjes.

IV

Financimi i vendosjes së kiosqeve dhe rregullimi i hapësirës dhe dokumentacionit investivo-teknik, do të bëhet me marrëveshje të veçanet për investim dhe shfrytëzimin e kiosqeve, pas miratimit të këtij dokumentacioni nga DUKMM.

V

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës së Gjilanit, Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit e Komunës së Gjilanit.

VI

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Gjilanit.

KUVENDI I KOMUNËS-GJILAN

01.Nr. 6170
Gjilan, më 24.06.2008


Kryetari i Komunës,

/Qemajl MUSTAFA/



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, www.gjilani-komuna.org; e-mail: zip_gjilan@hotmail.com, tel. 0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 486

Në bazë të nenit 44.2 të Rregullores nr.2007/30 dhe nenit 38.1 pika (h) të Statutit të Komunës së Gjilanit, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 24.06.2008, miraton këtë:

V E N D I M

Për dhënien në shfrytëzim të përkohshëm të pronës komunale për ndërtimin e Xhamive

I

Me këtë vendim Këshillit të Bashkësisë islame në Gjilan, me qëllim të ndërtimit të Xhamive, i epën në shfrytëzim të përkohshëm këto prona:

- a. Për ndërtimin e Xhamisë në Fshatin **Vërbicë e Kmetovcit**, Komuna e Gjilanit, sipërfaqja prej: **0.10.74** ha, (1.074m²) nga pjesa e ngastrës kadastrale nr.362/1, në sipërfaqe të përgjithshme prej: 1.31.96 ha, vendi i quajtur: "Luginjë", Zona kadastrale: Verbicë e Kmetovcit, e evidentuar në Fletë posedimin nr.56, Pasuri shoqërore e Komunës së Gjilanit, dhe
- b. Për ndërtimin e Xhamisë në Fshatin **Ponesh**, Komuna e Gjilanit, sipërfaqja prej: **0.07.61** ha (761m²) nga pjesa e ngastrës kadastrale nr.3356, në sipërfaqe të përgjithshme prej 0.69.93 ha, Vendi i quajtur: "Ponesh", Zona kadastrale: Ponesh, e evidentuar në Fletë posedimin nr.336, në emër të: Pasuri Shoqërore e Komunës së Gjilanit.

II

Ndërtimi i objekteve nga pika I e këtij vendimi dhe organizimit të hapësirës do të bëhet në tërësi sipas paraqitjes grafike në kopje të planit të datës: 07.12.2007, të hartuar nga Sektori i Planifikimit të Drejtorisë për Urbanizëm, Rindërtim dhe Ambient e Komunës së Gjilanit të cilat janë pjesë përbërëse e këtij vendimi.

III

Autorizohet Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit e Komunës së Gjilanit, që në emër të Komunës së Gjilanit, të bëjë nënshkrimin e kontratave për dhënien në shfrytëzim të përkohshëm të paluajtshmërive nga pika I. e këtij vendimi, në afat prej dhjetë (10) vitesh nga dita e nënshkrimit të kontratës.

Kushtet e dhënies në shfrytëzim të përkohshëm dhe mënyra e kompensimit do të caktohen me kontratë të veçanet si në paragrafin 1 të kësaj pike.

IV

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës së Gjilanit, Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit e Komunës së Gjilanit.

V

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Gjilanit.

KUVENDI I KOMUNËS-GJILAN

01.Nr. 6171
Gjilan, më 24.06.2008


Kryetari i Komunës,

/Qemajl MUSTAFA/



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, www.gjilani-komuna.org; e-mail: zip_gjilan@hotmail.com, tel. 0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 486

Në bazë të nenit 17.1, 20 dhe 24.1 dhe 2. të Ligjit për Planifikim Hapësinor, nr. 2003/14, nenit 38.1 pika (h). të Statutit të Komunës së Gjilanit, Kuvendi i Komunës së Gjilani, në seancën e mbajtur më datë: 04.07.2008, miraton këtë:

V E N D I M

Për Revidimin e një pjese të PDU: "Qytet i Vjetër" te Xhamia e Vogël

I.

Me këtë vendim bëhet revidimi (plotësimi dhe ndryshimi) i një pjese të Planit Detaj Urbanistik: "Qytet i Vjetër" në hapësirën në mes rrugëve nga Xhamia e Vogël deri të kufiri i pronës së ish NTPSH: "Kualiteti" në Gjilan.

II.

Revidimi nga pika I. e këtij vendimi, nënkupton: plotësimin dhe ndryshimin të 1/2 të ng.kad. nr. 4592 nga destinimi: rrugë dhe rregullim i hapësirës në destinim: *banim kolektiv*, ndërrimin e destinimit të ng.kad. nr. 4593 nga banimi individual në: *banim kolektiv*, dhe plotësimit të PDU ekzistues të ngastrave kadastrale nr. 4595 dhe 4595/2, në aspekt të: pozitës në hapësirë, gabaritit dhe etazhitetit, në tërësi sipas paraqitjes grafike e cila është pjesë përbërëse e këtij Vendimi, dhe në harmoni të plotë me rregullat teknike të urbanizmit.

III.

Obligohet Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit e Komunës së Gjilanit që revidimin sipas pikës I. dhe II. të këtij vendimi ta inkorporoj në Planin Detaj Urbanistik: " Qytet i Vjetër".

IV.

Nga dita e hyrjes në fuqi e këtij vendimi, pushon të vlejë pjesa e PPlanit Detaj Urbanistik i përfshirë me këtë revidim.

V.

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës së Gjilanit dhe Drejtoria për Urbanizëm Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit e KK-ës Gjilan,

VI.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS SË GJILANIT

01.Nr. 3539
Gjilan, më 04.07.2008


Kryetari i komunës,

/Qemajl MUSTAFA/



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, www.gjilani-komuna.org; e-mail: zip_gjilan@hotmail.com, tel. 0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 486

Në bazë të nenit 3 paragrafi 2 të Ligjit për Eksproprijimin dhe nenit 38.1 pika (h). të Statutit të Komunës së Gjiçanit, Kuvendi i Komunës së Gjiçanit, në seancën e mbajtur më date 04.07.2008, miraton këtë:

V E N D I M

Për lejimin e ndërrimit të pronës së paluajtshme

I.

Me këtë Vendim, Komunës së Gjiçanit i **Lejohet ndërrimi** i kësaj prone të paluajtshme:

a. sipërfaqes prej: **0.00.78** ha, (78,0m²) të pjesës së ngastrës kadastrale nr. 4790, parcelë, vendi i quajtur: "Qytezë-Mirushë", ZK-Gjiçan e evidentuar në Fletë Posedimin nr. 1752, në emër të Pasuri Shoqërore e - Ujërat e KK-ës Gjiçan,

me

b. sipërfaqen prej **0.00.78** ha (78,0m²), të pjesës së ngastrës kadastrale nr. 3321, në sipërfaqe prej gjithsej: 0.04.00 ha, me kulturë: parcelë, vendi i quajtur: "Qytezë-Mirushë", ZK. Gjiçan, e evidentuar në Fletë Posedimin nr. 7447, në emër të Hatixhe /Murat / Kastratit nga Gjiçani.

II.

Ndërrimi i paluajtshmërive nga pika I. e këtij vendimi, bëhet më qëllim të kompletimit të truallit të Hatixhe Kastratit nga Gjiçani, për shkak të ndryshimit të kamotshëm të shtratit të lumit "Mirusha" si pasojë e vërshimeve.

III.

Autorizohet Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit e KK-ës Gjiçan, që në emër të Komunës së Gjiçanit, të bëjë nënshkrimin e marrëveshjes për ndërrimin e paluajtshmërive nga pika I. e këtij vendimi dhe të bëjë regjistrimin e pronave të ndërruara në emër të pronarëve të rinj, në tërësi sipas paraqitjes grafike që është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

IV.

Mbi zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës së Gjiçanit, Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit e Komunës së Gjiçanit.

V.

Ky Vendim hynë në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS SË GJILANIT

01.Nr. 6540
Gjiçan, më 04.07.2008


Kryetari i komunës,

/Qemajl MUSTAFA/



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, www.gjilani-komuna.org; e-mail: zip_gjilan@hotmail.com, tel. 0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 486

Duke u mbështetur në nenin 6 të Ligjit për Planifikim hapësinor, nr. 2003/14 të datës 03.07.2003, nenit 4 të Udhëzimit Administrativ nr.4 për zbatimin e Ligjit për Planifikim hapësinor të datës 27.04.2004 dhe nenit 4 të Vendimit mbi formimin e Këshillit të ekspertëve për planifikim zhvillimor të Komunës së Gjilanit dhe Planifikim Zhvillimor Urban të Qytetit të Gjilani, nr.3740/0101 të datës 16.04.2008, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 04.07.2008, miratoi këtë:

VENDIM

PËR CAKTIMIN E SHUMËS SË KOMPENSIMIT PËR ANËTARËT E KËSHILLIT TË EKSPERTËVE PËR PLANIFIKIM ZHVILLIMOR TË KOMUNËS SË GJILANIT DHE PLANIFIKIM URBAN TË QYTETIT TË GJILANIT

I

Caktohet shuma e kompensimit të anëtarëve të Këshillit të Ekspertëve për planifikim Zhvillimor të Komunës së Gjilanit, përkatësisht Planifikim Zhvillimor Urban të Qytetit të Gjilanit.

II

Shuma nga pika **I**. e këtij vendimi do të epet në formë të mëditjes në shumë prej **70 € bruto**, dhe atë më së shumti dy mëditje mesatarisht brenda 1 muaji.

III

Anëtarëve të Këshillit të cilët janë me banim jashtë qytetit të Gjilanit iu takon edhe kompensimi i shpenzimeve të udhëtimit sipas çmimeve në transportin publik.

IV

Shuma e kompensimit do të paguhet në formë të mëditjes nga mjetet buxhetore të KK-Gjilan.

V

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Shërbimi i Kuvendit të Komunës së Gjilanit

VI

Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, pushon të vlejë vendimi për caktimin e shumës së kompensimit të anëtarëve të Këshillit të Ekspertëve për Planifikim Zhvillimor të Komunës së Gjilanit, nr. 01.3741/0101 i datës 16.04.2008.

VI

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Gjilanit.

KUVENDI I KOMUNËS – GJILAN

01.Nr. 6546
Gjilan, më 04.07.2008


Kryetari i komunës,

/Qemajl MUSTAFA/



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, www.gjilani-komuna.org; e-mail: zip_gjilan@hotmail.com, tel. 0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 486

Duke u bazuar në nenin 29 të Ligjit mbi eksproprijimin, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më datë 19.09.2008, miratoi këtë:

V E N D I M
PËR VAZHDIMIN E AFATIT TË PUNËS KOMISIONIT PËR BLERJEN E PRONAVE
PËR INTERES PUBLIK

I

Me këtë vendim i vazhdohet afati i punës Komisionit të formuar sipas vendimit të KK-së Nr. 1093/0101 të datës 12.02.2008,

II

Detyra e Komisionit do të jetë që të negociojë me pronarët e mundshëm për blerjen e pronave për interes publik.

Komisioni do të ketë këtë përbërje:

1. Ibrahim Salihu - PDK,
2. Behar Mehmeti - AKR,
3. Burhan Selmani – AAK,
4. Ramadan Ajvazi - LDK,
5. Isah Bunjaku - LDD,

III

Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Urbanizmit, Kadastër dhe Mbrojtje të Ambientit të KK-Gjilan.

IV

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS-GJILAN

01.Nr. 9988
Gjilan, më 19.09.2008


Kryetari i Komunës,

/Qemajl MUSTAFA/



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, www.gjilani-komuna.org; e-mail: zip_gjilan@hotmail.com, tel. 0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 486

Në bazë të nenit 38.1 pika (h) të Statutit të Komunës së Gjiçanit, nenit 21. al.1.pika 1.dhe 2. dhe 24. të Vendimit për vendosjen e objekteve të përkohshme në territorin e komunës së Gjiçanit, nr. 01-1894/020 prej 11. Prill/2001, Kuvendi i Komunës së Gjiçanit, në seancën e vetë të mbajtur më 19.09.2008, miraton këtë:

V E N D I M

Për Largimin e Kiosqeve dhe Objekteve tjera të përkohshme nga hapësirat publike në territorin e komunës së Gjiçanit

I.

Miratohet vendimi për largimin e Kiosqeve dhe Objekteve tjera të karakterit të përkohshëm të vendosura në hapësirat publike në territorin e Komunës së Gjiçanit.

II.

Të gjitha Kiosqet-Objektet e karakterit të përkohshëm të vendosura deri në miratimin e këtij vendimi duhet të largohen nga hapësirat publike, në afat prej 30 ditësh nga dita e miratimit të këtij Vendimi.

Përfundimisht nga zbatimi i paragrafit 1. të kësaj pike, bëjnë objektet në lokacionin nr. 2. të nenit 2. të Vendimit të KK-ës Gjiçan, nr. 01-2423/0202 prej dt. 25.05/2001, dhe objektet në lokacionin e caktuar me Vendimin e KK-ës Gjiçan, 01.nr.6170 prej dt. 24.06/2008.

III.

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës, përmes: Drejtorisë për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Emergjencë civile dhe Drejtorisë për Inspektion.

VI.

Ky Vendim hynë në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS SË GJILANIT


Nr. 01. 9983
Gjiçan, më 19.09.2008

K R Y E T A R I,
Qemajl MUSTAFA



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, [ëëë.gjilani-komuna.org](http://ee.gjilani-komuna.org); e-mail: zip_gjilan@hotmail.com, tel. 0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 486

Në bazë të nenit 38.1 pika (h) të Statutit të Komunës së Gjiçanit, nenit 2. al.1, nenet 3. 4. 6. të Vendimit për vendosjen e objekteve të përkohshme në territorin e komunës së Gjiçanit, nr. 01-1894/020 prej 11. Prill/2001, Kuvendi i Komunës së Gjiçanit, në seancën e vetë të mbajtur më 19.09.2008, miraton këtë:

V E N D I M

Për caktimin e lokacioneve për vendosjen e Kiosqeve dhe Objekteve tjera të përkohshme nga të gjitha hapësirat publike në Territorin e Komunës së Gjiçanit

I.

Miratohet vendimi për caktimin e lokacioneve për vendosjen e Kiosqeve dhe Objekteve tjera të karakterit të përkohshëm të vendosura në të gjitha hapësirat publike në territorin e komunës së Gjiçanit.

II.

Lokacionet dhe radhitja dhe madhësia e kiosqeve-Objekteve nga pika I. e këtij Vendimi do të caktohen në tërësi sipas organizimit të shfrytëzimit të hapësirës publike, të propozuar nga Komisionit për identifikimin e lokacioneve, nr. 07-439, dt. 08.09/2008, të lëshuar nga Drejtoria për Urbanizëm, Rindërtim dhe Ambient e Komunës së Gjiçanit..

III.

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset: kryetari i Komunës, përmes Drejtorisë për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Emergjencë Civile dhe Drejtorisë për Inspektion.

VI.

Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi , shfuqizohen të gjitha Vendimet e përcaktimit të lokacioneve për vendosjen e objekteve të karakterit të përkohshëm, me pikën II. të këtij Vendimi.

VII.

Ky Vendim hynë në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS SË GJILANIT


Nr. 01. 9984
Gjiçan, më 19.09.2008

K R Y E T A R I,
Qemajl MUSTAFA



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, [ëëë.gjilani-komuna.org](http://ee.gjilani-komuna.org); e-mail: zip_gjilan@hotmail.com, tel. 0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 486

Në bazë të nenit 2. pika 9 dhe nenit 14 të Ligjit për Eksproprijim ("g.z. e Kosovës" nr. 21/78, dhe 46/86), të pikës IV- të Vendimit të KK-ës për shpalljen e interesit të përgjithshëm, për rregullimin e shtratit të Lumit "Mirusha", nr.01-4726/0101 të dt. 30.04/2007, pikës III. të Vendimit të KK-ës Gjilan, për ndarjen e zonave dhe caktimin e çmimit (kompensimit) për tokën ndërtimore të eksproprijuar për vitin 2008, nr. 01-1101/0101 të dt. 12.02/2008, duke u mbështetur në nenin 38.1.f. të Statutit të Komunës së Gjilanit, Kuvendi i Komunës së Gjilanit, në seancën e vetë të mbajtur më 19.09 2008, miraton këtë:

V E N D I M

për ndarjen e mjeteve për kompensimin e eksproprijimit të paluajtshmërive:

I.

Me këtë Vendim ndahen mjetet në shumë prej gjithsej: **113.000,00** Euro, për kompensimin e pronarëve të tokës-paluajtshmërive si vijon:

a. Për Rregullimin e shtratit të Lumit "Mirusha", Shumën prej: **100.000,00 Euro**, për eksproprijimin e pjesës së ngastrës kadastrale, nr. 1128, në sipërfaqe prej: **S=1960.0m²** dhe pjesës së ngastrës kadastrale nr. 1129, në sipërfaqe prej: **S= 211.0m²**, (Gjithsej **S=2171,0m²**), vendi i quajtur: "Livadhet e Arapit-Bregu i Sahitit", Zona Kadastrale: Gjilan, të evidentuara në fletë posedimin nr. 1095, në emër të Januz Ahmetit nga fshati Malishevë.

b. Për ndërtimin e gropës septike të rrjetit të kanalizimit të fshatit Koretishtë, shumën prej: **13.000,00** Euro, për eksproprijimin e pjesës së ngastrës kadastrale nr. 516/4, në sipërfaqe prej gjithsej: **S=200.0m²**, vendi i quajtur: "Petigovc", Zona Kadastrale: Gjilan, e evidentuar në Fletë posedimin nr. 6146, në emër të Sahrat /Abdylhamit / Osmanit nga Gjilani.

II.

Mjete nga pika I. e këtij vendimi të ndahen nga të hyrat buxhetore të Komunës së Gjilanit për vitin 2008, dhe të njëjtat të deponohen në llogari të veçantë bankare.

III.

Obligohet Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Buxhet e KK-ës Gjilan, që të bëjë ndarjen, deponimin dhe lëshimin e vërtetimit për sigurimin e mjeteve nga pika I. e këtij Vendimi.

IV.

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës, Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Financa, si dhe Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit e Komunës së Gjilanit.

VI.


Ky Vendim hynë në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS SË GJILANIT

01.Nr. 9977
Gjilan, më 19.09.2008

Kryetari I komunës,

/Qemajl Mustafa/



Në bazë të nenit 14 të Ligjit për Planifikimin Hapësinor, nr. 2003/14, nenit 1. dhe 2. të Udhëzimit Administrativ për zbatimin e Ligjit për planifikimin hapësinor mbi elementet e themelore të Planit Zhvillimor Urban, nr. Rend. 34, prej 26.12/2003, nenit 27 të Ligjit për Tokën ndërtimore ("Fl. Zyrtare e Kosovës" nr. 14/80 dhe 42/86) nenit 12.2.d., dhe 17.1.b., të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 28/2008), nenit 12. pika a. dhe b. të Statutit të Komunës së Gjilanit, e në vështrim të Vendimit për qasjen e hartimit të Planit Zhvillimor Urban të Qytetit të Gjilanit, nr. 01-10521/020 të dt. 21.12/2004, Kuvendi i Komunës së Gjilanit, në seancën e vetë të mbajtur më: 30 Tetor/ 2008, miraton këtë:

V E N D I M

Për miratimin e Planit Zhvillimor Urban të Qytetit të Gjilanit

I.

Miratohet Plani Zhvillimor i Urban i Qytetit të Gjilanit, (në tekstin e mëtejshëm: PZHU i Qytetit të Gjilanit), i cili përcakton synimet afatmesme për zhvillimin dhe menaxhimin e zonës urbane të qytetit të Gjilanit për periudhën: 2008-2013 dhe përfshinë tërë hapësirën e territorit administrative të qytetit të Gjilanit si dhe pjesëve zonave të fshatrave dhe vendbanimeve që përkufizohen me Qytetin e Gjilanit, në sipërfaqe prej gjithsej: 1.701.72.24 ha.

II.

PZHU i Qytetit të Gjilanit, është hartuar nga Kompania e licencuar: "Instituti për Shkencë dhe Teknologji" (INTECH) nga Prishtina.

III.

Dokumenti i PZHU i Qytetit të Gjilanit, nga pika II. e këtij Vendimi, është hartuar në gjithsej shatë ekzemplar dhe atë: një ekzemplar në tri gjuhë zyrtare (Shqip, Anglisht, Serbisht), ndërsa gjashtë ekzemplar të njëjtë në gjuhën shqipe, i cili përmban pjesën tekstuale dhe pjesën grafike, të përmbledhur në edhe në formë Digjitale, i cili vërtetohet me Vulën e Kuvendit të Komunës së Gjilanit dhe nënshkrimin e Kryetarit të Komunës së Gjilanit

A. Pjesa tekstuale përmban:

1. Profilin e Zhvillimit Hapësinor dhe Analizën e Gjendjes;
2. Vizionin, parimet dhe caqet;
3. Kornizën e Zhvillimit Hapësinor;
4. Strategjitë dhe veprimet për zbatim si dhe
5. Dispozitat për zbatim.

B. Pjesa grafike përmban: të dhënat hartografike dhe shtojcat tjera grafike në të cilat paraqiten gjendja dhe ndërhyrjet në hapësirë në këto fusha:

- 1.1. Demografia dhe çështjet Sociale;
- 1.2. Zhvillimi Ekonomik;

- 1.3. Mjedisi dhe Shfrytëzimi i Tokës si dhe
- 1.4. Infrastruktura;
2. Zhvillimi i Sub qendrave për rreth pjesës urbane.

IV.

Plani nga pika I. e këtij Vendimi përbën dokumentin themelor për realizimin e programit të rregullimit të hapësirës së Qytetit të Gjilanit dhe pjesëve periferike, përcakton rrjetin dhe ndërlidhjet e objekteve të infrastrukturës komunale interne dhe eksterne dhe është bazë për hartimin e Planeve Rregulluese Urbane.

V.

Për zbatimin e këtij Plani do të kujdeset Kryetari i Komunës së Gjilanit, përmes Drejtorisë për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrotjtje të Mjedisit e Komunës së Gjilanit.

VI.

Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi, shfuqizohen të gjitha dispozitat e Planit të Përgjithshëm Urbanistik të Qytetit të Gjilanit, ("Gazeta Zyrtare e Kosovës", nr. 21/81.) dhe vendimeve të nxjerra në bazë të atij vendimi e që janë në kundërshtim me këtë vendim.

VII.

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Gjilanit.

KUVENDI I KOMUNËS SË GJILANIT


Nr. 01. 11735
Gjilan, më 30.10.2008

K R Y E S U E S I,

/Bujar Nevzati/



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN



Adresa: rr."Adem Jashari", pn, yvvvgjilani-komuna.org; zip gjilan@hotmail.com, tel.028/20 781, 20 782, 21 482.

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Planifikim Hapësinor, nr. 2003/14, nenit 1. dhe 2. të Udhëzimit Administrativ për zbatimin e Ligjit për Planifikim Hapësinor mbi elementet themelore të Planit Zhvillimor të Komunës, nr. Rend. 33, prej 16.12/2003, nenit 27 të Ligjit për Tokën ndërtimore ("Fl.Zyrtare e Kosovës" nr. 14/80 dhe 42/86) nenit 6., 12.2.d., dhe 17.1.a., të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 28/2008), nenit 12. pika a. dhe b. të Statutit të Komunës së Gjiçanit, e në vështrim të Vendimit për qasjen e hartimit të Planit Zhvillimor Komunal të Komunës së Gjiçanit, nr. 01-10520/020 të dt. 21.12/2004, Kuvendi i Komunës së Gjiçanit, në seancën e vetë të mbajtur më 30 Tetor/ 2008, miraton këtë:

V E N D I M

Për miratimin e Planit Zhvillimor Komunal: *GJILANI-2015+*

I.

Miratohet Plani Zhvillimor i Komunal:*Gjiçani 2015+*, (në tekstin e mëtejshëm: PZHK:*Gjiçani 2015+*), i cili përcakton synimet afatgjate për zhvillimin dhe menaxhimin e zonave Rurale të Komunës së Gjiçanit dhe zonës Urbane të Qytetit të Gjiçanit për periudhën: 2008-2015+ dhe përfshinë tërë hapësirën e territorit brenda kufijve administrativ të Komunës së Gjiçanit, në sipërfaqe prej gjithsej: 51.496.72.77 ha.

II.

PZHK:*Gjiçani- 2015+*, është hartuar nga Kompania e licencuar: "Instituti për Shkencë dhe Teknologji" (INTECH) nga Prishtina.

III.

Dokumenti i PZHK:*Gjiçani 2015+*, nga pika II. e këtij Vendimi, është hartuar gjithsej 7 ekzemplar dhe atë: një ekzemplar, në tri gjuhë zyrtare (Shqip, Anglisht, Serbisht), dhe gjashtë ekzemplar të njëjtë në gjuhën shqipe, i cili përmban pjesën tekstuale dhe pjesën grafike, të përmbledhur në edhe në formë Digjitale dhe vërtetohet me Vulën e Kuvendit të Komunës së Gjiçanit dhe nënshkrimin e Kryetarit të Komunës së Gjiçanit

A. Pjesa tekstuale përmban:

6. Profilin e Zhvillimit Hapësinor dhe Analizën e Gjendjes;
7. Vizionin, parimet dhe caqet;
8. Kornizën e Zhvillimit Hapësinor;
9. Strategjitë dhe Veprimet për zbatim si dhe
10. Dispozitat për zbatim.

B. Pjesa grafike përmban: të dhënat hartografike dhe shtojcat tjera grafike, në të cilat paraqiten: gjendja dhe ndërhyrjet në hapësirë në këto fusha:

- 1.1. Demografia dhe Çështjet Sociale;
- 1.2. Zhvillimi Ekonomik;

- 1.3. Mjedisi dhe Shfrytëzimi i Tokës si dhe
- 1.4. Infrastruktura;
2. Zhvillimi i Sub qendrave për rreth pjesës urbane
3. Zhvillimi i Sub qendrave për rreth 6 nën qendrave sekondare
4. Zhvillimi i gjashtë nën qendrave Sekondare dhe
5. Zhvillimi i 22 vendbanimeve rurale

IV.

Plani nga pika I. e këtij Vendimi përbën dokumentin themelor për realizimin e programit të rregullimit të hapësirës së këtij lokacioni, përcakton rrjetin dhe ndërlidhjet e objekteve të infrastrukturës komunale interne dhe eksterne.

V.

Për zbatimin e këtij Plani do të kujdeset Kryetari i Komunës së Gjilanit, përmes Drejtorisë për Urbanizëm Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit e Komunës së Gjilanit.

VI.

Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi, shfuqizohen të gjitha dispozitat e vendimeve që janë në kundërshtim me këtë vendim, përveç rasteve kur Ligji në mënyrë specifike e njeh autoritetin e Ligjit tjetër.

VI.

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Gjilanit.

KUVENDI I KOMUNËS SË GJILANIT

Nr. 01. 11736
Gjilan, më 30.10.2008.

K R Y E S U E S I,

/Bujar NEVZATI/



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN



Adresa: rr."Adem Jashari", pn, yvvgjilani-komuna.org:zip_gjilan@hotmail.com, tel.028/20 781, 20 782, 21 482.

Në bazë të nenit 15 të Ligjit për Planifikim Hapësinor, nr. 2003/14, nenit 1. dhe 2. të Udhëzimit Administrativ për zbatimin e Ligjit për Planifikim Hapësinor mbi elementet themelore të Planit Rregullues Urban, nr. Rend. 41, prej 04.mars/2005, nenit 12. pika a. dhe b. të Statutit të Komunës së Gjilanit, Kuvendi i Komunës së Gjilanit, në seancën e vetë të mbajtur më 30 Tetor/ 2008, miraton këtë:

V E N D I M

Për miratimin e Prioriteteve për hartimin-revidimin e Planeve Rregulluese Urbane

I.

Me këtë Vendim, miratohet Prioriteti i hartimit-revidimit të Planeve Rregulluese Urbane, (në tekstin e mëtejme: Plani i Prioriteteve të PRrU), i cili përcakton renditjen dhe dinamikën e fillimit të hartimit-revidimit të Planeve Rregulluese Urbane të zonave të caktuara me Vendimet mbi qasjen e hartimit të këtyre planeve, për periudhën e ardhshme deri në kompletimin e tërësishëm të miratimit të këtyre planeve brenda kufijve të përcaktuar me Planin Zhvillimor Urban të Qytetit të Gjilanit.

II.

Plani i Prioriteteve, është hartuar nga Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit e Komunës së Gjilanit, në bashkëpunim me Komitetin për Planifikim Urban, Resurse Natyrore, Pronë dhe Banim dhe Komitetin për Politikë dhe Financa të KK-ës Gjilan, në tërësi sipas përshkrimit në formë tekstuale dhe paraqitjes-përkufizimit grafik-e në Ortofoto të Qytetit të Gjilanit, të cilat janë pjesë përbërëse e këtij vendimi.

III.

Për zbatimin e këtij Plani do të kujdeset Kryetari i Komunës së Gjilanit, përmes Drejtorisë për Urbanizëm Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit e Komunës së Gjilanit.

IV.

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Gjilanit.

KUVENDI I KOMUNËS SË GJILANIT

Nr. 01. 11741
Gjilan, më 30.10.2008


K R Y E S U S I,

/Bujar NEVZATI/



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, [ëëë.gjilani-komuna.org](http://eeë.gjilani-komuna.org); e-mail: zip_gjilan@hotmail.com, tel. 0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 486

Në bazë të nenit 17.1, 20 dhe 24.1 të Ligjit për Planifikim Hapësinor nr.2003/14, nenit 38.1 pika c) të Statutit të Komunës së Gjilanit, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 21.11.2008, miraton këtë:

V E N D I M

për ndërrimin e destinimit të parcelave kadastrale

I

Me këtë vendim bëhet ndërrimi i destinimit ekzistues të paraparë me Planin Detaj Urbanistik për parcelat kadastrale dhe atë:

- a. Parcela kadastrale **nr.2054/5**, vendi i quajtur: "Dheu u Bardhë", në sipërfaqe prej: 441.0 m², e evidentuar në Certifikatën nr.1731, në emër të Këshillit të Bashkësisë Islame-Gjilan, e përfshirë me Planin Detaj Urbanistik të Lagjes "Dheu i Bardhë", me destinim: "**për ndërtimin e objekteve individuale**" në destinim: "**për ndërtim të objektit fetar-Xhamisë**" dhe
- b. Parcela kadastrale **nr.904/11**, vendi i quajtur: "Popovicë", në sipërfaqe prej: 397.0 m², e evidentuar në Certifikatën nr.1731, në emër të Bashkësisë Islame-Gjilan, e përfshirë me Planin Detaj Urbanistik të Lagjes "Zona Perëndimore-Qarku", me destinim: "**për ndërtimin e objekteve individuale**" në destinim: "**për ndërtim të objektit fetar-Xhamisë**"

II

Obligohet Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit e Komunës së Gjilanit që ndryshimin e destinimit nga pika I/a. dhe I/b. të këtij vendimi, ta inkorporojë në PDU: "Dheu i Bardhë", përkatësisht PDU: "Zona Perëndimore-Qarku", në tërësi sipas paraqitjes grafike në kopje të planit.

III

Nga dita e hyrjes në fuqi e këtij vendimi, pushojnë të vlejné destinimet e gjertanishme për ngastrat kadastrale-pjesët e PDU-ve përkatëse të përfshira me këtë vendim.

IV

Zbatimin e këtij vendimi e bënë Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, ndërsa për zbatimin e tij kujdeset Kryetari i Komunës së Gjilanit.

V

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Gjilanit.

KUVENDI I KOMUNËS-GJILAN

01.Nr. 12486
Gjilan, më 21.11.2008


Kryesuesi i kuvendit,

/Bujar NEVZATI/



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, [ëëë.gjilani-komuna.org](http://www.gjilani-komuna.org); e-mail: zip_gjilan@hotmail.com, tel. 0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 486

Duke u bazuar në nenin 38.1 pika c) të Statutit të Komunës së Gjiçanit, Kuvendi i Komunës së Gjiçanit në seancën e mbajtur më 21.11.2008, miratoi këtë:

V E N D I M

PËR PËRKRAHJEN E PROPOZIMIT PËR NGRITJEN E “SAHAT KULLËS”

I

Me këtë vendim përkrahet propozimi i zgjidhjes urbanistike të vendosjes së objektit të “Sahat Kullës” në ngastrën kadastrale nr.3781-1, pronë e NTSH “28 Nëntori” në Gjiçan.

II

Po ashtu me këtë vendim autorizohet Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, që të hulumtoj edhe ndonjë lokacion alternativ për vendosjen e objektit të “Sahat Kullës” në Gjiçan.

III

Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, ndërsa për zbatimin e tij kujdeset Kryetari i Komunës së Gjiçanit.

IV

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Gjiçanit.

KUVENDI I KOMUNËS-GJILAN

01.Nr. 12484
Gjiçan, më 21.11.2008


Kryesuesi i kuvendit,

/Bujar NEVZATI/



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, www.gjilani-komuna.org; e-mail: zip_gjilan@hotmail.com, tel. 0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 486

Duke u bazuar në nenin II të vendimit për caktimin e lokacionit për vendosjen e kiosqeve dhe objekteve tjera të përkohshme nga të gjitha hapësirat publike në territorin e Komunës së Gjilanit, si dhe bazuar në Rekomandimin e Komitetit për Politikë dhe Financa të datës 06.11.2008, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 21.11.2008, miratoi këtë:

V E N D I M

Për miratimin e Kontratës për vendosjen e kiosqeve

I

Me këtë vendim miratohet Kontrata për vendosjen e Kiosqeve e bazuar në partneritetin private-publik, në mes të Komunës së Gjilanit dhe SHPK "ELITE" nga Gjakova.

II

Pjesë përbërëse e këtij Vendimi, është Propozim-Kontrata në mesë të Komunës së Gjilanit dhe SHPK "ELITE" nga Gjakova, në të cilën janë precizuar obligimet dhe të drejtat e Komunës së Gjilanit dhe Investitorit.

III

Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Ambientit, ndërsa për zbatimin e tij kujdeset Kryetari i Komunës së Gjilanit.

IV

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Gjilanit

KUVENDI I KOMUNËS-GJILAN

01.Nr. 12481
Gjilan, më 21.11.2008


Kryesuesi i kuvendit,

/Bujar NEVZATI/



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, [ëëë.gjilani-komuna.org](http://ee.gjilani-komuna.org); e-mail: zip_gjilan@hotmail.com, tel. 0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 486

Në bazë të nenit 9.1, nenit 38.1 pika c) dhe h) të Statutit të Komunës së Gjiçanit, si dhe bazuar në kërkesën e Drejtorisë për Arsim, Kuvendi i Komunës së Gjiçanit në seancën e mbajtur më 24.12.2008, miratoi këtë:

V E N D I M

Për shpalljen Zonë me Interes të përgjithshëm të ngastrës kadastrale nr.02142-0

I

Me këtë vendim, shpallet Zonë me Interes të përgjithshëm, ngastra kadastrale nr.02142-0, Fleta Poseduese nr.1750, vendi i quajtur: "Rasadnik", Zona kadastrale: Gjiçan, PSH. Kuvendi i Komunës së Gjiçanit, me sipërfaqe prej 00.60.16 ha.

II

Ngastra kadastrale e shpallur me Interes të përgjithshëm si në pikën I. të këtij vendimi do të shfrytëzohet për ndërtimin e një shkolle për nevoja të Arsimit

III

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës së Gjiçanit, Drejtoria për Arsim, Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë e KK-Gjiçan.

VI

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS-GJILAN

01.Nr. 13528 _____
Gjiçan, më 24.12.2008


Kryesuesi i kuvendit,

/Bujar NEVZATI/



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, [ëëë.gjilani-komuna.org](http://ee.gjilani-komuna.org); e-mail: zip_gjilan@hotmail.com, tel. 0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 486

Në bazë të nenit 17 pika b. dhe c. të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28/2008, e në vështrim të nenit 38.1 pika (b) dhe (c) të Statutit të Komunës së Gjilanit, si dhe bazuar në Rekomandimin e Komitetit për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 24.12.2008, miratoi këtë:

V E N D I M

Për aprovimin e kërkesës së Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë

I

Me këtë vendim, aprovohet kërkesa e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë së Qeverisë së Republikës së Kosovës për ndarjen e lokacionit në sipërfaqe prej 1m2, për vendosjen e pajisjes "Qoshqet Informative" në projektin "Navigatori i Qytetit".

II

Projekti "Navigatori i Qytetit" mundëson prezantimin e atraksioneve turistike të Kosovës në formë digjitale dhe financohet nga BKK-ja.

III

Autorizohet Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit si dhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë e KK-Gjilan, që të caktojnë lokacionin e përshtatshëm për projektin e Departamentit të Turizmit pran Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë.

IV

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës së Gjilanit, Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë e KK-Gjilan.

VI

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS-GJILAN


01.Nr. 13527
Gjilan, më 24.12.2008

Kryesuesi i kuvendit,
/Bujar NEVZATI/



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, www.gjilani-komuna.org; e-mail: zip_gjilan@hotmail.com, tel. 0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 486

Duke u bazuar në nenin 38.1 pika c) dhe l) të Statutit të Komunës së Gjilanit, si dhe bazuar në Rekomandimin e Komitetit për Politikë e Financa të datës 21.01.2009, pas diskutimeve lidhur me interesin e komunës në ndërtimet për banim kolektiv në lagjen "Iliria" – lokacioni pranë "Grafikos"-it, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 29.01.2009, miratoi këtë::

V e n d i m

1. Që interesi minimal i komunës në sipërfaqen efektive të shfrytëzueshme (neto sipërfaqen) në këto ndërtesa të jetë 25%.
2. Që njëri nga kushtet në shpalljen e konkursit publik (tenderit) për investitorët në këtë zonë të jetë maksimumi i interesit të komunës në sipërfaqen e shfrytëzueshme për ofertat e përgjegjshme (maksimumi mbi 25%).
3. Që sipërfaqja që i takon komunës të jetë kualitative (të merret parasysh funksionaliteti i saj dhe katet në të cilat ajo mund të merret).
4. Që familjet që e gëzojnë të drejtën për banim në këtë zonë të akomodohen në sipërfaqen që i takon komunës.
5. Relacionet në mes të familjeve që aktualisht banojnë në këtë hapësirë (11 familje) dhe komunës precizohen me kontratë të veçantë e cila i parasheh të gjitha kushtet dhe interesin e palëve dhe e cila do të votohet nga kuvendi (hapësira që u takon në ndërtesën e re, kushtet e dislokimit derisa të ndërtohen objektet, kohëzgjatja e ndërtimit etj).
6. Relacionet në mes të investitorit në këtë hapësirë dhe komunës precizohen gjithashtu me kontratë të veçantë e cila gjithashtu do të votohet nga kuvendi.
7. Ky vendim i paraprin procesit të negocijimit dhe të parashtrimit të kushteve për investitorët e ardhshëm në këtë zonë.
8. Për realizimin e këtij vendimi përkujdeset kryetari i komunës dhe Drejtorati për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit.
9. Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Gjilanit.

KUVENDI I KOMUNËS-GJILAN

01.Nr. 1029
Gjilan, më 29.01.2009


Kryesuesi i kuvendit,

/Bujar NEVZATI/



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: r. "Adem Jashari" pn, www.gjilani-komuna.org; e-mail: zip_gjilan@hotmail.com, tel. 0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 486

Në mbështetje të nenit 21 alinea 3,4 dhe 6, të Ligjit Mbi Eksproprijimin Gaz. Zyrt. e Kosovës 21/78, si dhe bazuar në rekomandimin e Komitetit për Politikë dhe financa të datës 21.01.2008, Kuvendi I Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 29.01.2009 miraton këtë:

V E N D I M
PËR ANULIMIN E AKTVENDIMEVE DHE DEEKSPROPRIIMIN E PALUAJTSHMËRIVE TË
LAGJËS "Q.QESHME " I. NË GJILAN

- I. ANULOHEN AKTVENDIMET DHE DEEKSPROPRIOHËN paluajtshmëritë e marra nga posedimi prej pronarëve të mëparshëm në vendin e quajtur lagja " Q. Qeshme " I. në Gjilan.
- II. Sipërfaqet tokësore të cilat janë të parapara për rrugë publike nuk do të përfshihen me këtë vendim .
- III. Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit , duke vendosur në çështjen juridike të anulimit aktvendimeve dhe deekspropriimit të pronave të ekspropriuara përkatësisht marrjen e të drejtës së shfrytëzimit të tokës ndërtimore të pa ndërtuar në lagjen "Q. Qeshme " I. në Gjilan, paraqet në vijim arsyeshmerinë
publike duke marrë parasysh kërkesat e ish pronarëve të mëparshëm të tokave të pa ndërtuara të kësaj lagje si dhe gjendjen faktike dhe reale në teren e cila nuk korrespondon me aktvendimet e marra më herët për eksproprijim për rregullimin e planit të atëhershëm detaj urbanistik në atë lagje të cilat janë të plotfuqishme që nga viti 1988, andaj pasi që nuk është realizuar qëllimi i eksproprijimit respektivisht marrjes së të drejtës së shfrytëzimit të tokës së pa ndërtuar ndërtimore të qytetit -lagjes " Q. Qeshme "I, në Gjilan , Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit, propozon të bëjë anulimin dhe deekspropriimin e aktvendimeve mbi eksproprijimin konform dispozitave pozitive juridike në fuqi përkatësisht nenit 21 al. 3. të Ligjit Mbi Eksproprijimin / Gaz. Zyrt. e Kosovës / 21/78 . sipas të cilit thuhet : Nëse shfrytëzuesi i eksproprijimit dhe pronari i përparshëm atë e kërkojnë së bashku, anulohet aktvendimi në formë të prerë mbi eksproprijimin . Qëndron fakti se shfrytëzuesi i eksproprijimit nuk e ka realizuar qëllimin e eksproprijimit siç është paraparë për realizimin e planit detaj urbanistik në atë pjesë të lagjes " Q . Qeshme "I, në Gjilan .
- IV. Nëse në çfarëdo kohe sigurohen dëshmi se pronarët kanë marrë kompensim, komuna do të fillojë procedurën e kthimit të pronës së deekspropriuar sipas këtij vendimi me të gjitha investimet që do të bëhen në atë prone, nga pronarët.
- V. Për realizimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi, Pronë dhe Banim.

KUVENDI I KOMUNËS-GJILAN

01.Nr. 1030
Gjilan, më 29.01.2009


Kryesuesi i kuvendit,

/ Bujar NEVZATI/



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, www.gjilani-komuna.org; e-mail: zip_gjilan@hotmail.com, tel. 0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 486

Në bazë të nenit 17.1, 20 dhe 24.1 dhe 2. të Ligjit për Planifikim Hapësinor, nr. 2003/14, nenit 38.1. pika b. dhe c. e Statutit të Komunës së Gjilanit, Kuvendi i Komunës së Gjilanit, në seancën e mbajtur më 12.03.2009, miraton këtë:

V E N D I M

Për Ndërrimin e destinimit të hapësirës të një pjese të PDU: "Dardania I" (te ish lokacioni i tregut)

I.

Me këtë vendim bëhet revidimi (plotësimi dhe ndryshimi) i një pjese të Planit Detaj Urbanistik: "Dardania I", në Gjilan, të hapësirës që përfshinë ngastrat kadastrale nr 470/10 në sipërfaqe prej 9132,65m² dhe ngastrën kadastrale nr. 477/1 në sipërfaqe prej 9093,65m².

II.

Revidimi nga pika I. e këtij vendimi, nënkupton: ndërrimin e destinimit në kuptim të organizimit dhe shfrytëzimit të hapësirës, me përmbajtje të objekteve të karakterit publik: terrene sportive, Çerdhe Fëmijësh, lojëra fëmijësh, hapësirë gjelbëruese, parkingje, trotuare, rrugë-ale, me përmbajtje përcjellëse, në tërësi sipas paraqitjes grafike, e cila është pjesë përbërëse e këtij vendimi..

III.

Obligohet Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit e Komunës së Gjilanit të revidimin sipas pikës I. dhe II. të këtij vendimi ta inkorporoj në Planin Detaj Urbanistik: "Dardania I" në Gjilan.

IV.

Nga dita e hyrjes në fuqi e këtij vendimi, pushon të vlejë pjesa e Planit Detaj Urbanistik i përfshirë me pikën I. të këtij vendimi, përkatësisht Vendimi i KK-ës Gjilan, nr. 01-350-51/81 i dt. 15.12/1981, ("Gaz. Zyrt. E Kosovës" nr. 8/1982) për ndryshimin dhe plotësimin e PDU: "Dardania I" dhe "Dardania II", ,

V.

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës së Gjilanit, Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit e KK-ës Gjilan, si dhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë e KK-ës Gjilan

VI.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS SË GJILANIT

01.Nr. 2688
Gjilan, më 12.03.2009


Kryesuesi i kuvendit,

/Bujar NEVZATI/



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa:rr."Adem Jashari" pn, gje.gjilani-komuna.org; e-mail:zip_gjilan@hotmail.com,tel.0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 486

Në bazë të nenit 17 pika c) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe nenit 38.1 pika c) të Statutit të Komunës së Gjilanit, Kuvendi i Komunës së Gjilani, në seancën e mbajtur më 30.03.2009, miraton këtë:

V E N D I M

Për dhënien e pëlqimit Kompanisë “Bejta Commerce” për rritjen e sipërfaqes në shfrytëzim në vendburimin e Gëlqeroreve në Parallovë

I.

Me këtë vendim Kompanisë “Bejta Commerce” **I EPET** pëlqimi për rritjen e sipërfaqeve për shfrytëzim në vendburimin e Gëlqeroreve në ZK- Parallovë, në sipërfaqe të përgjithshme prej 02.77.60ha, në pjesën e parcelave 1279 me sipërfaqe prej 01.58.16, vendi i quajtur: “Goline”, Pasuri Shoqërore-Ekonomia e Pyjeve-Gjilan dhe 1305 me sipërfaqe prej 01.19.44, vendi i quajtur: “Guri”, Pasuri Shoqërore-Ekonomia e Pyjeve-Gjilan.

II

Ky pëlqim epet me kusht që, Kompania “Bejta Commerc” në një afat kohorë prej 3-6 muaj, të bëjë instalimin e teknologjisë për zvogëlimin e emetimit të pluhurit.

III

Po ashtu me këtë vendim, Kompania “Bejta Commerc” obligohet që të bëjë mirëmbajtjen e rrugës në segmentin ku zhvillohen punimet.

IV

Obligohet Drejtoria e Inspektionit që të bëjë monitorimin e përmbushjes së kushteve për dhënien e këtij pëlqimi, Kompanisë “Bejta Comerc”

V.

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës së Gjilanit, Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit e KK-ës Gjilan, Drejtoria e Inspektionit, si dhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë e KK-ës Gjilan.

III.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS SË GJILANIT

01.Nr. 3372
Gjilan, më .26.03.2009


Kryesuesi i kuvendit,

/Bujar NEVZATI/



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, www.gjilani-komuna.org; e-mail: zip_gjilan@hotmail.com, tel. 0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 486

Duke u bazuar në nenin 38.1 pika c), të Statutit të Komunës së Gjilanit, si dhe bazuar në rekomandimin e Komitetit për Politikë dhe Financa të datës 21.04.2009, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 29.04.2009, miratoi këtë:

V E N D I M **PËR DHENJËN NË SHFRYTËZIM TË HAPËSIRËS PUBLIKE, SH.P.K. "VIVA FRESH" NË GJILAN**

I

Me këtë vendim, SH.P.K. "VIVA FRESH" nga Gjilani i epet në shfrytëzim të përkohshëm për pesë (5) vjet, hapësira publike: në ngastrën kadastrale nr.3295 me sipërfaqe 1500 m² nga sipërfaqja e gjithëmbarshme prej 6118m², Fleta poseduese nr.1750, vendi i quajtur: "sh.p" me kulturë: parcelë, Zona kadastrale: Gjilan, P.SH.-Kuvendi i komunës Gjilan.

II

Hapësirën publike si në pikën I të këtij vendimi, SH.P.K. "VIVA FRESH" do ta shfrytëzojë për rregullimin e auto parkingut dhe infrastrukturës përcjellëse për konsumatorët e vetë dhe për qytetarë, dhe ky auto parking do të rregullohet në harmoni të plotë me Drejtorin për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit të KK-Gjilan.

III

Mënyra dhe kushtet e shfrytëzimit të hapësirës publike si në pikën I të këtij vendimi, si dhe të drejtat dhe obligimet e njërës dhe palës tjetër do të rregullohen më Marrëveshje të veçantë në mesë të Kuvendit të Komunës së Gjilanit dhe SH.P.K. "VIVA FRESH" nga Gjilani, dhe Kuvendi i Komunës e ruan të drejtën e revokimit të këtij vendimi atëherë kur paraqitet nevoja për këtë lokacion.

IV

Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria e Kadastrit, Gjeodezisë, Pronës dhe Banimit, ndërsa për zbatimin e tij kujdeset Kryetari i Komunës së Gjilanit.

V

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Gjilanit.

KUVENDI I KOMUNËS-GJILAN

01.Nr. 4821
Gjilan, më 29.04.2009


Kryesuesi i kuvendit

/ Bujar NEVZATI/



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, [ëëë.gjilani-komuna.org](http://ee.gjilani-komuna.org); e-mail: zip_gjilan@hotmail.com, tel. 0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 486

Në bazë të nenit 17 pika b. dhe c. të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/2008, nenit 38.1.c. të Statutit të Komunës së Gjilanit, Kuvendi i Komunës së Gjilani, duke vendosur sipas kërkesës së: Zyrës Projekteve të KK_ës Gjilan, për sigurimin e lokacionit për ndërtimin e objekteve për persona me nevoja të veçanta, të dt. 13.03/2009, në seancën e mbajtur më datë: 29.04.2009, miraton këtë:

V E N D I M

Për dhënien në shfrytëzim të tokës-truallit për ndërtimin e objektit për persona me nevoja të veçanta

I.

Me këtë vendim, Shoqatës: "Handikos", Shoqatës së Shurdhmemecëve dhe Shoqatës së të Verbërve me seli në Gjilan, iu IPET në shfrytëzim të përhershëm, pjesa e Ngastrës Kadastrale nr. 2438-1 në sip. 1600m² dhe ng. kadastrale nr. 2438-4, në sip. 419m², vendi i quajtur: "Monopol", Zona Kadastrale: Gjilan, e cila evidentohet në Flet posedimin nr. 1750, në emër të Pasurisë Shoqërore e Komunës së Gjilanit si dhe pjesa e ngastrës kadastrale nr. 2437 nga rrethoja e Qendrës për Punë Sociale në Gjilan deri te kufijtë e ng. kad 2438, e evidentuar në FP-QP, nr. 5773, në emër të Qendrës për Punë Sociale në Gjilan.

II.

Ngastrat kadastrale të përshkruara në pikën I. të këtij Vendimi, duhet të shfrytëzohet ekskluzivisht për ndërtimin e: *Objektit për Persona me nevoja të veçanta të Komunës së Gjilanit*, në tërësi sipas kushteve tekniko-urbanistike të përcaktuara me Zgjidhjen urbanistike-teknike të hartuar nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit të Komunës së Gjilanit, përkatësisht Projektit të hartuar nga Donatori dhe projekti final duhet të kalojë në procedura të rregullta.

III.

Mbi zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës së Gjilanit, Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë e Komunës së Gjilanit.

IV.

Ky Vendim hynë në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS SË GJILANIT

01.Nr. 4818
Gjilan, më 29.04.2009


Kryesuesi I kuvendit,

/Bujar NEVZATI/



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, [ëëë.gjilani-komuna.org](http://www.gjilani-komuna.org); e-mail: zip_gjilan@hotmail.com, tel. 0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 486

Në bazë të nenit 17.1, 20 dhe 24.1 dhe 2. të Ligjit për Planifikim Hapësinor, nr. 2003/14, nenit 38.1. pika b. dhe c. e Statutit të Komunës së Gjilanit, dhe nenit 6 të Vendimit për aprovimin e Planit Detaj Urbanistik: “Zona Perëndimore-Qarku” në Gjilan, nr. 01-8030/002 të dt. 16.04.2002, Kuvendi i Komunës së Gjilani, në seancën e mbajtur më datë: 29.04.2009, miraton këtë:

V E N D I M

Për revidimin e një pjese të PDU: “Zona Perëndimor-Qarku”, në Gjilan (te Shkolla Fillore)

I.

Me këtë vendim bëhet revidimi (plotësimi dhe ndryshimi) i një pjese të Planit Detaj Urbanistik: “Zona Perëndimore-Qarku”, në Gjilan, afër lokacionit të Shkollës Fillore, në ndërtim e sipër, në ngastrën kadastrale nr. 1779/3, 1779/4, 1779/5. 1779/6, 1776/1, 1776/3 dhe ng. kad. nr.1775.

II.

Revidimi nga pika I. e këtij vendimi, nënkupton: plotësimin dhe ndryshimin formës, madhësisë, etazhitetit dhe renditjes-shtrirjes së objekteve si dhe ndryshimin e destinimit të objekteve dhe organizimit të hapësirave, në tërësi sipas paraqitjes grafike (Varianti i Planifikuar) e cila është pjesë përbërëse e këtij Vendimi.

III.

Obligohet Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit e Komunës së Gjilanit të revidimin sipas pikës I. dhe II. të këtij vendimi ta inkorporoj në Planin Detaj Urbanistik: “Zona Perëndimore –Qarku” në Gjilan.

IV.

Nga dita e hyrjes në fuqi e këtij vendimi, pushon të vlejë pjesa e Planit Detaj Urbanistik i përfshirë me pikën I. të këtij vendimi.

V.

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës së Gjilanit, Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit e KK-ës Gjilan, si dhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë e KK-ës Gjilan

VI.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS SË GJILANIT

01.Nr. 4819
Gjilan, më 29.04.2009


Kryesuesi i kuvendit,

/ Bujar NEVZATI/



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, www.gjilani-komuna.org; e-mail: zip_gjilan@hotmail.com, tel. 0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 486

Në bazë të nenit 9.1, nenit 38.1 pika c) të Statutit të Komunës së Gjiçanit, bazuar në Rekomandimin e Komitetit për Politikë dhe Financa të datës 22.05.2009, si dhe bazuar në përgjigjen e Agjencionit Kosovar të Privatizimit për ndërrim të pronës, Kuvendi i Komunës së Gjiçanit në seancën e mbajtur më 26.05.2009, miratoi këtë:

V E N D I M

Për shpalljen Zonë me Interes të përgjithshëm publik të ngastrat kadastrale nr.1961-1 dhe 4961-2

I

Me këtë vendim, shpallet Zonë me Interes të përgjithshëm publik, ngastra kadastrale nr.1961-1 dhe 4961-2, me sipërfaqe të përgjithshme prej 0.97.98 ha, Fleta Poseduese nr.1730, , në vendin e quajtur: "Fidanishte", me kulturë: parcelë, Zona kadastrale: Gjiçan, në emër të Ndërmarrjes Shoqërore "Agrokultura.

II

Ngastrat kadastrale të shpallura me Interes të publik si në pikën I. të këtij vendimi do të shfrytëzohen për ndërtimin e Shtëpisë së paqes dhe Objektivit të Qendrës Socio-Kulturore "Don Bosko" në Gjiçan.

III

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës së Gjiçanit, Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë e KK-Gjiçan.

VI


Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS-GJILAN

01.Nr. 5817
Gjiçan, më 26.05.2009

Kryesuesi i kuvendit,

/Bujar NEVZATI/



Në bazë të nenit 17 të Ligjit për Planifikim Hapësinor nr.2003/14, dispozitive të Udhëzimit Administrativ për planifikim hapësinor mbi elementet themelore të Planit Rregullues Urban, nr.41. të datës 04.03.2005, nenit 27 të Ligjit për Tokën Ndërtimore, (G.Z. e Kosovës nr.14/80 dhe 42/86), nenit 17. pika b. Të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr.03/L-040, (G.Z. e R.K. nr.28/2008), nenit 38.1 pika b. Të Statutit të Komunës së Gjilanit, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 14.07.2009, miraton këtë:

V E N D I M

për miratimin e propozim zgjidhjes të Planit Rregullues të lokacionit: “FSHATI I RI” Livoq i Ulët

I

Miratohet propozim zgjidhja e Planit rregullues i lokacionit “Livoqi i Ri”, i cili përfshin hapësirën në pjesën jug perëndimore të fshatit Livoq i Ulët (në tekstin e mëtejshëm: PZ e PRr-Livoqi i Ri), i cili përcakton synimet afatmesme për zhvillimin dhe rregullimin e hapësirës së përfshirë me këtë plan, në një sipërfaqe prej gjithsej: 97 hektarësh.

II

PZ e PRr, “Livoqi i Ri” është hartuar nga: N.Sh.”GEO-KOS” Prishtinë-F. Kosovë dhe NPT. Niti-c” Gjilan.

Elaborati nga pika paraprake këtij vendimi, është hartuar në 1 ekzemplar të shkruar dhe në 1 kopje digjitale, dhe i vejtë përbëhet nga pjesa tekstuale dhe pjesa grafike.

a. Pjesa tekstuale përmban:

- Arsyeshmërinë e miratimit të planit dhe përshkrimin teknik të planit;
- Kufijtë e zonës dhe planin e parcelimit, planin-paraqitjen grafike të hapësirës të parapara sipas destnimit dhe shtrirjes së objekteve të banimit individual dhe objekteve të infrastrukturës së karakterit të përgjithshëm publik dhe infrastrukturës teknike komunale,
- Destinimin e sipërfaqeve,
- Vijat rregullative të rrugëve dhe sipërfaqeve publike si dhe vijat ndërtimore,
- Pikat e lartësisë së rrugëve të infrastrukturës dhe kyqjeve në këto rrjete: rrugëve, furnizimit me ujë, ujërave të zeza, ujërave atmosferike, telekomunikacionit, elektrikes, etj si dhe qasjes përkatësisht kyqjet në infrastrukturë,
- Planin e parcelimit.

b. Pjesa grafike përmban;

- Ekstraktin nga Plani Zhvillimor Komunal dhe pozitën e hapësirës që trajtohet me këtë plan,
- Hartat-vizatimet në përpjesë 1:5000 dhe 1:2500, në të cilat janë të paraqitura lokacionet për shfrytëzim të tokës ekzistuese duke identifikuar hapësirat-objektet publike dhe shërbimet tjera publike, rrugët, banimin, gjelbërimin, shkollën, etj.

- Kufijtë e hapësirës që trajtohet,
- Destinimin e sipërfaqeve dhe mënyrën e shfrytëzimit të tokës, përkatësisht objektit, rregullat e ndërtimit dhe rregullimit, mënyrën e përfshirjes së gjendjes ekzistuese, ndarjen në tersi hapësinore dhe njësi në kuadër të planit,
- Planin e infrastrukturës rrugore me profilet karakteristike dhe elementet analitike-geodete për infrastrukturë të re rrugore,
- Planin nivelues, vijat ndërtimore, vijat rregullative,
- Planin e parcelimit,
- Planin e rrjetit dhe objekteve të infrastrukturës, sipërfaqeve të lira etj, shtesat tjera, varësisht nga nevoja e planit.

IV

Parashtruesi i kërkesës obligohet që në afat prej 6 muajsh nga dita e miratimit të këtij vendimi, Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit të Komunës së Gjilanit, të i dorëzoj Draft dokumentin e Planifikimit-Projektin kryesor në 5 ekzemplarë origjinal në formë të shkruar dhe kopje në formë digjitale të plotësuar edhe me këto përmbajtje:

a. Pjesa tekstuale:

- Normat dhe standardet teknike për zhvillimin dhe rregullimin e hapësirës,
- Kushtet dhe kriteret për mbrojtjen të mjedisit, shfrytëzimin racional të energjisë etj,
- Kushtet për sipërfaqet publike, private si dhe elementet përcjellëse,
- Kërkesat e veçanta për lëshimin e lejeve të ndërtimit, varësisht nga kushtet e vendit dhe llojit të objektit,
- Pozitën e objektit në parcelë dhe kuadër të parcelave fqinje dhe distancën në mes të objekteve,
- Lartësinë, formësimin arkitektonik dhe estetik të elementeve të caktuara të objekteve,

b. Pjesa grafike:

- Hartat-vizatimet në përpjesë 1:1000,

b. Paraqitja digjitale duhet të plotësohet me përmbajtje nga pika a. dhe b. Të këtij neni.

V.

Obligohet Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit të Komunës së Gjilanit që pas pranimit të draft-dokumentit i plotësuar nga hartuesi me përmbajtjet nga neni IV. Të këtij vendimi, në formë të shkruar të informojë Kuvendin e Komunës së Gjilanit për plotësimin-mosplotësimin e obligimeve të parashtruesit të kërkesës përkatësisht hartuesit të projekt-dokumentit.

VI.

Varësisht nga plotësimi i projekt-dokumentit me përmbajtjet e caktuara në pikën IV. të këtij vendimi, ku projekt-dokumenti do të vërtetohet me vulën e Kuvendit të Komunës së Gjilanit, dhe nënshkrimin e Kryesuesit të kuvendit të Komunës së Gjilanit dhe i vejtë hynë në fuqi ditën e nënshkrimit, përkatësisht vërtetimit.

Në rast të mosrespektimit të te njëjtit, ky vendim do të konsiderohet se nuk është miratuar dhe lihet jashtë fuqisë.

VII.

Projekt-dokumenti nga pika VI. e këtij vendimi do të përbëjë dokumentin themelor për realizimin e planit të parcelimit dhe programit të rregullimit të hapësirës së këtij kompleksi. Shpenzimet për hartimin e Planit Detal Urbanistik të Lokacionit “Fshati i Ri” në Livoq të Ulët i bartë Kuvendi i Komunës së Gjilanit.

VIII

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryesuesi i komunës, Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër, pronë dhe Banim të Komunës së Gjilanit.

IX

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS SË GJILANIT

01.Nr. 7832
Gjilan, më 14.07.2009


Kryesuesi i kuvendit,

/Bujar NEVZATI/



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, www.gjilani-komuna.org; e-mail: zip_gjilan@hotmail.com, tel. 0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 486

Në bazë të nenit 17.1, 20 dhe 24.1 dhe 2. të Ligjit për Planifikim Hapsinor, nr. 2003/14, nenit 17.pika b,c dhe e, të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, ("G.Z. R.Kosovës" nr. 28/2008), nenit 38.1. pika b. dhe c. e Statutit të Komunës së Gjilanit, Kuvendi i Komunës së Gjilani, në seancën e mbajtur më 11.09.2009, miraton këtë:

V E N D I M

Për Dhënien në shfrytëzim të truallit për ndërtimin e Xhamisë në lagjen "Dardania II" dhe Revidimin e një pjese të PDU: "Dardania II" në Gjilan

I.

a. Me këtë vendim Bashkësisë Islame të Kosovës- Gjilan, i epet në shfrytëzim pjesa e parcelës kadastrale nr. 454/15 dhe parcelës 454-16, . në sipërfaqe prej gjithsej: 800m², vendi i quajtur: "Dardania", ZK-Gjilan, e evidentuar si PSH. ish BVI për Banim dhe Veprimtari komunale e Komunës së Gjilanit, për ndërtimin e objektit të kultit fetar-Xhamisë.

b. dhe bëhet revidimi (plotësimi dhe ndryshimi) i një pjese të Planit Detaj Urbanistik: "Dardania II", në Gjilan, të hapësirës që përfshinë parcelat: nr. 454-15, në sip. 1060m²; parc. nr. 454-16, në sip.7895; parc. nr. 455-1 në sip. 550m² dhe parc. nr. 455-2 në sip. 1725m², (gjithsej sip. prej.1.230m²).

II.

Revidimi nga pika I. e këtij vendimi, nënkupton: ndërrimin e destinimit në kuptim të organizimit dhe shfrytëzimit të hapësirës, me përmbajtje të objekteve të karakterit publik: Objekt për shërbimin civil komunal, terrene sportive, këndi për lojëra fëmijësh, hapësirë gjelbëruese, parkingje, trotuare, rruge-ale, me përmbajtje përcjellëse, në tërësi sipas paraqitjes grafike të hartuar nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit të Komunës së Gjilanit, e cila është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

III.

Obligohet Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit e Komunës së Gjilanit që revidimin sipas pikës I. dhe II. të këtij vendimi ta inkorporoj në Planin Detaj Urbanistik: " Dardania II" në Gjilan.

IV.

Obligohet Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër, Pronë dhe Banim e KK-ës Gjilan që të bëjë ri parcelimin, matjen përcaktimin e kufijve dhe përlogaritjen e sipërfaqes së truallit në fjalë, në tërësi sipas paraqitjes grafike të hartuar nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit të Komunës së Gjilanit.

Nga dita e hyrjes në fuqi e këtij vendimi, pushon të vlejë pjesa e Planit Detaj Urbanistik i përfshirë me pikën I. të këtij vendimi, përkatësisht Vendimi i KK-ës Gjilan, nr. 01-350-51/81 i dt. 15.12/1981, (" Gaz. Zyrt. E Kosovës" nr. 8/1982) për ndryshimin dhe plotësimin e PDU: "Dardania I" dhe "Dardania II", dhe Vendimi nr.01.5707/0101 i datës 03.10.2006 për ndarjen e lokacionit për ndërtim të xhamisë në lagjen "Dardania II", në Gjilan.

V.

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës së Gjilanit, Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit e KK-ës Gjilan, si dhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë e KK-ës Gjilan

VI.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS SË GJILANIT

01.Nr. 10879
Gjilan, më 11.09.2009.


K r y e s u e s i,

/ Bujar Nevzati /



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, www.gjilani-komuna.org; e-mail: zip_gjilan@hotmail.com, tel. 0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 486

Duke u bazuar në nenin 38.1 shkronja c), nenin 52.4 të Statutit të Komunës së Gjilanit, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 29.09.2009, miratoi këtë:

V E N D I M

Për ndryshimin e lokacionit për vendosjen e "SAHAT KULLËS"

I

Me këtë vendim lejohet ndryshimi i lokacionit për vendosjen e "Sahat Kullës, nga ngastra kadastrale nr.3781, në lokacionin e Qendrës Zejtare, afër Stacionit të Autobusëve në Gjilan.

II

Po ashtu me këtë vendim obligohen sektorët e veçantë të Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër, Pronë dhe Banim dhe Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit që të ndërmarrin veprimet e nevojshme për krijimin e kushteve për vendosjen e objektit të "Sahat kullës".

III

Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi pushon të vlej vendimi 01.Nr.12484 i datës 21.11.2008 për përkrahjen e propozimit për ngritjen e "Sahat Kullës".

IV

Për zbatimin e këtij vendimi obligohen Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër, Pronë dhe Banim dhe Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit e KK-Gjilan, ndërsa për implementimin e tij do të kujdeset Kryetari i Komunës së Gjilanit.

V

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Gjilanit.

KUVENDI I KOMUNËS-GJILAN

01.Nr. 11585
Gjilan, më 29.09.2009


Kryesuesi i kuvendit,

/Bujar NEVZATI/



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, eee.gjilani-komuna.org; e-mail: zip_gjilan@hotmail.com, tel. 0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 486

Duke u bazuar në nenin 38.1 shkronja c), nenin 52.4 të Statutit të Komunës së Gjilanit, si dhe bazuar në Rekomandimin e Komitetit për Politikë dhe Financa të datës 30.09.2009, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 12.10.2009, miratoi këtë:

V E N D I M

Për dhënien në shfrytëzim të tokës-truallit për ndërtimin e gjashtë (6) shtëpive për të zhvendosurit brenda Komunës së Gjilanit

I

Me këtë vendim jepet në shfrytëzim toka-trualli në sipërfaqe prej 0.18.00 ha, për ndërtimin e gjashtë (6) shtëpive për personat e zhvendosur brenda territorit të Komunës së Gjilanit, të Komunitetit serb, në ngastrën kadastrale nr.1680-0, vendi i quajtur "Rid", Komuna Kadastrale: Budrigë.

II

Po ashtu me këtë vendim obligohen sektorët e veçantë Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër, Pronë dhe Banim dhe Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit që të ndërmarrin veprimet e nevojshme dhe të bëjnë parcelimin, matjen, përcaktimin e kufjve dhe krijimin e parakushteve për fillimin e ndërtimit të shtëpive për të zhvendosurit si në pikën I të këtij vendimi

III

Për zbatimin e këtij vendimi obligohen Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër, Pronë dhe Banim dhe Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit e KK-Gjilan, ndërsa për implementimin e tij do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Nënkrjetari për Komunitete i Komunës së Gjilanit.

IV

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Gjilanit.

KUVENDI I KOMUNËS-GJILAN

01.Nr. 12075
Gjilan, më 12.10.2009


Kryesuesi i kuvendit,

/Bujar NEVZATI/



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, www.gjilani-komuna.org; e-mail: zip_gjilan@hotmail.com, tel. 0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 486

Duke u bazuar në nenin 38.1 shkronja c), nenin 52.4 të Statutit të Komunës së Gjilanit, si dhe bazuar në Rekomandimin e Komitetit për Shërbime Publike, Komunale, Mbrojtje dhe Shpëtim, dhe pas shqyrtimit të kërkesës së OVL të UÇK-së-Dega në Gjilan, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 12.10.2009, miratoi këtë:

V E N D I M

Për lejimin e vendosjes së Pllakës përkujtimore për Dëshmorët Afrim Gagica dhe Naser Azemi

I

Me këtë vendim lejohet vendosja e Pllakës përkujtimore për Dëshmorët e kombit Afrim Gagica dhe Naser Azemi, në vendin e rënies së tyre afër Shkollës fillore "Thimi Mitko" në Gjilan.

II

Po ashtu me këtë vendim obligohen sektorët e veçantë të Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër, Pronë dhe Banim dhe Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit që të ndërmarrin veprimet e nevojshme për krijimin e kushteve për vendosjen e Pllakës përkujtimore.

III

Për zbatimin e këtij vendimi obligohen Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër, Pronë dhe Banim dhe Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit e KK-Gjilan, ndërsa për implementimin e tij do të kujdeset Kryetari i Komunës së Gjilanit.

IV

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Gjilanit.

KUVENDI I KOMUNËS-GJILAN


01.Nr. 12085
Gjilan, më 12.10.2009

Kryesuesi i kuvendit,

/Bujar NEVZATI/



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN
BELEDIYESI



Adresa: rr."Adem Jashari", pn, vvvgjilani-komuna.org; zip gjilan@hotmail.com, tel.028/20 781, 20 782, 21 482.

Në bazë të nenit 17 pika b. dhe c. të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/2008, nenit 38.1.c. të Statutit të Komunës së Gjilanit, Kuvendi i Komunës së Gjilani, duke vendosur sipas kërkesës së: Zyrës Projekteve të KK_ës Gjilan, për sigurimin e lokacionit për ndërtimin e objekteve për persona me aftësi të kufizuar, të dt. 13.03/2009, në seancën e mbajtur më datë: 12.10. 2009, miraton këtë:

V E N D I M

për

dhënjën në shfrytëzim të tokës-truallit për ndërtimin e Objektivit për Persona me Aftësi të Kufizuar

I.

Me këtë vendim, Shoqatës: "Handikos", "Shoqatës së Shurdhmemecëve" dhe "Shoqatës të Verbërve" që të tria me seli në Gjilan, iu IPET në shfrytëzim të përhershëm, pjesa e Ngatrës Kadastrale nr. 1-3, me kulturë Parcelë, në sip. = **3800m² (tridhjetë e tetë ari)** (nga gjithsej s= 38289m²), vendi i quajtur: "Gllama", Zona Kadastrale: Gjilan, e cila evidentohet në Flëtposedimin nr. 1750, në emër të P.SH-Kuvendi Komunal- Gjilan.

II.

Ngastra kadastrale e përshkruar në pikën I. të këtij Vendimi, duhet të shfrytëzohet ekskluzivisht për ndërtimin e: *Objektivit për Persona me Aftësi të Kufizuara të Komunës së Gjilanit me përmbajtje përcjellëse*, në tërësi sipas kushteve tekniko-urbanistike të përcaktuara me Zgjidhjen urbanistike-teknike të hartuar nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit të Komunës së Gjilanit më datë 08. Tetor. 2009, e cila është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

III.

Obligohet Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit e Komunës së Gjilanit që revidimin sipas pikës I. dhe II. të këtij vendimi ta inkorporoj në Planin Rregullues Urban të lokacionit konkret, në rastin e hartimit dhe miratimit të të njëjtit.

IV.

Obligohet Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër, Pronë dhe Banim e KK-ës Gjilan që të bëjë ri parcelimin, matjen përcaktimin e kufijve dhe përlllogaritjen e sipërfaqes dhe regjistrimin e truallit-ngatrës në fjalë, në tërësi sipas paraqitjes grafike të hartuar nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit të Komunës së Gjilanit.

V.

Nga dita e hyrjes në fuqi e këtij vendimi, pushon të vlejë-lihet jashtë fuqisë, Vendimi i KK-ës Gjilan, 01.nr.4818 i dt. 29.04/2009, për dhënie në shfrytëzim të tokës-truallit përkatësisht pjesëve të Ngatrës Kadastrale nr. 2438-1 në sip. 1600m² dhe ng. kadastrale nr. 2438-4, në sip. 419m², vendi i quajtur: "Monopol", Zona Kadastrale: Gjilan, e cila evidentohet në Flet posedimin nr. 1750, në emër të P. SH. e Komunës së Gjilanit si dhe pjesa e ngatrës kadastrale nr. 2437 nga rrethoja e Qendrës për Punë Sociale në Gjilan deri te kufijtë e ng. kad 2438, e evidentuar në FP-QP, nr. 5773, në emër të Qendrës për Punë Sociale në Gjilan si dhe të gjitha aktet që kanë rrjedhë si pasojë e këtij vendimi si dhe Vendimi-Leja e ndërtimit nr. 07-271/424 e dt. 10. Shtator. 2009 e lëshuar nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit e Komunës së Gjilanit.

VI.

Obligohet DGJKPB, që të bëjë ç` regjistrimin edhe rikthimin në gjendjen e mëhershme të pronës nga pika V. e këtij vendimi.

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës së Gjilanit, Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit e KK-ës Gjilan, si dhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër, Pronë dhe Banim e KK-ës Gjilan.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.


01.Nr. 12083
Gjilan, më 12.10.2009

K R Y E S U E S I,
/Bujar Nevzati/



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, www.gjilani-komuna.org; e-mail: zip_gjilan@hotmail.com, tel. 0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 486

Duke u bazuar në nenin 38.1 shkronja c), nenin 52.4 të Statutit të Komunës së Gjiçanit, Kuvendi i Komunës së Gjiçanit në seancën e mbajtur më 12.10.2009, miratoi këtë:

V E N D I M

Për dhënien në shfrytëzim të tokës-truallit për ndërtimin e gjashtë (6) shtëpive për të zhvendosurit jashtë territorit të Komunës së Gjiçanit

I

Me këtë vendim jepet në shfrytëzim toka-trualli, për ndërtimin e gjashtë (6) shtëpive për personat e zhvendosur jashtë territorit të Komunës së Gjiçanit, të Komunitetit Rom, në Lagjen "Qenar Qeshme" të cilat familje para luftës në këtë lagje kanë jetuar në baraka si raste sociale.

II

Po ashtu me këtë vendim obligohen sektorët e veçantë të Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër, Pronë dhe Banim dhe Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit që të ndërmarrin veprimet e nevojshme dhe të bëjnë parcelimin, matjen, përcaktimin e kufijve dhe krijimin e parakushteve për fillimin e ndërtimit të shtëpive për të zhvendosurit si në pikën I të këtij vendimi

III

Për zbatimin e këtij vendimi obligohen Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër, Pronë dhe Banim dhe Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit e KK-Gjiçan, ndërsa për implementimin e tij do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Nënkrjetari për Komunitete i Komunës së Gjiçanit.

IV

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Gjiçanit.

KUVENDI I KOMUNËS-GJILAN

01.Nr. 12076
Gjiçan, më 12.10.2009


Kryesuesi i kuvendit,

/Bujar NEVZATI/



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, gje.gjilani-komuna.org; e-mail: zip_gjilan@hotmail.com, tel. 0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 486

Në bazë të nenit 17.1, 20 dhe 24.1 dhe 2. të Ligjit për Planifikim Hapësinor, nr. 2003/14, nenit 38.1. pika b. dhe c. e Statutit të Komunës së Gjilanit, dhe Vendimit të KK-ës Gjilan, për qasjen e hartimit të Planit Rregullues Urban "Kodra e Thatë", nr. 01-3747/0101, dt. 16.04/2008, Kuvendi i Komunës së Gjilani, në seancën e mbajtur më datë: 12.10.2009, miraton këtë:

V E N D I M

Për miratimin e Zgjidhjes Urbanistike të pjesës së P.Rr.U: "Kodra e Thatë" në Gjilan (stacioni i Autobusëve "Kosovatrans" - Rr. "Gjon Sereqi")

I.

Me këtë vendim miratohet Zgjidhja Urbanistike e lokacionit, cili përfshinë hapësirën duke filluar nga stacioni i Autobusëve: "Kosovatrans" në Gjilan, rrugës së Ferizajt, deri të rruga: "Gjon Sereqi", në drejtim të Lagjes Iliria, deri të Rr.ku kthehet në të majtë dhe vazhdon në drejtim të qendrës së qytetit deri në pikën fillestare, në sipërfaqe prej gjithsej.....m².

II.

Zgjidhja Urbanistike është hartuar nga Kompania: "Urban+" nga Prishtina, dhe e njëjta përmban të pjesën tekstuale dhe grafike me të gjitha elementet e Planit Rregullues Urban, duke përfshirë përshkrimin e gjendjes ekzistuese dhe mundësit e organizimit të ndërtimit të objekteve të reja sipas shtrirjes dhe formës, madhësisë, etazhitetit dhe destinimit si dhe organizimin e rregullimit të hapësirave të lira me të gjitha përmbajtjet e nevojshme të infrastrukturës komunale teknike në tërësi sipas paraqitjes grafike, e cila është pjesë përbërëse e këtij Vendimi.

III.

Obligohet Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit e Komunës së Gjilanit të revidimin sipas pikës I. dhe II. të këtij vendimi ta inkorporoj në Planin Detaj Urbanistik: "Zona Perëndimore - Qarku" në Gjilan.

IV.

Nga dita e hyrjes në fuqi e këtij vendimi, pushon të vlejë pjesa e Planit Detaj Urbanistik i përfshirë me pikën I. të këtij vendimi.

V.

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës së Gjilanit, Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit e KK-ës Gjilan, si dhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë e KK-ës Gjilan

VI.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS SË GJILANIT

01.Nr. 12074
Gjilan, më 12.10.2009.


K r y e s u e s i,

/Bujar Nevzati/



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr."Adem Jashari", pn, yvvqjilani-komuna.org; zip gjilan@hotmail.com, tel.028/20 781, 20 782, 21 482.

Në bazë të nenit 17 pika b. dhe c. të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/2008, nenit 38.1.c. të Statutit të Komunës së Gjilanit, Kuvendi i Komunës së Gjilanit, duke vendosur sipas kërkesës së: Ministrisë së Drejtësisë - Shërbimi Korrektues i Kosovës-Prishtinë/ Drejtorisë së Qendrës së Paraburgimit në Gjilan, nr. 01-73 e dt. 31. mars/2009, të ripërsëritur me kërkesën nr. 07-10734 të dt. 08.09/2009, për dhënien në shfrytëzim edhe të një pjese të tokës ndërtimore, për ndërtimin e *Qendrës së Paraburgimit", në seancën e mbajtur më datë: 12.10.2009, miraton këtë:

V E N D I M

Për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale për: Ndërtimin e Qendrës së Paraburgimit

I.

Me këtë vendim Qendrës së Paraburgimit në Gjilan, I EPET në shfrytëzim sipërfaqja prej: 3.21.18 ha hektarësh nga pjesa e ngastrës kadastrale nr.4462-1, në sipërfaqe prej gjithsej: 80268m², vendi i quajtur: Pasjak, Zona Kadastrale: Koretishtë, e cila evidentohet në Flet posedimin nr. 516, në emër të: Pasuri Shoqërore e kuvendi Komunal-Gjilan.

II.

Ngastra kadastrale e përshkruar në pikën I. të këtij Vendimi, duhet të shfrytëzohet ekskluzivisht për ndërtimin e objektit: *Qendra e Paraburgimit-Gjilan*, në tërësi sipas kushteve tekniko-urbanistike të qe do të përcaktohen me akt të veçantë të Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit të Komunës së Gjilanit, në procedurën e pajisjes me Leje Ndërtimi.

III.

Qendra e Paraburgimit ne Gjilan, obligohet që menjëherë pas ndërtimit të objektit të ri, në lokacionin e ri në "Pasjak", Kuvendit të Komunës së Gjilanit të ia dorëzojë në posedim objektin e vjetër dhe ngastrën kadastrale ku është i ndërtuar objekti i tanishëm.

IV.

Obligohet Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër, Pronë dhe Banim e KK-ës Gjilan që të bëjë matjen, përcaktimin e kufijve dhe përlllogaritjen e sipërfaqes së ngastrave nga pika I. e këtij vendimi, në tërësi sipas paraqitjes grafike të hartuar nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit të Komunës së Gjilanit.

V.

Mbi zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës së Gjilanit, Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë e Komunës së Gjilanit.

IV.

Ky Vendim hynë në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS SË GJILANIT


Nr. 01. 12073
Gjilan, më 12.10.2009

K R Y E S U E S I,



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, ëëë.gjilani-komuna.org; e-mail: zip_gjilan@hotmail.com, tel. 0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 486

Në bazë të nenit 10.2, 15 dhe 16 të Ligjit për Planifikimin Hapësinor, Nr.14/ 2003 nenit 1. dhe 2. të Udhëzimit Administrativ për zbatimin e Ligjit për planifikimin hapësinor mbi elementet e themelore të Planit Rregullues, nr. 41-02/05 prej 04 mars 2004, nenit 17.b. Ligjit për Qeverisjen Lokale, nr. 03/L-040(g.z. e Republikës së Kosovës) nr. 28/2008, nenit 38.b. të Statutit të Komunës së Gjilanit, Kuvendi i Komunës së Gjilanit, e në mbështetje të pikës I të Vendimit të KK-ës Gjilan, 01.nr. 3269/0101, të dt. 16.04/2008 për qasjen e revidimit të Planeve Rregulluese Urbani të Qytetit të Gjilanit, në seancën e vetë të mbajtur më: 19.05.2010, miraton këtë:

V E N D I M

Për miratimin e Planit Rregullues Urban: "Qendra-Zona-1" e Qytetit të Gjilanit

I.

Me këtë Vendim, miratohet Plani Rregullues Urban: "Qendra-Zona -1", e Qytetit të Gjilanit, (në tekstin e mëtejme: PRRU-"Qendra-Zona-1", i cili përfshinë hapësirën e cila përkufizohet duke filluar nga ura mbi Lumin "Mirusha" në qendër të Qytetit duke vazhduar paralel me shtratin e Lumit deri te Xhamia e Balcit, duke përcjellë kufirin në mes Stadiumit të Qytetit dhe Kompleksit të Shkollave të Mesme, deri te Objekti: "Inkubatori i Biznesit", kthehet në të djathtë deri te objekti i PTK-ës, ku del në rrugën kryesore të cilën e përcjell dhe e prët duke vazhduar deri te rruga: "Rexhep Mala", kthehet në të djathtë deri të rruga "A. Presheva", ku kthehet në të majtë deri te rruga e parë, kthehet djathtas dhe e përcjell rrugën të cilën e përcjell deri te bashkimi me rrugën "Reshat Ymeri", ku kthehet në drejtim të Qytetit deri te rruga kryesore Gjilan-Bujanovc, kthehet në të majtë duke e përcjellë të njëjtën deri të ura mbi lumin Stanishor, ku kthehet në të djathtë duke përcjellë rrugën Gjilan –Malishevë deri te kthesa e parë, duke përcjell kufirin e tregut të Gjellbër deri te objekti i parë, ku kthehet në të majtë deri te shtrati i Lumit "Mirusha" të cilin më pastaj e përcjellë rrjedhës së epërme deri në Qendër të Ura, përkatësisht pika fillestare, në sipërfaqe prej gjithsej: 40 hektar.

II.

PRRU: "Qendra-Zona-1", është hartuar nga Studio e Planifikimit dhe Dizajnit Urban: "URBAN Plus", me seli në Prishtinë.

III.

Dokumenti nga pika paraprake e këtij Vendimi, vërtetohet me vulën e Kuvendit të Komunës së Gjilanit dhe nënshkrimin e Kryetarit të Komunës së Gjilanit, në pesë ekzemplar të njëjtë dhe i njëjti përbëhet nga pjesa tekstuale dhe pjesa grafike.

IV.

Plani përmban:

a. Pjesa tekstuale përmban:

- kufijtë e zonës për të cilën hartohet plani dhe shenjëzat e tyre në hartat kadastrale;
- gjendja ekzistuese;
- destinimi i sipërfaqeve;
- vijat rregullative të rrugëve dhe sipërfaqeve publike si dhe vijat ndërtimore;
- pikat e lartësisë së rrugëve dhe sipërfaqeve publike (plani i nivelimit);
- zgjidhjen e rrjetit të infrastrukturës: rrugëve, furnizimit me ujë, ujërave të zeza, ujërave atmosferike, telekomunikimet, elektricitetit etj dhe kycjet në infrastrukturë;
- plani i parcelimit dhe ri parcelimit;
- normat dhe standardet teknike për zhvillimin urban duke përfshirë shkallën e planeve;
- 9 kushtet dhe kriteret për mbrojtje mjedisore;
- kushtet dhe kriteret për shfrytëzim racional të energjisë;

- kushtet urbane për sipërfaqet publike, private si dhe elementet përcjellëse;
- kërkesat e veçanta, kushtet dhe rregulloret e domosdoshme për lëshimin e lejes ndërtimore, sipas vendit dhe llojit të objektit që është duke u ndërtuar;
- vlerat me rëndësi natyrore, kulturore, historike si dhe identifikohen objektet për të cilat është e domosdoshme të sigurohet mbrojtje ose kushte të tjera të veçanta para fillimit të renovimit apo rikonstruimit të tyre;
- kushtet në lidhje me mbrojtjen mjedisore nga lloje të ndryshme të ndotjes, mbrojtja e bio diversitetit, mbrojtja nga zjarri dhe fatkeqësitë e tjera si dhe shkatërrimet;
- lloji dhe karakteri i objektit që mund të ndërtohet nën kushtet e përcaktuara me plan ose nën kushte të veçanta;
- lloji dhe shfrytëzimi i objektit, ndërtimi i së cilit është i ndaluar në zona të caktuara;
- pozita e objektit në parcelë dhe në kuadër të parcelave fqinje;
- lartësia / Etazhiteti objekteve;
- distanca më e vogël ndërmjet objekteve;
- kushtet për ndërtimin e objekteve të tjera në parcelën e njëjtë ndërtimore;
- kushtet dhe mënyrat e sigurimit të hyrjes në parcelë dhe në hapësirën e parkingut;
- kushtet për definimin e rrethojave;
- formësimi arkitektonik dhe estetik i elementeve të caktuara
- kushtet për renovim dhe rikonstruim të objekteve ekzistuese;
- kushtet e veçanta për ndërtim të objekteve;
- dendësia e banimit dhe dendësia e ndërtimit sipas standardeve;
- kushtet që kanë të bëjnë me hapësirat e lira të cilat duhet të mirëmbahen në apo përreth ndërtesave;
- kushtet e kyçjes në infrastrukturë (p.sh. furnizimi me ujë, menaxhimi i hedhurinave të ngurta, hapësirat për parkingje, etj.);
- kushtet për vendosjen e objekteve tregtare, punëtorive, depove apo fabrikave;
- kushtet për vendosjen e objekteve me karakteristika të veçanta arkitektonike të dizajnuara për qëllime të veçanta;
- kushtet për ndërtimin e objekteve me rëndësi strategjike
- programin e rregullimit të tokës ndërtimore

b. Pjesa grafike përmban:

- plani e infrastrukturës dhe përmbajtjeve publike,
- bazën gjeodezike;
- ortofoto-gjendja: 2004.
- prerjet, dukjet në hapësirë, aksonometrinë e objekteve, etj;
- hartat-vizatimet në përpjesë 1:200 ,1 :500, 1 :1000 dhe 1 : 2500, varësisht nga madhësia e sipërfaqes së përfshirë me plan;
- ekstraktin nga Planin Zhvillimor Urban;
- kufijtë e hapësirës që trajtohet ;
- destinimin e sipërfaqeve dhe mënyrën e shfrytëzimit të tokës përkatësisht objektit; rregullat e ndërtimit dhe rregullimit; mënyrën e përtëritjes së gjendjes ekzistuese, ndarjen në tërësi hapësinore dhe njësi në kuadër të planit ;
- planin e infrastrukturës rrugore me profilet karakteristike dhe me elementet analitike-gjeodete për infrastrukturë të rrugore;
- planin nivelues; vijat ndërtimore; vijat rregullative;
- planin e parcelimit;
- planin e rrjetit dhe objekteve të infrastrukturës, sipërfaqeve të lira etj;
- shtesat e tjera, varësisht nga nevoja e planit.

V

Planin nga pika I. e këtij Vendimi përbën dokumentin themelor për realizimin e programit të rregullimit, organizimin dhe destinimin e hapësirës së këtij lokacioni, përcakton rregullat dhe kriteret e ndërtimit në banime-afariste dhe rrjetit të objekteve të infrastrukturës publike.

VI.

PRRU: “Qendra-Zona1”, duhet të inkorporohet në Planin Zhvillimor Urban të Qytetit të Gjilanit.

VII.

Ngastrat kadastrale të përfshira me këtë plan e të cilat janë të destinuara për objekte publike, e që nuk janë pronë Komunale, shpallen me interes të përgjithshëm publik, në tërësi sipas ligjit në fuqi.

VIII.

Për zbatimin e këtij vendimi, do të kujdeset Kryetari i Komunës së Gjilanit përmes, Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër, Pronë dhe Banim dhe Drejtorisë për Shërbime Publike të KK-ës Gjilan.

IX.

Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi, pushojnë të vlejnjë pjesët e Planeve Detaje Urbanistike e të cilat janë të përfshira në këtë plan.

X.

Ky Vendim hynë në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Gjilanit.

Nr. 01, 5791
Gjilan, më 19.05.2010.


Kuvendi i komunës,

Izmi Zeka, Kryesues



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, www.gjilani-komuna.org; e-mail: zip_gjilan@hotmail.com, tel. 0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 486

Në bazë të nenit 14. të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal, nr. 03/L-049, nenit 17 pika b. dhe c. të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/2008, nenit 5, 37, 43, 44 dhe 46 të Ligjit mbi tokën ndërtimore, ("Gazeta Zyrtare e Kosovës", nr. 14/80 dhe 42/86), nenit 38.1. b, c, d, e, f, të Statutit të Komunës së Gjiçanit, pikës IV. dhe V. të Vendimit për miratimin e Planit Zhvillimor Komunal të Komunës së Gjiçanit, nr. 01-11736, pikës IV. dhe V. të Vendimit për miratimin e Planit Zhvillimor Urban të Qytetit të Gjiçanit, nr. 01-11735, të dt. 30.10/2008, Kuvendi i Komunës së Gjiçanit në seancën e vet të mbajtur më datën: 19.05.2010, miraton këtë:

V E N D I M

PËR CAKTIMIN E ZONAVE TË TOKËS NDËRTIMORE NË TERRITORIN E KOMUNËS SË GJILANIT

Neni 1.

Me këtë vendim përcaktohen zonat e tokës ndërtimore në territorin e Komunës së Gjiçanit.

Bazat, masat dhe kriteret për caktimin e zonave të tokës ndërtimore në territorin e Komunës së Gjiçanit, përkatësisht Qytetit të Gjiçanit janë:

- shkalla reale e rregullimit të tokës ndërtimore-pajisja me objekte të infrastrukturës komunale publike: rrjetit të rrugës, ujësjellësit, kanalizimit fekal dhe atmosferik, rrjetit të elektrikes, ndriçimit publik, telekomunikacionit, hapësirave gjelbëruese dhe rekreative, objekteve të karakterit të përgjithshëm publik, objekteve edukativo-arsimore, kulturore, sportive, shëndetësore etj.
- përshtatshmëria për banim dhe zhvillim ekonomik që ofron toka ndërtimore dhe
- programi i rregullimit të tokës ndërtimore-strategjinë zhvillimore të Komunës së Gjiçanit në tërësi dhe Qytetit të Gjiçanit në veçanti.

Neni 2.

Në bazë të kriterëve nga al. 1 e nenit 1. të këtij Vendimi, toka ndërtimore e Komunës së Gjiçanit ndahet në gjithsej 2 zona dhe atë :

- A. zona Urbane e Qytetit të Gjiçanit, të cilën e përbëjnë tri (3) nën zona dhe
- B. zona Rurale e Fshatrave dhe Vendbanimeve Rurale , të cilën e përbëjnë dy (2) nën zona.

Neni 3.

A/I. Zona Urbane- Nën zona e Parë:

Përfshinë të gjitha ngastrat kadastrale në pjesën e Qytetit, përkatësisht brenda kufijve të ngastrave kadastrale duke filluar nga rruga për Varreza të Qytetit, mbi Hallën e Sporteve) duke përfshirë edhe stadiumin mbi parkun e epërm, ku kthehet në të majtë duke përcjellë kufirin e varrezave deri mbi Shk. Fill. "Abaz Ajeti", përfshin oborrin e Shkollës, e kalon rrugën Gjilan- Velekincë, përcjellë kufirin e ish Fabrikës-Kombinati i Tekstilit "Integji", përfshinë dhe e përcjellë kufirin e Kombinatit të Tekstilit, Fabrikën e Radiatorëve, duke kaluar rrugën Gjilan-Zabel dhe përfshin kompleksin e ish Thertores së vjetër deri te Shtrati i Lumit "Mirusha", ku kthehet në drejtim të rrjedhës së epërme deri të unaza "Jugu I", kthehet në të djathtë deri te Lumi "Stanishor", ku kthehet në të majtë dhe përcjellë rrjedhën e epërme të lumit deri te rruga qarkore, kthehet në të majtë duke përcjellë rrugën "A. Presheva, ku kthehet në të djathtë në drejtim të lagjes "Banja", kthehet në të majtë dhe del në rrugën Gjilan Koretishtë mbi Fakultetin e Edukimit, vazhdon në drejtim të Koretishtës, deri te rruga e parë, ku kthehet majtas dhe del në rrugën e Lagjes "Dardania I" duke vazhduar deri të udhëkryqi i rrugës Gjilan-Prishtinë, e kalon atë dhe del deri te trekëndëshi ku ndahet rruga për Kodrën e Dëshmorëve dhe Livoq të Epërm, kthehet në të majtë dhe del të TV-Meni, përmbi Spitalin Regjional, duke vazhduar për kufij deri te rruga pas spitalit, ku e përcjellë të njëjtën deri të rruga Gjilan-Ferizaj, përball hallës së Sporteve, kthehet në drejtim të Ferizajt deri te rruga për varreza.

A/II. Zona Urbane – Nën zona e Dytë:

Përfshinë të gjitha ngastrat kadastrale që nuk janë të përfshira me nën zonën e I-rë, por të cilat gjinden brenda kufijve, duke filluar nga fillimi i rrugës qarkore në rrugën Ferizaj-Gjilan, përballë Kompanisë "Bejta Comerc"

pompa:”RiCOM, ku kthehet në të djathtë të rruga qarkore-“Ramiz Cërnica” ku kthehet në të djathtë duke përcjellë rrugën qarkore deri te kthesa e madhe, vazhdon rrugës: “Bahtir Jahiri”, e pret rrugën Gjilan – Livoq te Qendra e Mjekësisë Familjare, duke vazhduar Rr. “Rifat Berisha”, deri te ish Aeroporti Bujqësor, ku kthehet në të djathtë duke përcjellë në tërësi rrugën qarkore nga udhëkryqi: Gjilan-Prishtinë, duke vazhduar dhe përcjellë rrugën qarkore, kah ish aeroporti bujqësor, udhëkryqi Gjilan Prishtinë, Gjilan-Koretishtë, Gjilan –Stanishor, Gjilan- Kufcë e Epërme, deri te bashkimi më rrugën Gjilan - Bujanovc përballë Fabrikës së Baterive dhe vazhdon deri të Udhëkryqi i rrugës Kufcë e Epërme –Shillovë, e kalon rrugën magjistrale dhe përballë frigoriferit kthehet në të djathtë duke përcjellë kufirin e hapësirës së përfshirë me PRRU “Kampi Montith” prapa Fabrikës së Çelikut- F. Baterive deri të përroi nën F. Baterive kthehet në të majtë deri te rruga Gjilan-Malishevë në Kufcë të Ultë, përkatësisht Qeshmja ku kthehet në të djathtë deri të rruga Kufcë e Ultë-Zabel – ish tregu në Lagjen “Arbëri”, dhe del në rrugën Gjilan –Velekincë dhe te Trafostacioni vazhdon rrugës Arbëri - Livoq i Ultë, të cilën e përcjellë deri pas kodrës dhe te udhëkryqi i parë kthehet në të djathtë në vijë të drejtë e prët rrugën e vjetër të Kumanovës deri te rruga magjistrale Ferizaj-Gjilan, ku kthehet në të majtë dhe del te pika fillestare përball “Bejta Comec”.

A/III. Zona e Urbane –Nën zona e Tretë: përfshinë Lagjet dhe Vendbanimet e Qytetit jashtë kufirit të nën zonës së II-të, dhe Brenda kufirit të Planit Zhvillimor Urban të Qytetit të Gjilanit, nr.01-11735, të miratuar më datë: 30.10/2008;

B /I. Zona Rurale –Nën zona e Parë: përfshinë Fshatrat dhe Vendbanimet e rrafshëta dhe atë: Velekincë, Pasjan, Llashticë, Zhegër, Lladovë, Nasalë, Budrigë, Partesh, Cërnica, Livoq i Ultë, Livoq i Epërm, Pasjak, Bresalc, Koretishtë, Stanishor, Kufcë e Epërme, Shillovë, Përlepnicë, Kmetovc, Mireshe, Pogragjë, Uglarë dhe Malishevë e Ultë.

B/II. Zona Rurale- Nën zona e Dytë: fshatrat dhe vendbanimet kodrinore-malore dhe që nuk janë të përfshira me zonat nën zonën e I-rë rurale, përkatësisht nën zonat tjera.

Neni 4.

Obligohet Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër, Pronë dhe Banim e KK-ës Gjilan, që të bëjë paraqitjen grafike të kufijve, regjistrimin dhe përshkrimin e ngastrave kadastrale nga pika A. e nenit 2. të këtij Vendimi, në tërësi sipas përshkrimit të zonave-nën zonave të pjesës urbane nga neni paraprake.

Neni 5.

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është edhe paraqitja grafike e nxjerr nga PZHU i Qytetit të Gjilanit, përkatësisht PZHK i Komunës së Gjilanit.

Neni 6.

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës së Gjilanit dhe Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit e Komunës së Gjilanit

Neni 7.

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

Nr.01. 5792
Gjilan, më 19.05.2010.


Kuvendi i komunës,

Izmi Zeka, Kryesues



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, [ëëë.gjilani-komuna.org](http://ee.gjilani-komuna.org); e-mail: zip_gjilan@hotmail.com, tel. 0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 486

Në bazë të nenit 6.1 dhe 6.2. të Ligjit për Planifikimin Hapësinor nr. 14/2003, nenit 28 dhe 29 të Statutit të Komunës së Gjilanit, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 19.05.2010, miraton këtë:

V E N D I M
PËR FORMIMIN E KËSHILLIT TË EKSPERTËVE PËR PLANIFIKIM
ZHVILLIMOR TË KOMUNËS SË GJILANIT DHE PLANIFIKIM URBAN TË
QYTETIT TË GJILANIT

Neni 1.

Për sigurimin e kushteve për planifikim të qëndrueshëm dhe të barabartë hapësinor të territorit të Komunës së Gjilanit, mbështetjes profesionale dhe shkencore të dokumenteve të planifikimit hapësinor dhe dokumenteve tjera, Formohet Këshilli i ekspertëve për planifikimin zhvillimor të Komunës së Gjilanit dhe Planit Zhvillimor Urban të qytetit të Gjilanit (në tekstin e mëtejshëm: Këshilli) si Organ konsultativ i Kuvendit të Komunës së Gjilanit, në përbërje prej:

1. Sabri Tahiri, kryetar
2. Ali Arifi, Zv. kryetar
3. Abdyl Hasani,
4. Zeqirja Rrahmani,
5. Agim Salihu, anëtar
6. Nexhat Hajrullahu, anëtar
7. Ismet Mehmeti, anëtar
8. Sevdije Hyseni, anëtare
9. Luaras Idrizi, anëtar
10. Fadil Gashi, anëtar
11. Turhan Maksuti, anëtar

Neni 2.

- 2.1. Këshilli përbëhet prej kryetarit, zëvendës kryetarit dhe 9 anëtarëve nga radha e personave profesional, shkencor, publik dhe personave tjerë kompetent për planifikim hapësinor.
- 2.2. Këshillin e udhëheqë dhe e kryeson kryetari i Këshillit, kurse në mungesë të tij, zëvendësi i kryetarit të Këshillit.
- 2.3. Përbërja e këshillit duhet të reflektojë barazi gjinore dhe mundësi të barabarta.
- 2.4. Kuvendi me vendim të veçantë emëron personat e lartshënuar si anëtarë të Këshillit

Neni 3.
Detyrat e Këshillit

3. Këshilli ka për detyrë të:

- jep mendime, propozime dhe vërejtje në dokumentet e planifikimit hapësinor (Planin Zhvillimor të Komunës, Planet zhvillimore për zona të veçanta dhe Planin Zhvillimor Urban të Qytetit të Gjilanit) dhe në dokumentet tjera të përcaktuara me Ligjin për Planifikim Hapësinor të Kosovës të cilat i nxjerr: Qeveria e Kosovës, Kuvendi i Kosovës, Kuvendi i Komunës dhe organet e tij nga fusha e planifikimit hapësinor, e që kanë ndërlidhje me territorin e Komunës së Gjilanit.
- shqyrtojë dhe propozojë zgjidhje përkatëse në rastet e mos harmonizimit të strategjive zhvillimore për sektor të ndryshëm të rëndësishëm për planifikimin hapësinor.
- përcjell dhe kujdeset për procedurat nëpër të cilat duhet të kalojnë dokumentet e planifikimit hapësinor të cilat miratohen nga organet e Kuvendit dhe Qeverisë së Kosovës, Komunës së Gjilanit dhe organeve të tij, në vështrim të Ligjit për planifikim hapësinor dhe akteve tjera nga fusha e planifikimit hapësinor.
- kryen edhe punë tjera që dalin nga aktet juridike të organeve kompetente nga fusha e planifikimit hapësinor.

3.2. Këshilli duhet t'i raportojë Kuvendit të Komunës për punën e vetë.

Neni 4.
Kompensimi për anëtarët e Këshillit

Këshilli është organ konsultativ i Kuvendit, kështu që kompensimi për punën e Këshillit do të caktohet me akt të veçantë.

Neni 5.
Punët administrative-teknike të Këshillit

Për punët administrativo-teknike dhe çështje tjera lidhur me punën e Këshillit është përgjegjës Kuvendi Komunal.

Neni 6.

Këshilli përcakton rregullat e procedurës për punën e tij.

Neni 7.

Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, pushon të vlejë Vendimi për formimin e Këshillit të ekspertëve për Planifikim Zhvillimor të Komunës së Gjilanit, nr. 01.3740/0101 i datës 16.04.2008.

Neni 8.

Ky vendim hynë në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës.

Nr.01. 5797
Gjilan, më 19.05.2010


Kuvendi i komunës,

Izmi ZEKA, Kryesues



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa:rr."Adem Jashari" pn, ëëë.gjilani-komuna.org; e-mail:zip_gjilan@hotmail.com,tel.0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 486

Në

pajtim me nenin 4 paragrafi 2 dhe 3 dhe 3.3.11 të Ligjit për Shpronësimet e pronës së paluajtshme nr. 03/L – 139 dhe nenit 11 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L-040 dhe nenit 39 të Statutit të Komunës së Gjilanit 01. nr. 12479 të dt. 21.11.2008, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në mbledhjen e mbajtur me dt. 18.06.2010, miraton këtë:

V E N D I M
PËR SHPALLJEN E INTERESIT PUBLIK PËR SHPRONËSIM TË
PALUAJTSHMERIVE PËR RREGULLIMIN E KOMPLEKSIT MEMORIAL
“KODRA E DËSHMORËVE” NË GJILAN

- I. Shpallet interesi publik për shpronësimin e paluajtshmërisë për rregullimin e Kompleksit Memorial “Kodra e Dëshmorëve” në Gjilan.
- II. Pjesë e këtij vendimi do të jetë regjistri i pronave për shpronësim, i paraqitur me elaborat për shpronësim.
- III. Për zbatimin e këtij vendim kujdeset Drejtoria e Kadastrit, Gjeodezisë, Pronës dhe Banimit, Drejtoria e Urbanizmit dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit, Zyra e Projekteve dhe organet tjera për aq sa ndikohen me këtë vendim.
- IV. Mbikëqyrjen e realizimit të këtij vendimi e bënë Kryetari i Komunës së Gjilanit.
- V. Ky vendim hynë në fuqi në ditën e miratimit nga ana e KK-së në Gjilan.

01.Nr. 7286
Gjilan, më 18.06.2010


Kuvendi i Komunës,

Izmi ZEKA, Kryesues



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, www.gjilani-komuna.org; e-mail: zip_gjilan@hotmail.com, tel. 0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 486

Në bazë të nenit 10.2, 15 dhe 16 të Ligjit për Planifikimin Hapësinor, Nr.14/ 2003 nenit 1. dhe 2. të Udhëzimit Administrativ për zbatimin e Ligjit për planifikimin hapësinor mbi elementet e themelore të Planit Rregullues, nr. 41-02/05 prej 04.mars/2004, neit 17.b. Ligjit për Qeverisjen Lokale, nr. 03/L-040(g.z. e Republikës së Kosovës" nr. 28/2008, nenit 38.b. të Statutit të Komunës së Gjilanit, Kuvendi i Komunës së Gjilanit, e në mbështetje të pikës I. të Vendimit të KK-ës Gjilan, 01.nr. 3747/0101, të dt. 16.04/2008 për qasjen e hartimit të Planit Rregullues Urban "Kodra e Thatë" e Qytetit të Gjilanit, në seancën e mbajtur më: 28.09.2010, miraton këtë:

V E N D I M

Për miratimin e Planit Rregullues Urban: "KODRA E THATË" e Qytetit të Gjilanit

1.

Me këtë Vendim, miratohet Plani Rregullues Urban: "Kodra e Thatë", e Qytetit të Gjilanit, (në tekstin e mëtejme: PRrU-"Kodra e Thatë", i cili përfshinë hapësirën në mes të rrugës Gjilan – Ferizaj dhe Gjilan-Rruga e Vjetër e Kumanovës, duke filluar nga trekëndëshi nën Stacionin e Autobusëve dhe përcjellë rrugën në drejtim të lagjes "Iliria" dhe "Arbëria" deri te rruga mbi Varrezat e Qytetit, ku kthehet në të djathtë deri te rruga e Vjetër e Kumanovës, kthehet në të majtë duke e përcjellë të njëjtën deri te kryqëzimi me rrugën ekzistuese "Arbëri-Livoq i Ulët", kthehet në të djathtë duke përcjellë rrugën e paraparë me Plan Zhvillimor Urban të Qytetit të Gjilanit, deri te rruga magjistrale Gjilan-Ferizaj, kthehet në drejtim të Qytetit të Gjilanit deri te pika fillestare nën stacionin e Autobusëve, në sipërfaqe prej gjithsej: 120 hektar.

2.

PRrU: "Kodra e Thatë", është hartuar nga Studio e Universitetit AAB: "A-design", me seli në Prishtinë.

3.

Dokumenti nga pika paraprake e këtij Vendimi, vërtetohet me Vulën e Kuvendit të Komunës së Gjilanit dhe nënshkrimin e Kryetarit të Komunës së Gjilanit në pesë ekzemplar të njëjtë dhe i njëjti përbëhet nga pjesa tekstuale dhe pjesa grafike.

4.

Plani përmban:

a. Pjesa tekstuale përmban:

- kufijtë e zonës për të cilën hartohet plani dhe shenjëzimet e tyre në hartat kadastrale;
- gjendja ekzistuese;
- destinimi i sipërfaqeve;
- vijat rregullative të rrugëve dhe sipërfaqeve publike si dhe vijat ndërtimore;
- pikat e lartësisë së rrugëve dhe sipërfaqeve publike (plani i nivelimit);
- zgjidhjen e rrjetit të infrastrukturës: rrugëve, furnizimit me ujë, ujërave të zeza, ujërave atmosferike, telekomunikimet, elektricitetit, etj. dhe kycjet në infrastrukturë;
- plani i parcelimit dhe riparcelimit;
- normat dhe standardet teknike për zhvillimin urban duke përfshirë shkallën e planeve;
- 9. kushtet dhe kriteret për mbrojtje mjedisore;
- kushtet dhe kriteret për shfrytëzim racional të energjisë;
- kushtet urbane për sipërfaqet publike, private si dhe elementet përcjellëse;
- kërkesat e veçanta, kushtet dhe rregulloret e domosdoshme për lëshimin e lejes ndërtimore, sipas vendit dhe llojit të objektit që është duke u ndërtuar;
- vlerat me rëndësi natyrore, kulturore, historike si dhe identifikohen objektet për të cilat është e domosdoshme të sigurohet mbrojtje ose kushte të tjera të veçanta para fillimit të renovimit apo rikonstruimit të tyre;

- kushtet në lidhje me mbrojtjen mjedisore nga lloje të ndryshme të ndotjes, mbrojtja e biodiversitetit, mbrojtja nga zjarri dhe fatkeqësitë e tjera, si dhe shkatërrimet;
- lloji dhe karakteri i objektit që mund të ndërtohet nën kushtet e përcaktuara me plan ose nën kushte të veçanta;
- lloji dhe shfrytëzimi i objektit, ndërtimi i së cilit është i ndaluar në zona të caktuara;
- pozita e objektit në parcelë dhe në kuadër të parcelave fqinje;
- lartësia/Etazhiteti objekteve;
- distanca më e vogël ndërmjet objekteve;
- kushtet për ndërtimin e objekteve të tjera në parcelën e njëjtë ndërtimore;
- kushtet dhe mënyrat e sigurimit të hyrjes në parcelë dhe në hapësirën e parkingut;
- kushtet për definimin e rrethojave;
- formësimi arkitektonik dhe estetik i elementeve të caktuara të
- kushtet për renovim dhe rikonstruim të objekteve ekzistuese;

- kushtet e veçanta për ndërtim të objekteve;
- dendësia e banimit dhe dendësia e ndërtimit sipas standardeve;
- kushtet që kanë të bëjnë me hapësirat e lira të cilat duhet të mirëmbahen në apo përreth ndërtesave;
- kushtet e kycjes në infrastrukturë (p.sh. furnizimi me ujë, menaxhimi i hedhurinave të ngurta, hapësirat për parkingje, etj.);
- kushtet për vendosjen e objekteve tregtare, punëtorive, depove apo fabrikave;
- kushtet për vendosjen e objekteve me karakteristika të veçanta arkitektonike të dizajnuara për qëllime të veçanta;
- kushtet për ndërtimin e objekteve me rëndësi strategjike
- programin e rregullimit të tokës ndërtimore

c. Pjesa grafike përmban:

- Planin e infrastrukturës dhe përmbajtjeve publike,
- bazën gjeodezike;
- Ortofoto-gjendja: 2008.
- Prerjet, dukjet në hapësirë, aksonometrinë e objekteve, etj;
- Hartat-vizatimet në përpjesë 1:200, 1:500, 1:1000 dhe 1:2500, varësisht nga madhësia e sipërfaqes së përfshirë me plan;
- Ekstraktin nga Planin Zhvillimor Urban;
- Kufijtë e hapësirës që trajtohet ;
- Destinimin e sipërfaqeve dhe mënyrën e shfrytëzimit të tokës përkatësisht objektit; rregullat e ndërtimit dhe rregullimit; mënyrën e përtëritjes së gjendjes ekzistuese, ndarjen në tërësi hapësinore dhe njësi në kuadër të planit ;
- Planin e infrastrukturës rrugore me profilet karakteristike dhe me elementet analitike-gjeodete për infrastrukturë të re rrugore;
- Planin nivelues; vijat ndërtimore; vijat rregullative;
- Planin e parcelimit;
- Planin e rrjetit dhe objekteve të infrastrukturës, sipërfaqeve të lira etj;
- Shtesat e tjera, varësisht nga nevoja e planit.

5.

Planin nga pika I. e këtij Vendimi përbën dokumentin themelor për realizimin e programit të rregullimit, organizimin dhe destinimin e hapësirës së këtij lokacioni, përcakton rregullat dhe kriteret e ndërtimit të objekteve banesore-afariste dhe rrjetit të objekteve publike dhe objekteve të Infrastrukturës teknike komunale.

6.

PRrU: "Kodra e Thatë", duhet të inkorporohet në Planin Zhvillimor Urban të Qytetit të Gjilanit.

7.

Ngastrat kadastrale të përfshira me këtë plan e të cilat janë të destinuara për objekte publike dhe objekte të infrastrukturës komunale, e që nuk janë pronë Komunale, shpallen me interes të përgjithshëm publik, në tërësi sipas ligjit në fuqi.

8.

Për zbatimin e këtij vendimi, do të përkujdeset Kryetari i Komunës së Gjilanit përmes, Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër, Pronë dhe Banim dhe Drejtorisë për Shërbime Publike të KK-ës Gjilan.

9.

Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi, pushojnë të vlejnë pjesët e Planeve Detaje Urbanistike, Planeve Rregulluese Urbane, Zgjidhjeve urbanistike apo akteve tjera të cilat i kanë zëvendësuar ato plane, e të cilat janë të përfshira me këtë plan.

10.

Ky Vendim hynë në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Gjilanit.

Nr. 01. 12750
Gjilan, më 28.09.2010


Kuvendi i komunës

Izmi Zeka, Kryesues



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa:rr."Adem Jashari" pn, ëëë.gjilani-komuna.org; e-mail:zip_gjilan@hotmail.com,tel.0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 486

Në bazë të nenit 10.2, 15 dhe 16 të Ligjit për Planifikimin Hapësinor, Nr.14/ 2003 nenit 1. dhe 2. të Udhëzimit Administrativ për zbatimin e Ligjit për planifikimin hapësinor mbi elementet e themelore të Planit Rregullues, nr. 41-02/05 prej 04. mars/2004, neit 17.b. Ligjit për Qeverisjen Lokale, nr. 03/L-040(g.z. e Republikës së Kosovës" nr. 28/2008, nenit 38.b. të Statutit të Komunës së Gjilanit, Kuvendi i Komunës së Gjilanit,e në mbështetje të pikës I. të Vendimit të KK-ës Gjilan, 01.nr. 3267/0101, të dt. 16.04/2008 për qasjen e hartimit të Planit Rregullues Urban "Fidanishte" e Qytetit të Gjilanit, në seancën e mbajtur më: 28.09.2010, miraton këtë:

V E N D I M

Për miratimin e Planit Rregullues Urban: "FIDANISHTE" e Qytetit të Gjilanit

1.

Me këtë Vendim, miratohet Plani Rregullues Urban: "Fidanishte", e Qytetit të Gjilanit, (në tekstin e mëtejme: PRRU-"Fidanishte", i cili përfshinë hapësirën (trekëndëshin) në mes rrugës magjistrale: Gjilan- Bujanovc, duke filluar nga Ura mbi lumin Stanishor përbri Kazermës së TMK-ës, duke vazhduar në drejtim të Bujanovcit deri te bashkimi i rrugës unazore me rrugën magjistrale përball kufirit të Fabrikës për përpunimin e metaleve: "Çeliku" dhe Fabrikës së Baterive Ni-CD, në Gjilan, ku kthehet në anën e majtë në drejtim lagjes "Dheu i Bardhë" duke përcjell rrugën unazore ekzistuese deri te ura mbi lumin Stanishor, ku kthehet në drejtim të Qytetit duke përcjellë rrjedhën e poshtme të shtratit të lumit Stanishorka, deri të pika nisëse te Ura përbri Kazermës, në sipërfaqe rreth 50. hektar.

2.

PRRU: "Fidanishte", është hartuar nga NPN: "Favoring" me seli në Prishtinë.

3.

Dokumenti nga pika paraprake e këtij Vendimi, vërtetohet me Vulën e Kuvendit të Komunës së Gjilanit dhe nënshkrimin e Kryetarit të Komunës së Gjilanit në pesë ekzemplar të njëjtë dhe i njëjti përbëhet nga pjesa tekstuale dhe pjesa grafike.

4.

Plani përmban:

a. Pjesa tekstuale përmban:

- kufijtë e zonës për të cilën hartohet plani dhe shënjimet e tyre në hartat kadastrale;
- gjendja ekzistuese;
- destinimi i sipërfaqeve;
- vijat rregullative të rrugëve dhe sipërfaqeve publike si dhe vijat ndërtimore;
- pikat e lartësisë së rrugëve dhe sipërfaqeve publike (plani i nivelimit);
- zgjidhjen e rrjetit të infrastrukturës: rrugëve, furnizimit me ujë,ujërave të zeza, ujërave atmosferike, telekomunikimet, elektricitetit,etj. dhe kycjet në infrastrukturë;
- plani i parcelimit dhe riparcelimit;
- normat dhe standardet teknike për zhvillimin urban duke përfshirë shkallën e planeve;
- 9. kushtet dhe kriteret për mbrojtje mjedisore;
- kushtet dhe kriteret për shfrytëzim racional të energjisë;
- kushtet urbane për sipërfaqet publike, private si dhe elementet përcjellëse;
- kërkesat e veçanta, kushtet dhe rregulloret e domosdoshme për lëshimin e lejes ndërtimore, sipas vendit dhe llojit të objektit që është duke u ndërtuar;
- vlerat me rëndësi natyrore, kulturore, historike si dhe identifikohen objektet për të cilat është e domosdoshme të sigurohet mbrojtje ose kushte të tjera të veçanta para fillimit të renovimit apo rikonstruimit të tyre;
- kushtet në lidhje me mbrojtjen mjedisore nga lloje të ndryshme të ndotjes, mbrojtja e biodiversitetit, mbrojtja nga zjarri dhe fatkeqësitë e tjera, si dhe shkatërrimet;

- lloji dhe karakteri i objektit që mund të ndërtohet nën kushtet e përcaktuara me plan ose nën kushte të veçanta;
- lloji dhe shfrytëzimi i objektit, ndërtimi i së cilit është i ndaluar në zona të caktuara;
- pozita e objektit në parcelë dhe në kuadër të parcelave fqinje;
- lartësia/Etazhiteti objekteve;
- distanca më e vogël ndërmjet objekteve;
- kushtet për ndërtimin e objekteve të tjera në parcelën e njëjtë ndërtimore;
- kushtet dhe mënyrat e sigurimit të hyrjes në parcelë dhe në hapësirën e parkingut;
- kushtet për definimin e rrethojave;
- formësimi arkitektonik dhe estetik i elementeve të caktuara të
- kushtet për renovim dhe rikonstruim të objekteve ekzistuese;
- kushtet e veçanta për ndërtim të objekteve;
- dendësia e banimit dhe dendësia e ndërtimit sipas standardeve;
- kushtet që kanë të bëjnë me hapësirat e lira të cilat duhet të mirëmbahen në apo përreth ndërtesave;
- kushtet e kycjes në infrastrukturë (p.sh. furnizimi me ujë, menaxhimi i hedhurinave të ngurta, hapësirat për parkingje, etj.);
- kushtet për vendosjen e objekteve tregtare, punëtorive, depove apo fabrikave;
- kushtet për vendosjen e objekteve me karakteristika të veçanta arkitektonike të dizajnuara për qëllime të veçanta;
- kushtet për ndërtimin e objekteve me rëndësi strategjike
- programin e rregullimit të tokës ndërtimore

d. Pjesa grafike përmban:

- Plani e infrastrukturës dhe përmbajtjeve publike,
- bazën gjeodezike;
- Ortofoto-gjendja: 2004.
- Prerjet, dukjet në hapësirë, aksonometrinë e objekteve, etj;
- Hartat-vizatimet në përpjesë 1:200 ,1 :500, 1 :1000 dhe 1 : 2500, varësisht nga madhësia e sipërfaqes së përfshirë me plan;
- Ekstraktin nga Plani Zhvillimor Urban;
- Kufijtë e hapësirës që trajtohet ;
- Destinimin e sipërfaqeve dhe mënyrën e shfrytëzimit të tokës përkatësisht objektit; rregullat e ndërtimit dhe rregullimit; mënyrën e përtëritjes së gjendjes ekzistuese, ndarjen në tërësi hapësinore dhe njësi në kuadër të planit ;
- Planin e infrastrukturës rrugore me profilet karakteristike dhe me elementet analitike-gjeodete për infrastrukturë të re rrugore;
- Planin nivelues; vijat ndërtimore; vijat rregullative;
- Planin e parcelimit;
- Planin e rrjetit dhe objekteve të infrastrukturës, sipërfaqeve të lira etj;
- Shtesat e tjera, varësisht nga nevoja e planit.

5.

Plani nga pika I. e këtij Vendimi përbën dokumentin themelor për realizimin e programit të rregullimit, organizimin dhe destinimin e hapësirës së këtij lokacioni, përcakton rregullat dhe kriteret e ndërtimit të objekteve banesore-afariste dhe rrjetit të objekteve publike dhe objekteve të Infrastrukturës teknike komunale.

6.

PRrU: "Kodra e Thatë", duhet të inkorporohet në Planin Zhvillimor Urban të Qytetit të Gjilanit.

7.

Ngastrat kadastrale të përfshira me këtë plan e të cilat janë të destinuara për objekte publike dhe objekte të infrastrukturës komunale, e që nuk janë pronë Komunale, shpallen me interesit të përgjithshëm publik, në tërësi sipas ligjit në fuqi.

8.

Për zbatimin e këtij vendimi, do të përkujdeset Kryetari i Komunës së Gjilanit përmes, Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër, Pronë dhe Banim dhe Drejtorisë për Shërbime Publike të KK-ës Gjilan.

Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi, pushojnë të vlejshme pjesët e Planeve Detaje Urbanistike, Planeve Rregulluese Urbane, Zgjidhjeve urbanistike apo akteve tjera të cilat i kanë zëvendësuar ato plane, e të cilat janë të përfshira me këtë plan.

Ky Vendim hynë në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Gjilanit.

Kuvendi i Komunës,

Izmi Zeka, Kryesues



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Në bazë të nenit 15, 16 dhe 20 të Ligjit për Planifikim Hapësinor ,nr.14/2003, Udhëzimit Administrativ për zbatimin e Ligjit për Planifikim Hapësinor mbi elementet themelore të Planit Rregullues Urban, nr.rend.41, nr. prot.02/05, dhe nenit 38.1 pika b.dhe c. të Statutit të Komunës së Gjilanit , Kuvendi i Komunës së Gjilanit, në seancën e vet të mbajtur më 08.10.2010, miraton këtë:

V E N D I M

Për Miratimin e Zgjidhjes Urbanistike të Profilit të Rrugës: “7. Shtatori”, në Gjilan

I.

Me këtë vendim miratohet Zgjidhja Urbanistike e profilit të Rrugës” 7. Shatori në Gjilan, i cili përfshin hapësirën duke filluar nga kryqëzimi me Rrugën kryesore Gjilan-Ferizaj, përball Stacionit të Autobusëve, përkatësisht “Kullës së Sahatit” deri rrëzë “Kodra së Dëshmorëve”, (në tekstin e mëtejme: ZU - “Kulla e Sahatit”-“Kodra e Dëshmorëve”.

II.

Zgjidhja Urbanistike është hartuar nga Kompania: “Edesign” nga Prishtina, dhe e njëjta përmban pjesën tekstuale dhe pjesën grafike me të gjitha elementet e Planit Rregullues Urban, duke përfshirë gjendjen ekzistuese dhe mundësitë e organizimit të rekonstruimit dhe ndërtimit të objekteve të reja përcjellëse të infrastrukturës teknike komunale.

Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është edhe Paraqitja Grafike.

III.

Obligohet Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit e Komunës së Gjilanit, që ZU, nga pika I. dhe II. të këtij Vendimi, ta inkorporoj në Planet Urbanistike në fuqi.

IV.

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Kryetari I Komunës së Gjilanit, përmes Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër, Pronë dhe Banim e Komunës së Gjilanit.

V.

Nga dita e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi, pushon të vlejë pjesa e Planit Urbanistik, përkatësisht profilet e rrugës të përfshira me ato plane e të cilat janë të përfshira me ZU– “Kulla e Sahatit”-“Kodra e Dëshmorëve”.

VI.

Ky Vendim hynë në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Gjilanit.

01.Nr. 13225
Gjilan, më 08.10.2010


Kuvendi i Komunës,

Izmi ZEKA, Kryesues



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, [ëëë.gjilani-komuna.org](http://ee.gjilani-komuna.org); e-mail: zip_gjilan@hotmail.com, tel. 0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 486

Duke u bazuar në nenin 38.1 shkronja c) dhe j), nenin 52.4 të Statutit të Komunës së Gjilanit, si dhe bazuar në Rekomandimin e Komitetit për Politikë dhe Financa të datës 22.10.2010, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 25.11.2010, miratoi këtë:

V E N D I M
PËR NDARJEN E LOKACIONIT PËR NDËRTIMIN E OBJEKTIT TË BANIMIT PËR
FAMILJET E DËSHMORËVE DHE INVALIDËVE TË LUFTËS

I

Me këtë vendim ndahet lokacioni për ndërtimin e Objektivit të banimit për familjet e Dëshmorëve dhe Invalidëve të Luftës të UÇK-ës në sipërfaqe prej 00.70.00 ha, nga sipërfaqja e gjithëmbarshme prej 03.13.69 ha, nr. i njësish P-70403013-02616-0, Certifikata kadastrale nr.1750, në vendin e quajtur "Qenar Çeshme", Zona kadastrale-Gjilan, P.SH.-pronë e Kuvendit të Komunës së Gjilanit.

II

Mjetet për ndërtimin e Objektivit të banimit për familjet e Dëshmorëve dhe Invalidëve të Luftës në lokacionin si në pikën I të këtij vendimi do të mbulohen nga Buxheti i Qeverisë së Republikës së Kosovës.

III

Po ashtu me këtë vendim obligohen sektorët e veçantë të Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastrë, Pronë dhe Banim dhe Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit që të ndërmarrin veprimet e nevojshme për krijimin e kushteve për vendosjen e objektivit të banimit për familjet e Dëshmorëve dhe Invalidëve të Luftës.

IV

Zbatimin e këtij vendimi e bëjnë Drejtoria për Gjeodezi, Kadastrë, Pronë dhe Banim dhe Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, ndërsa për implementimin e tij kujdeset Kryetari i Komunës së Gjilanit.

V

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Gjilanit.

Nr.01. 16-15298
Gjilan, më 25.11.2010


Kuvendi i Komunës,

Izmi ZEKA, Kryesues



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, www.gjilani-komuna.org; e-mail: zip_gjilan@hotmail.com, tel. 0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 486

Në bazë të nenit 38.1 shkronja c) dhe e) dhe nenit 39.1 të Statutit të Komunës së Gjiçanit, kërkesës së MMHP-Institutit Hidrometeorologjik të Kosovës-Prishtinë, nr.ZSP-542/2010 të datës 03.09.2010, Kuvendi I Komunës së Gjiçanit në seancën e mbajtur më 25.11.2010, miratoi këtë:

V E N D I M

për dhënien në shfrytëzim të përkohshëm të pronës komunale për vendosjen e pajisjeve për monitorimin e cilësisë së ajrit

I

Me këtë vendim Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor-Institutit Hidrometeorologjik të Kosovës në Prishtinë I IPET në shfrytëzim të përkohshëm paluajtshmëria në sipërfaqe prej gjithsejtë: **8m²** nga pjesa e parcelës kadastrale nr.3844, në sipërfaqe të përgjithshme prej: 1839m², Vendi i quajtur: "Qytet", Zona Kadastrale: Gjiçan, e evidentuar në Fletën poseduese nr.5138, në emër të" Kuvendi I Komunës-Gjiçan.

II

Paluajtshmëria nga pika I e këtij vendimi, epet me qëllim të vendosjes së Stacionit për monitorimin e cilësisë së ajrit dhe nuk mund të përdoret për qëllime të tjera.

III

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është paraqitja grafike-pëlqimi urbanistik i dhënë në kopje të planit më datë 18 Tetor 2010 nga Drejtoria për urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit e Komunës së Gjiçanit.

IV

Autorizohet Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër, Pronë dhe Banim e KK-Gjiçan, që në emër të Komunës së Gjiçanit të bëjë nënshkrimin e Kontratës për dhënien në shfrytëzim të përkohshëm të paluajtshmërisë nga pika I e këtij vendimi, në afat prej 10 vitesh nga dita e nënshkrimit të kontratës.

Kushtet e dhënies në shfrytëzim të përkohshëm dhe mënyra e kompensimit do të caktohen me përafërsisht me kontratë nga paragrafi 1 i kësaj pike.

V

Zbatimin e këtij vendimi e bënë Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër, Pronë dhe Banim, ndërsa për implementimin e tij kujdeset Kryetari I Komunës së Gjiçanit.

VI

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi I Komunës së Gjiçanit.

01.Nr. 16-15289
Gjiçan, më 25.11.2010


Kuvendi i Komunës,

Izmi ZEKA, Kryesues



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, www.gjilani-komuna.org; e-mail: zip_gjilan@hotmail.com, tel. 0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 486

Në bazë të nenit 38.1 shkronja c) dhe e) dhe nenit 39.1 të Statutit të Komunës së Gjiçanit, kërkesës së këshillit të Bashkësisë Islame të Kosovës, nr.17-13418, të datës 14.10.2010, Kuvendi i Komunës së Gjiçanit në seancën e mbajtur më 25.11.2010, miratoi këtë:

V E N D I M

për dhënien në shfrytëzim të përkohshëm të pronës komunale për kompletimin e truallit të Xhamisë në fshatin Dobërqan

I

Me këtë vendim Këshilli i Bashkësisë Islame, me qëllim të kompletimit të truallit për ndërtimin e Xhamisë në fshatin Dobërqan, Komuna e Gjiçanit i jep në shfrytëzim të përkohshëm paluajtshmërinë në sipërfaqe prej gjithsejtë: **90m²** nga pjesa e parcelës kadastrale nr.705, në sipërfaqe të përgjithshme prej: 5175m², Vendi i quajtur: "Fshatë", Zona Kadastrale: Dobërqan, e evidentuar në Fletën poseduese nr.350, në emër të: Pasuri Shoqërore-e mirë e përgjithshme-Rrugë e Komunës së Gjiçanit.

II

Sipërfaqja prej **10m²** e pjesës së ngastrës kadastrale nr.706 e evidentuar në Fletën poseduese nr.182, në emër të Këshillit të Bashkësisë Islame-Gjiçan, i bashkëngjitet sipërfaqes së Ngatrës Kadastrale nr. 705 të evidentuar në Fletën poseduese nr. 350, në emër të PSH-Rrugë e KK-Gjiçan.

III

Ndërtimi i objektit të Xhamisë dhe organizimi i rregullimit të hapësirës do të bëhet në tersi sipas kushteve urbanistike-teknike në tersi sipas paraqitjes grafike të punuar nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit e Komunës së Gjiçanit, e të cilat do të jenë pjesë përbërëse e këtij vendimi.

IV

Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë edhe: Aktvendimi i Ministrisë për Kulturë, Rini dhe Sport dhe Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve-Prishtinë, nr.95 të datës 05.10.2010 dhe Pëlqimi i Këshillit të Bashkësisë Islame-Gjiçan, nr.123/10 të datës 15.10.2010.

V

Autorizohet Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër, Pronë dhe Banim e KK-Gjiçan, që në emër të Komunës së Gjiçanit të bëjë nënshkrimin e Kontratës për dhënien në shfrytëzim të përkohshëm të paluajtshmërisë nga pika I e këtij vendimi, në afat prej 10 vitesh nga dita e nënshkrimit të kontratës.

Kushtet e dhënies në shfrytëzim të përkohshëm dhe mënyra e kompensimit do të caktohen me përafërsisht me kontratë nga paragrafi I. i kësaj pike.

VI

Zbatimin e këtij vendimi e bënë Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër, Pronë dhe Banim, ndërsa për implementimin e tij kujdeset Kryetari i Komunës së Gjiçanit.

VII

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Gjiçanit.

01.Nr. 16-15299
Gjiçan, më 25.11.2010

Kuvendi i Komunës,

Izmi ZEKA, Kryesues